



KOMISIONI
EVROPIAN

Bruksel, 10.11.2015
DPS (2015) 213 përfundimtar

**DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT
RAPORTI I VITIT 2015 PËR SHQIPËRINË**

shoqëron dokumentin

**KOMUNIKIM I KOMISIONIT
PËR PARLAMENTIN EVROPIAN, KËSHILLIN, KOMITETIN EKONOMIK DHE SOCIAL
EVROPIAN DHE KOMITETIN E RAJONEVE**

Strategjia e BE-së për zgjerimin

{KOM(2015) 611 përfundimtar}

{DPS(2015) 210 përfundimtar}

{DPS(2015) 211 përfundimtar}

{DPS(2015) 212 përfundimtar}

{DPS(2015) 214 përfundimtar}

{DPS(2015) 215 përfundimtar}

{DPS(2015) 216 përfundimtar}

Përmbajtja

1. HYRJE	4
1.1 Konteksti	4
1.2 Përmbledhje e raportit	4
2. KRITERET POLITIKE	6
2.1 Demokracia	6
2.2 Reforma në administratën publike	9
2.3 Shteti i së drejtës.....	12
2.4 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve	20
2.5 Problemet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare.....	22
3. KRITERET EKONOMIKE	23
3.1 Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale	24
3.2 Aftësia për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së .	30
4.1 Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave.....	33
4.2 Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punëtorëve.....	34
4.3 Kapitulli 3: E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime.....	34
4.4 Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit.....	35
4.5 Kapitulli 5: Prokurimi publik	36
4.6 Kapitulli 6: E drejta e shoqërive tregtare	38
4.7 Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale	38
4.8 Kapitulli 8: Politika e konkurrencës.....	39
4.9 Kapitulli 9: Shërbimet financiare	40
4.10 Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe media	40
4.11 Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural.....	41
4.12 Kapitulli 12: Politika e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare	42
4.13 Kapitulli 13: Peshkimi.....	43
4.14 Kapitulli 14: Politikat e transportit.....	44
4.15 Kapitulli 15: Energjia.....	45
4.16 Kapitulli 16: Tatimet.....	46
4.17 Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare.....	47
4.18.Kapitulli 18: Statistikat.....	48
4.19. Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi.....	49
4.20.Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe politika industriale	50
4.21. Kapitulli 21: Rrjetet trans-evropiane.....	51
4.22.Kapitulli 22 : Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore	52
4.23.Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore.....	533

4.24.Kapitulli 2: Drejtësia, liria dhe siguria	62
4.25 Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi.....	67
4.26.Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura	68
4.27.Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimet klimatike.....	69
4.28.Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit.....	70
4.29.Kapitulli 29: Bashkimi doganor.....	72
4.30.Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë.....	72
4.31.Kapitulli 31: Politika e jashtme, siguri dhe mbrojtje.....	73
4.32.Kapitulli 32: Kontrolli Financiar.....	74
4.33.Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore.....	76
Shtojca I: Marrëdhëniet midis BE - Shqipërisë.....	77
Shtojca II: Shtojca statistikore.....	79

1. HYRJE¹

1.1 Konteksti

Në qershor 2014, Këshilli Evropian i dha Shqipërisë statusin e vendit kandidat. Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka përmbushur bë mënyrë të rregullt detyrimet e saj që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA). Dialogu i rregullt politik dhe ekonomik midis BE-së dhe Shqipërisë ka vijuar nëpërmjet strukturave përkatëse sipas MSA-së. Qeveria është angazhuar në ndërmarrjen e reformave që lidhen me BE-në dhe në trajtimin e pesë prioritetëve kryesorë të identifikuar për hapjen e negociatave për anëtarësim.² Shqipëria ka vijuar të marrë pjesë në mënyrë aktive në takimet e dialogut të nivelit të lartë, si dhe në grupet e përbashkëta të punës për pesë prioritetet kyç.

1.2 Përmbledhje e raportit

Zgjedhjet vendore të qershorit 2015 u zhvilluan pa incidente madhore. Dyshimet në lidhje me paanësinë dhe profesionalizmin e autoriteteve zgjedhore dhe politizimin e përgjithshëm të procesit zgjedhor, mbeten ende çështje për tu zgjidhur. Në dhjetor 2014, Kuvendi miratoi një rezolutë që përcakton se shumica qeverisëse dhe partia në opozitë duhet të përfshihen në një dialog politik të vazhdueshëm dhe konstruktiv. Kjo i dha fund bojkotit gjashtëmujor të Kuvendit nga ana e partisë kryesore të opozitës. Megjithatë, duhet akoma shumë punë për t'i dhënë zgjidhje kulturës së përçarjes politike dhe për të siguruar një dialog ndërpartiak akoma më konstruktiv.

Në lidhje me reformën në administratën publike, Shqipëria është deri diku e përgatitur. Ndërkohë, janë miratuar strategjia gjithëpërfshirëse e reformave dhe Kodi i ri i Procedurave Administrative. Por, është e nevojshme të bëhen akoma përpjekje për të arritur objektivin e një administrate publike profesionale dhe të depolitizuar, për të rritur kapacitetin financiar dhe administrativ të njësive të qeverisjes vendore, si dhe për të siguruar zbatimin efektiv të ligjit për nëpunësin civil në nivel vendor.

Sistemi gjyqësor në Shqipëri është në një fazë fillestare të përgatitjes. Në sistemin gjyqësor ka mangësi të konsiderueshme për tu trajtuar që lidhen me pavarësinë dhe besueshmërinë e gjykatësve dhe prokurorëve, ekzekutimin e vendimeve, bashkëpunimin ndër-institucional, dhe administrimin e drejtësisë i cili vazhdon të jetë i ngadaltë. Për të kryer një reformë të plotë dhe gjithëpërfshirëse në drejtësi u krijua një komision parlamentar i posaçëm. Hapat e ardhshëm vendimtare janë miratimi i strategjisë dhe planit të veprimit për reformën gjyqësore, shoqëruar nga miratimi i masave të nevojshme institucionale, legjislative dhe procedurale.

Shqipëria është pak e përgatitur në drejtim të luftës kundër korrupsionit. Është miratuar strategjia e re kundër korrupsionit dhe plani i veprimit. Megjithatë, korrupsioni është i përhapur dhe kërkohen akoma më shumë përpjekje për të bërë progres me qëllim krijimin e një historiku të qëndrueshëm të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në të gjitha nivelet. Duhet të përmirësohen hetimet paraprake, vlerësimet sistematike të rrezikut dhe bashkëpunimi ndër-institucional. Pavarësia e institucioneve të përfshira në luftën kundër korrupsionit nevojitet të rritet, pasi këto institucione mbeten të pambrojtur ndaj presioneve politike dhe ndikimeve të tjera të panevojshme.

Për sa i përket luftës kundër krimit të organizuar, vendi është përgatitur në një farë niveli.

¹ Ky raport mbulon periudhën nga qershor 2014 deri në shtator 2015. Ai bazohet në të dhëna të marra nga një larmi burimesh, përfshirë kontributet e Qeverisë shqiptare, Shtetet Anëtare të BE-së, raportet e Parlamentit Evropian dhe informacione nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe jo-qeveritare. Si rregull, legjislativi apo aktet që janë ende në fazë përgatitje ose në pritje të miratimit nga Kuvendi nuk merren në shqyrtim.

² Shiko strategjinë dhe sfidat kryesore të zgjerimit për periudhën 2013-2014.

Shqipëria ka kryer një sërë operacionesh të zbatimit të ligjit të cilat çuan në shkatërrimin e kulturave të mëdha të kanabisit. Por, numri i vendimeve përfundimtare për dënimin me burgim, i cili sjell shpërbërjen në mënyrë efektive të organizatave kriminale, mbetet i papërfillshëm, në krahasim me vlerën e përlllogaritur të tregut kriminal në vend dhe rajon. Hetimi financiar, masat kundër pastrimit të parave dhe konfiskimi i pasurisë vijojnë të jenë të pakta në numër. Shqipëria ka nevojë të krijojë një regjistër të hetimeve paraprake, ndjekjeve penale dhe dënimeve në rastet e kriminit të organizuar, përfshirë këtu pastrimin e parave dhe shpërbërjen efektive të rrjeteve kriminale.

Kuadri ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është gjerësisht në pajtim me standardet evropiane. Megjithatë, zbatimi i ligjislacionit dhe strategjive përkatëse është i kufizuar, dhe mekanizmat që zbatohen për mbrojtjen e të drejtave të njeriut mbeten të pamjaftueshme. Për sa i përket lirisë së shprehjes, Shqipëria ka bërë pak në këtë drejtim. Atmosfera e përgjithshme është kryesisht e favorshme për të ushtruar lirinë e shprehjes, por kërkohet një zbatim më i mirë i ligjislacionit. Pavarësia e autoritetit rregullator dhe radio televizionit publik duhet të forcohet akoma më tej. Zbatimi në praktikë i të drejtave të pronësisë mbetet një çështje që duhet të garantohet, dhe proceset e regjistrimit, kthimit dhe kompensimit të pronës nuk kanë përfunduar ende. Pakicat Rome dhe egjiptiane përballen me kushte shumë të vështira të jetesës dhe vuajnë nga përjashtimi social dhe diskriminimi i shpeshtë. Në fushën kundër diskriminimit, është e nevojshme që jurisprudenca të zhvillohet më tej. Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës mbeten ende të dobëta. Sistemi i drejtësisë për të miturit nuk është në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Shqipëria ka vijuar të marrë pjesë në mënyrë aktive në bashkëpunimet rajonal dhe ka ruajtur marrëdhënie fqinjësie të mira, në përputhje me zotimet e saj të marra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Për sa i përket **kritereve ekonomike**, Shqipëria është e deri diku e përgatitur për të zhvilluar një ekonomi tregu funksionale. Është arritur një farë progresi në drejtim të përmirësimit të stabilitetit makroekonomik dhe janë përmirësuar perspektivat për rritje. Inflacioni ka mbetur i ulët. Megjithatë, ka ende sfida të mëdha. Është e nevojshme të bëhen përpjekje të mëtejshme për të mbështetur konsolidimin fiskal, përmirësuar mjedisin e biznesit dhe për t'i dhënë zgjidhje problemit të ekonomisë joformale. Shqipëria duhet, gjithashtu, të përmirësojë kuadrin e menaxhimit të buxhetit dhe t'i japë zgjidhje çështjes së nivelit të lartë të kredive me probleme. Nivelet e papunësisë (17.5%) dhe punësimit joformal vazhdojnë të mbeten të lartë.

Në lidhje me kapacitetin për të përballuar presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Bashkimit, Shqipëria ka një nivel përgatitje të ulët. Është bërë pak progres në drejtim të arsimit, transportit dhe infrastrukturës energjetike. Megjithatë, duhet të kryhen investime të rëndësishme në kapitalin njerëzor dhe fizik për të përmirësuar kapacitetin konkurrues të Shqipërisë. Shqipëria duhet të përmirësojë cilësinë e arsimit të lartë dhe të vazhdojë ristrukturimin e arsimit dhe aftësisimit profesional, të miratojë dhe verë në zbatim strategjitë kombëtare të transportit dhe energjisë, si dhe të ulë pengesat jo tarifore të tregtisë, të tilla si mangësitë në sigurinë ushqimore.

Shqipëria vijon të përshtatë legjislacionin e saj sipas kërkesave të BE-së në një sërë fushash, duke rritur kështu **aftësinë e saj për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësisë**. Në shumë fusha, vendi është deri diku i përgatitur, të tilla si kontrolli financiar, ose ka një farë përgatitje, siç janë fusha e prokurimit publik dhe ajo e statistikave. Por, Shqipëria do të duhet të bëjë përpjekje ende të mëdha për të rritur nivelin e aftësisë së saj për të zbatuar *acquis*-in. Ajo duhet të vazhdojë punën për të zhvilluar rrjetin e transportit dhe energjisë. Është e nevojshme të forcohen kapaciteti administrativ dhe standardet profesionale të organeve të ngarkuara me zbatimin e *acquis*-it dhe të mos cenohet pavarësia e organeve rregullatore. Vazhdon të jetë çështje thelbësore rritja e transparencës dhe besueshmërisë, në veçanti garantimi i funksionimit efektiv, produktiv dhe

transparent i sistemit të prokurimit publik dhe menaxhimi i financave publike.

Pritet që autoritetet shqiptare të vazhdojnë përpjekjet për të t'i dhënë zgjidhje rritjes së numrit të aplikimeve për azil, që janë dukshëm të pabazuara, të paraqitura nga qytetarët në vendet e Shteteve Anëtare të BE-së dhe ato të Schengen-it. Të gjitha aktivitetet që luftojnë këtë fenomen negativ, duhet të intensifikohen duke përdorur mekanizmin e monitorimit pas liberalizimit të vizave, sidomos pas rritjes së fundit të numrit të aplikimeve që ndodhi gjatë verës.

2. KRITERET POLITIKE

2.1 Demokracia

Zgjedhjet

Zgjedhjet vendore të qershorit 2015 u zhvilluan pa incidente madhore. Shqetësimet e ngritura në lidhje me paanësinë dhe profesionalizmin e autoriteteve zgjedhore dhe politizimin e përgjithshëm të procesit zgjedhor, mbeten ende për tu zgjidhur.

Pavarësisht se në zgjedhjet vendore të qershorit nuk ndodhën incidente madhore, procesi u shoqërua me një sërë mangësish. Vëzhguesit ndërkombëtarë vërejtën shumë raste të votimit në grup dhe parregullsi procedurale. Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) ngriti shqetësime në lidhje me paanshmërinë dhe profesionalizmin e organeve zgjedhore dhe politizimin e përgjithshëm të procesit zgjedhor.

Zgjedhjet vendore u bazuan në ndarjen e re territoriale-administrative, e cila përcaktoi ndarjen në 61 njësi bashkiake. Në prill, u miratuan ndryshimet në Kodin Zgjedhor për të pasqyruar kufijtë e rinj. Këto ndryshime forcuan gjithashtu dispozitat mbi kuotat gjinore në zgjedhjet vendore, duke kërkuar përfaqësimin me 50% të secilës gjini në listën e kandidatëve, në pajtim me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias. Ndërkohë që rekomandime të tjera të OSBE/ODIHR-it nuk janë marrë ende parasysh, përfshirë këtu ato mbi rritjen e paanshmërisë të komisioneve zgjedhore, transparencën e financimit të fushatës dhe zgjidhjen efektive të mosmarrëveshjeve zgjedhore.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka funksionuar me kapacitet të plotë qysh prej janarit, kur Kuvendi emëroi tre anëtarë, emërimi i të cilëve ishte lënë pezull qysh prej prillit 2013. Paanshmëria e përgjithshme dhe profesionalizmi i administratës zgjedhore mbetet një shqetësim.

Kuvendi

Në drejtim të funksionimit të kuvendit është bërë disi progres, në veçanti, është përmirësuar transparenca e procesit të bërjes së ligjeve. Por, duhen ende përpjekje për të garantuar një dialog ndërpartiak edhe më konstruktiv. Janë ndërmarrë hapat e parë për përgatitjen e legjislacionit për të përjashtuar nga postet publike personat që kanë kryer vepra penale.

Në dhjetor, partia kryesore e opozitës i dha fund periudhës gjashtë mujore të bojkotimit të Kuvendit, kur Kuvendi miratoi një rezolutë mbi bazën e së cilës shumica qeverisëse dhe partia kryesore e opozitës u zotuan të përfshihen në një dialog politik konstruktiv. Ato ranë dakord, gjithashtu, që të rishikojnë rregullat e procedurës të komisioneve parlamentare, si dhe për t'ju futur punës për të hartuar legjislacionin për përjashtimin nga postet publike të personave që kanë kryer vepra penale. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje nisi me ngritjen e dy komisioneve parlamentare hetimore dhe një komision të posaçëm për të punuar për përjashtimin nga postet publike të personave që janë kryer vepra penale. Miratimi i legjislacionit përkatës do të rrisë besimin e qytetarëve tek përfaqësuesit politikë dhe institucionet publike.

Puna e komisioneve vazhdon të jetë e ndikuar nga polarizimi politik. Në korrik, Kuvendi miratoi përbërjen e re të komisionit të posaçëm për reformën gjyqësore mbi bazën e parimit të barazisë së anëtarëve nga shumica qeverisëse dhe opozita. Në nëntor, Kuvendi ndryshoi rregullat e veta të procedurës, duke i dhënë partisë kryesore të opozitës të njëjtën njësi kohe për të folur sa Kryeministri. Ndërkohë, duhet të sigurohet dialogu konstruktiv në Kuvend dhe organet e tij teknike.

Kuvendi hoqi imunitetin e tre deputetëve nga shumica qeverisëse, dhe refuzoi shtatë propozime kandidatësh të Presidentit për në Gjykatën e Lartë.

Në mars, Kuvendi miratoi një ligj të ri për rolin e tij në procesin e integritit në BE, duke parashikuar më shumë gjithëpërfshirje, mbikëqyrje dhe shkëmbim të informacionit. Në maj, kjo nismë u pasua me themelimin e Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian, për ta bërë akoma më gjithëpërfshirës procesin e reformave që lidhen me BE-në. Kapaciteti i Kuvendit për të monitoruar zbatimin dhe pajtueshmërinë e legjislacionit të ri me të drejtën e BE-së mbetet i kufizuar. Koordinimi me ekzekutivin ka nevojë të rritet. Mekanizma të tjerë të ushtrimit të kontrollit, si seancat e pyetjeve vazhdojnë të përdoren pak.

Kuvendi ka vazhduar të monitorojnë punën e institucioneve të pavarura dhe ka shqyrtuar raportet e tyre në mënyrë më të shpejtë dhe më të plotë. Megjithatë, duhet të sigurohet ndjekja e përshtatshme në vazhdimësi e rezultateve të tyre.

Transparenca dhe gjithëpërfshirja në procesin legjislativ janë përmirësuar. Komisionet parlamentare kanë qenë përgjithësisht më aktivë me zhvillimin e konsultimeve me shoqërinë civile dhe grupet e interesit. Në dhjetor, u miratua një rezolutë mbi rolin e shoqërisë civile në zhvillimin demokratik të vendit. Struktura organizative e Kuvendit dhe kapaciteti i tij administrativ dhe specializimi ka nevojë të përmirësohet më tej, gjë që kërkon sigurimin e fondeve të mjaftueshme për të rekrutuar dhe trajnuar stafin, veçanërisht në lidhje me aftësitë për të kryer kërkime dhe analiza.

Qeverisja

Qeveria ka qenë e përqendruar në objektivin e saj për të trajtuar prioritetet kyçe për hapjen e negociatave për anëtarësim, duke ndjekur një sërë reformash të nevojshme për të ecur përpara në rrugën drejt e integritit në BE. Me nisjen e zbatimit të reformës administrative-territoriale dhe miratimin e strategjisë së decentralizimit është arritur një farë progresi në nivelin e qeverisjes vendore. Megjithatë, duhet shumë punë për të bërë të qarta funksionet dhe përgjegjësitë e njësisë të qeverisjes vendore të krijuara rishtazi, si dhe për të rritur kapacitetet e tyre financiare dhe administrative.

Në drejtim të koordinimit ndër-institucional janë marrë disa masa. Grupet e punës në sektorë të veçantë janë riorganizuar për të përmirësuar monitorimin e zhvillimit të politikave, si dhe për të ofruar këshilla strategjike që japin rezultate.

Gjykata Kushtetuese ka marrë vendime në 12 raste që lidhen me funksionimin e institucioneve shtetërore. Ekzekutimi i shpejtë i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është pikë esenciale; në veçanti duhet të garantohet zbatimi i tyre kur ato kërkojnë miratimin e akteve ligjore apo ndryshimin e praktikës së punës të qeverisë dhe Kuvendit.

Për të siguruar institucione të pavarura profesionale dhe të depolitizuara duhet të kryhen përpjekje të mëtejshme. Shqipëria duhet të marrë parasysh mundësinë për të miratuar rregulla të harmonizuara mbi emërimin dhe shkarkimin e krerëve të institucioneve të pavarura, kryerjen e një procesi transparent përzgjedhje që bazohet në merita, si për drejtuesit e tyre ashtu edhe për anëtarët e bordeve, për tu siguruar atyre autonomi buxhetore dhe pavarësi për të ngritur vetë strukturat e tyre të brendshme.

Për sa i përket vetëqeverisjes së njësive vendore, qeveria themeloi në janar Agjencinë Kombëtare për Zbatimin e Reformës Territoriale. Ndërkohë që janë miratuar udhëzimet për bashkimin e njësive të qeverisjes vendore, si rrjedhojë e reformës administrative territoriale, dhe është shpërndarë një fond i përkohshëm prej 13.2 milionë euro për zbatimin e reformës në 61 njësitë e reja bashkiake. Sipas strategjisë së miratuar rishtazi për decentralizimin për periudhën 2015-2020, nevojitet të miratohet një ligj i ri që të qartësojë tërësisht funksionet dhe përgjegjësitë e njësive të qeverisjes vendore. Shoqatat e njësive të qeverisjes vendore kanë qenë më aktive në hartimin e strategjisë dhe akteve ligjore. Megjithatë, mbeten akoma për tu zbatuar dispozitat e fundit ligjore për rritjen e bashkëpunimit ndër-institucional midis njësive të qeverisë qendrore dhe atyre vendore.

Ndryshimet në ligjin për planifikimin e territorit, të cilat bënë të qarta disa aspekte të zhvillimit të planeve vendore, hynë në fuqi në tetor 2014, dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre janë në zbatim qysh prej korrikut. Megjithatë, njësitë e qeverisjes vendore vazhdojnë të përballen me vështirësi për sa i përket zbatimit të përgjegjësive të tyre të planifikimit urban.

Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar ka vijuar me procesin e prishjes së ndërtimeve pa leje, ndërkohë që ende vazhdon procesi për legalizimin e ndërtimeve të tjera nga ana e Agjencisë së Legalizimit të ndërtimeve pa leje. Inspektorati ka denoncuar në prokurori disa nga kryetarët e bashkive për shpërdorim detyre dhe dhënien e lejeve të paligjshme të ndërtimit. Kjo gjë solli si rezultat nisjen e procedimeve penale dhe marrjen e vendimeve në shkallë të parë. Procesi i vendim-marrjes në Këshillin Kombëtar të Territorit (KKT), inspektorat dhe organet e qeverisjes vendore duhet të bëhet më transparente.

Për sa i përket decentralizimit fiskal, shpenzimet e njësive të qeverisjes vendore për vitin 2014 ishin 2.3% e PBB-së, duke shënjuar rritje nga viti i kaluar, por që ende mbetet mbrapa në lidhje me objektivin vjetor. Shqipëria duhet të forcojë menaxhimin e financave publike në nivel vendor sipas strategjisë për menaxhimin e financave publike, të miratuar në muajin dhjetor. Duhet të mbështeten akoma më shumë përpjekjet për të bërë transparente shpërndarjen e fondeve nga qendrore tek njësitë vendore. Shqipëria duhet të sigurojë qëndrueshmërinë e strategjisë së decentralizimit, si pjesë e programit të buxhetit afatmesëm 2016-2018.

Njësitë e qeverisjes vendore kanë nevojë për kapacitet më të madh për të qenë të afta të ofrojnë shërbime për publikun, duke përfshirë ofrimin e të gjitha shërbimeve publike një ndalesë (one-stop-shops). Është e nevojshme të bëhen akoma më shumë përpjekje për të zhvilluar kapacitetin për të hartuar dhe zbatuar planet e zhvillimit vendor. Duhet përpjekje të konsiderueshme, si nga ana e njësive të qeverisjes qendrore ashtu edhe nga ato vendore për të zhvilluar dhe zbatuar një plan trajnimi gjithëpërfshirës për stafin e njësive të reja të qeverisjes vendore.

Bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me shoqërinë civile vijon të jetë shumë i mirë, dhe janë realizuar një sërë trajnimesh të përbashkëta. Në mars, Komiteti Ndërkombëtar për Koordinimin e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut i dha Zyrës së Avokatit të Popullit certifikatën e statusit “A”, për pajtueshmërinë me Parimet e Parisit, duke i dhënë këtij të fundit të drejtën për të folur në Këshillin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Në nëntor, Ligji për Avokatin e Popullit u ndryshua, duke zgjeruar sferën e tij në nxitjen e të drejtave të njeriut dhe parashikimin e një procedure më transparente gjithëpërfshirëse për përzgjedhjen e kandidatëve për komisionerë, si dhe krijimin e dy posteve shtesë për Komisioner: Komisioneri për Fëmijët dhe Komisioneri për mekanizmin kombëtar për parandalimin e torturës. Megjithatë, këto nuk janë reflektuar në ndarjen e buxhetit shtesë, buxhet i cili mbeten i pamjaftueshëm. Shtatë zyrat rajonale të Avokatit të Popullit varen nga përkrahja e vullnetarëve dhe donatorëve. Duhet të rritet autoriteti, autonomia dhe burimet e Zyrës së Avokatit të Popullit, dhe ai duhet të konsultohet rregullisht kurdoherë në procesin legjislativ dhe hartimin e reformave që prekin fushat e kompetencës së tij.

Shoqëria civile

Është arritur progres i kënaqshëm në drejtim të krijimit të një kuadri institucional për

bashkëpunimin dhe konsultimin me shoqërinë civile. Tanimë, është më rëndësi që mekanizmat ekzistues të zbatohet plotësisht në praktikë.

Bashkëpunimi midis institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve) është përmirësuar. Në tetor, Kuvendi miratoi një rregullore për konsultimin e publikut, dhe në dhjetor, ai miratoi një rezolutë që ratifikoi Kartën e Shoqërisë Civile, duke njohur kështu rëndësinë e shoqërisë civile në zhvillimin demokratik të vendit. Pas një procesi të gjerë konsultimi, në maj, qeveria miratoi një plan, i cili përcakton politikën e saj për arritjen e një mjedisi më të favorshëm për shoqërinë civile. Përfaqësues të shoqërisë civile morën pjesë në mbledhjet e Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian, por duhet akoma punë që ato të marrin një rol aktiv. Qeveria miratoi ligji për krijimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, një organ këshillimor që ka për qëllim të mundësojë dialogun e rregullt ndërmjet qeverisë dhe OSHC-ve për zhvillimin e shoqërisë civile, por ky ligj nuk është miratuar ende nga Kuvendi. Në nivel vendor, bashkëpunimi mbetet i dobët.

Pavarësisht se, ligji i ri për TVSH-në iu njeh OSHC-ve mundësinë për të marrë rimbursimin e tatimit mbi vlerën e shtuar nga grante të financuara nga Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA), deri më tani nuk është kryer asnjë rimbursim i tillë. Sistemi i ri i deklarimit të taksave në linjë kërkon që të gjitha OSHC-të të bëjnë deklaratimet mujore, madje edhe kur ato nuk janë duke kryer veprimtari. Kjo gjë krijon një barrë administrative shtesë, veçanërisht mbi organizatat e vogla.

Financimi publik për OSHC-të është i kufizuar, dhe ndërkohë duhet që, procedurat për ndarjen e fondeve të bëhen të qarta dhe të unifikohen për mbarë administratën publike. Rregullat tatimore dhe norma të tjera nuk janë të favorshme për donacione private të OSHC-ve. Shoqëria civile mbetet në përgjithësi e fragmentuar dhe tejet e varur nga financimet e donatorëve.

2.2 Reforma në administratën publike

Në drejtim të reformës në administratën publike, Shqipëria është deri diku e përgatitur. Është bërë progres i pëlqyeshëm në fushat e prioriteteve kyçe të reformës në administratën publike, në veçanti, është miratuar një strategji gjithëpërfshirëse për reformën dhe Kodi i ri i Procedurave Administrative. Megjithatë, duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme edhe në fushat jashtë sferës së veprimtarisë së këtij prioriteti kyç, në veçanti, për përmirësimin e zhvillimit të politikave dhe koordinimin, dhe kapacitetit të gjykatave administrative.

Për të realizuar prioritetin kyç në reformën e administratës publike, për vitin që vjen, Shqipëria, në veçanti, duhet:

- të vazhdojë të dëshmojë një proces transparent dhe të bazuar në merita për rekrutimin dhe shkarkimin e nëpunësve civilë në të gjitha institucionet shtetërore, me qëllim arritjen e objektivit për një administratë publike profesionale dhe të depolitizuar;
- të bëjë publike informacione të sakta mbi shërbimin publik me anë të Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, dhe ta lidhë atë me sistemin e thesarit;
- të përgatitet për zbatimin e Kodit të ri të Procedurave Administrative, dhe paralelisht të rishikojë dhe përafrojë pjesën tjetër të legjislacionit përkatës.

Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

Ligji i vitit 2013 për statusin e nëpunësit civil është në pajtim me parimet e administratës publike. Ligji parashikon **rekrutimin, ngritjen në detyrë dhe largimin nga shërbimi civil mbi bazë merite**. Gjatë vitit 2014 dhe 2015, u kryen disa rekrutime të hapura me listë-rezervë për pranimin

në shërbimin civil. U mbajt një konkurs i hapur për nëpunës të lartë të shërbimit civil, i cili çoi në krijimin e trupës së nivelit të lartë drejtues.

Do të duhet të hartohet një program trajnimi të thelluar për të gjithë stafin e ri në nivel të lartë drejtues.

Ndryshimet e ligjit u miratuan në dhjetor, por, hapën mundësinë e rekrutimit të personave nga jashtë shërbimit civil për postet e mesme dhe të ulëta drejtuese, dhe bënë që shkarkimi të jetë më fleksibël. Aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ndryshimeve, duhet të sigurojnë procedura të drejta dhe rigorozë për rekrutimin dhe shkarkimin. Cilësia e procedurave të rekrutimit duhet të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme, në veçanti në institucionet e pavarura. Kuadri ligjor përjashton disa institucione dhe pozicione të caktuara nga sfera e veprimit të Ligjit për statusin e nëpunësit civil. Shqipëria duhet të garantojë një regjim homogjen të rekrutimit në institucionet e administratës publike.

Menaxhimi i burimeve njerëzore në mbarë administratën publike është përmirësuar. Departamenti i Administratës Publike ka rritur numrin e stafit të saj, në vitin 2014, për të siguruar koordinim më të mirë, por ka ende nevojë të përmirësojë kapacitetin. Kanë filluar përgatitjet për të bërë funksional sistemin informativ për menaxhimin e burimeve njerëzore, dhe për ta zgjeruar atë në të gjitha institucionet. Zbatimi i Ligjit për statusin e nëpunësit civil në nivel vendor mbetet akoma një sfidë. Numri i madh i ankesave në gjykatat administrative ngre shqetësim në lidhje me përdorimin e procedurave të zgjidhjes, uljes në detyrë, ristrukturimit dhe ato disiplinore për të uljen në detyrë dhe shkarkimin e nëpunësve publikë.

Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil u emërua nga Kuvendi në fund të vitit 2014, si një autoritet i pavarur për të kryer mbikëqyrjen e menaxhimit të shërbimit civil. Në mars, ajo prezantoi raportin e saj të parë në Kuvend. Por, duhet të sigurohet ndjekja efektive e konstatimeve dhe rekomandimeve të Komisioneres.

Sistemi i shpërblimit bazohet në klasifikimin e vendit të punës dhe, në parim, është një sistem transparent. Megjithatë, në qershor, Qeveria miratoi një sistem të ri të shpërblimeve mbi pagat për nëpunësit civilë që punojnë në fushën e integritetit në BE dhe të hartimit të ligjeve. Është e nevojshme që sistemi i propozuar të rishikohet për të siguruar pajtueshmërinë me Ligjin për statusin e nëpunësit civil. Autoritetet duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar një shpërblim të drejtë dhe transparent me pagesë të barabartë për punë të barabartë, dhe për të shmangur dobësimin e sistemit të shërbimit civil të bazuar në karrierë.

Zhvillimi profesional është parashikuar me ligj. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) është përgjegjëse për trajnimin e nëpunësve civilë. Cilësia dhe sasia e trajnimit është rritur, por buxheti i ASPA-së është i pamjaftueshëm për të mbuluar rritjen e numrit të nëpunësve civilë që kanë nevojë për trajnim. Sistemi i ri i vlerësimit të performancës nuk është vënë akoma në përdorim të gjerë.

Perceptimi i korrupsionit është i lartë në Shqipëri. Si strategjia për reformën në administratën publike ashtu edhe strategjia kundër korrupsionit përfshijnë masa për parandalimin e korrupsionit dhe nxitjen e **integritetit në shërbimin publik**, por ende duhet që ato të zbatohen në mënyrë efektive.

Zhvillimi dhe koordinimi i politikës

Shqipëria ka kuadrin ligjor dhe struktura institucionale funksionale për të garantuar **një sistem të mirë për hartimin e politikave**, por ka disa dobësi në drejtim të zbatimit. Është ngritur një sistem për koordinimin e integritetit evropian, por duhet që ai të bëhet plotësisht funksional dhe të pajiset me kapacitet e nevojshme të personelit. Planifikimi, monitorimi dhe raportimi i zbatimit të planit kombëtar për integritetin evropian duhet të përmirësohet. Ka dobësi në lidhje me zbatimin e programit e punës të Qeverisë, koordinimin e propozimeve të politikave dhe nxjerrjen e kostos së strategjive. Prandaj, duhet të forcohen në mënyrë të dukshme lidhjet ndërmjet planifikimit të

politikave dhe planifikimit të buxhetit afatmesëm.

Zhvillimi i politikave dhe legjislacionit nuk është ende aq sa duhet **gjithëpërfshirës dhe i bazuar në evidenca**. Në mars 2015, tabelat e përputhshmërisë në bazë të standardeve evropiane u bënë të detyrueshme për të gjithë legjislacionin që synohet të përafrohet me *acquis*-in. Megjithatë, ministritë zbatojnë ende rregulla të qarta të brendshme që rregullojnë procedurat për zhvillimin e politikave dhe hartimin e legjislacionit. Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik hyri në fuqi në maj, dhe përcaktoi procedura për konsultimin me palët e interesuara. Vlerësime të ndikimit nuk kryhen në mënyrë sistematike dhe cilësia e tyre ndryshon në varësi të institucioneve. Vlerësimet e ndikimit financiar, në përgjithësi, shoqërojnë projekt-propozimet legjislative, por cilësia e tyre gjithashtu ndryshon shumë.

Sistemi për monitorimin e performancës së Qeverisë duhet të jetë i zbatueshëm për të siguruar një **shqyrtim publik efektiv të punës së qeverisë**, dhe raportet e monitorimit të Qeverisë duhet të përqendrohen në arritjet kundrejt objektivave të politikës dhe jo në rezultate.

Besimi tek administratës

Ka një kuadër ligjor për organizimin e administratës shtetërore, por **linjat e dhënies së llogarisë** ndërmjet agjencive dhe organeve të vartësisë nuk janë ende plotësisht të qarta. Gjithashtu, linjat e dhënies së llogarisë brenda institucioneve kanë nevojë të përmirësohen, pasi sistemit i mungon karakteri i dhënies së llogarisë nga ana e administratës drejtuese. (Shiko *Kapitullin 32-Kontrolli financiar*)

Struktura e organizimit institucional dhe burimet që duhet të garantojnë **të drejtën e qytetarëve për të patur një administratë të mirë** janë të mirë vendosura në përgjithësi. Megjithatë, shkalla në të cilën zbatohen rekomandimet e organeve mbikëqyrëse, të tilla si Avokati i Popullit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, e vështirë për tu përcaktuar, pasi mungon monitorimi sistematik. **E drejta për tu njohur me informacionin publik** rregullohet nga Ligji për të Drejtën e Informimit, i cili u miratua në shtator të vitit 2014. Ky ligji vesh Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kompetenca mbikëqyrëse, monitoruese dhe për të vendosur sanksione. Ndërkohë që duhet të kryhet edhe monitorimi i rregullt i zbatimit në praktikë të përjashtimeve nga ky ligj.

E drejta për drejtësi administrative rregullohet me Ligjin për Gjykatën Administrative dhe Ligji për mosmarrëveshjet administrative. Kapaciteti i përgjithshëm i sistemit të gjykatave administrative për të shqyrtuar morinë e rasteve të prapambetura duhet të përmirësohet në mënyrë të dukshme. Ekzekutimi i vendimeve përfundimtare të gjykatave shoqërohet nga vonesa të konsiderueshme, përfshirë rastet e nëpunësve civilë të pushuar në mënyrë të paligjshme. Kushtetuta përcakton se **e drejta për të marrë kompensim** dhe përgjegjësia e autoriteteve publike në rast shkelje rregullohet me ligj të veçantë, por në praktikë numri i çështjeve gjyqësore është i ulët për shkak të ndërjegjësimit të kufizuar të publikut.

Menaxhimi i financave publike

Në dhjetor u miratua **strategjia e reformës në menaxhimin e financave publike** për periudhën 2014-2020. Zbatimi i saj është përqendruar në forcimin e kuadrit fiskal me objektiva shumëvjeçare, mbështetur në një sistem të ri të TI-së për administratën tatimore dhe kontrollin e pajtueshmërisë ligjore. Strategjia për parandalimin e vonesave të pagesave dhe shlyerja e borxhit është në rrugën e duhur. Është e nevojshme të forcohet besimi te programi i buxhetit afatmesëm, dhe të përmirësohet koordinimi i planifikimit dhe menaxhimit të investimeve publike. Duhet një koordinimi fortë për të siguruar sinergji me reformën në administratën publike. Është e nevojshme të shtohen akoma më shumë përpjekjet për të parandaluar, zbuluar dhe luftuar kundër rrezikut të mashtrimit, korrupsionit dhe shpërdorimit të fondeve publike.

Transparenca buxhetore garantohet deri në një farë mase. Propozimi i buxhetit vjetor nuk ka informacion mbi shpenzimet bazë, politikat e reja, të dhënat përfundimtare të shpenzimeve të

viteve të mëparshme apo zotimet shumëvjeçare mbi shpenzimet kapitale. Nuk vihet ende në dispozicion një buxhet për qytetarët. Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk jep mendim nëse raportet financiare të qeverisë paraqesin drejt financat publike.

Ofrimi i shërbimeve për qytetarët dhe bizneset

Ka një angazhim të fortë politik për një **administratë të orientuar drejt qytetarit**, dhe qeveria synon të ofrojë qasje të barabartë në shërbimet publike. Është arritur progres me zgjerimin e mëtejshëm të shërbimeve në portalin e-Albania si dhe me krijimin e një kuadri për lehtësimin e ndërveprimit ndërmjet institucioneve shtetërore. Plotësimi i kërkesave të publikut për shërbime qeveritare është i modest dhe duhet të rritet me politika dhe mekanizma të cilat nxisin përmirësimin cilësor të institucioneve publike.

Përgjegjësitë e fragmentuara institucionale janë një sfidë kyç për zbatimin e mëtejshëm të reformës. Në prill u arrit progres në drejtim të **thjeshtimit të procedurave administrative** me miratimin e Kodit të ri të Procedurave Administrative, në pajtim me standardet evropiane. Për zbatimin e njëtrajtshëm të kodit, pas hyrjes së tij në fuqi në mesit të vitit 2016, autoritetet duhet të kryejnë një rishikim dhe përafrimin paralel të legjislacionit që ka lidhje me të dhe të ofrojë trajnime thelbësore për nëpunësit civilë. Procedurat e veçanta administrative duhet të rishikohen dhe ose të hiqen, apo të sillen në pajtim me ligjin e ri.

Kuadri strategjik për reformën në administratën publike

Strategjia e **reformës në administratën publike** për periudhën 2015-2020 u miratua ë prill, së bashku me një **plan veprimi** për periudhën 2015-2017. Është ngritur një sistem gjithëpërfshirës për monitorimin dhe raportimin, me tregues të performancës dhe objektivat e synuar. Gjithashtu janë miratuar strategjitë që lidhen me menaxhimin e financave publike, axhendën dixhitale, anti-korrupsionin dhe decentralizimin. Grupi i krijuar rishtazi për Menaxhimin e Integruar të Politikës së RAP-it, kryesuar nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, pritet të sigurojë **mbështetjen politike** për procesin e reformës. Kapaciteti i institucioneve drejtuese ka nevojë të forcohet më tej, në veçanti në lidhje me monitorimin e reformës në administratën publike. **Qëndrueshmëria financiare** përbën një shqetësim, pasi kostot e përgjithshme në lidhje me reformën e administratës publike nuk pasqyrohen të plota në programin e buxhetit afatmesëm.

2.3 Shteti i së drejtës

Funksionimi i sistemit gjyqësor

Sistemi gjyqësor shqiptar është në një **fazë fillestare të përgatitjes**. Gjatë vitit të kaluar është arritur deri diku progres, kryesisht, në nëntor, me krijimin e një Komisioni të posaçëm parlamentar për Reformën në Drejtësi, me qëllim kryerjen e një procesi të përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës të reformës.

Administrimi i drejtësisë është i ngadaltë dhe vendimet gjyqësore jo gjithmonë ekzekutohen. Trajnimi profesional i gjykatësve është i pamjaftueshëm dhe pavarësia e tyre nuk garantohet plotësisht. Besimi ndaj gjykatësve dhe prokurorëve është i pamjaftueshëm, dhe korrupsion në sistemin e drejtësisë është i përhapur gjerësisht. Bashkëpunimi ndër-institucional është i dobët, dhe burimet janë të pamjaftueshme.

Për të realizuar prioritetin kyç në reformën e sistemit gjyqësor, për vitin që vjen, Shqipëria, në veçanti, duhet:

→ të miratojë një strategji të re për reformën gjyqësore dhe planin e veprimit shoqëruar, dhe të vazhdojë, me anë të një procesi konsultimi gjithëpërfshirës, me hartimin dhe miratimin e masave institucionale, legjislative dhe procedurale të nevojshme, duke marrë parasysh standardet evropiane dhe praktikat më të mira;

→ të plotësojë vendet e lira në Gjykatën e Lartë dhe gjykatat administrative;

→ të zgjerojë sistemin elektronik për menaxhimin e unifikuar të çështjeve gjyqësore dhe të garantojë që sistemi të punojë në mënyrë të efektshme, përfshirë këtu edhe një buxhet të përshtatshëm për mirëmbajtjen e tij;

→ të publikojë të gjitha vendimet e gjykatave me arsyetimet e tyre përkatëse brenda një afati të arsyeshëm.

Dokumentet strategjike

Strategjia e reformës në sektorin e drejtësisë për periudhën 2011-13 ka përfunduar, dhe **ka mbetur pezull miratimi i një strategjie të re**. Në prill, u miratua strategjia afatmesme e prokurorisë për periudhën 2015-17.

Organet drejtuese

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) është organi drejtues i gjyqësorit. Roli i tij është i kufizuar si gjykatë apelit dhe e shkallës së parë. Ajo përbëhet nga Presidenti i Republikës (Kryetari), Ministri i Drejtësisë, Kryetari i Gjykatës së Lartë, nëntë gjykatës nga të gjitha shkallët e gjykimit, të zgjedhur nga Konferenca kombëtare Gjyqësore dhe tre juristëve të zgjedhur nga Kuvendi me shumicë të thjeshtë. Asnjë dispozitë nuk parashikon që, të paktën një anëtar që emërohet nga Kuvendi, të mbështetet nga një parti e opozitës.

Nënkryetari i KLD-së, i cili emërohet me propozim të Presidenti nga radhët e anëtarëve të përcaktuar nga Kuvendi, luan një rol vendimtar në punën e Këshillit. Ai është i vetmi anëtar me kohë të plotë i këtij organi. KLD-ja është përgjegjëse për vlerësimin, emërimin, ngritjen në detyrë dhe transferimin e gjykatësve, si dhe kryen procedimet disiplinore të nisura nga Ministri i Drejtësisë. Në vitin 2014, u vendosën rregulla të reja për pezullim nga detyra dhe shkarkimin e anëtarëve të KLD-së, si dhe për çështjet lidhen me konfliktin e interesit. Megjithatë, rregullat e etikës mbeten jo të plota. KLD-ja publikon vendimet e tij në internet, së bashku me procesverbalet e takimeve.

Këshilli i Prokurorisë përbëhet nga gjashtë prokurorë, plus një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, dhe mund të përfshijë një përfaqësues të Presidentit të Republikës. Ai është një organ këshillimor i Prokurorit të Përgjithshëm dhe jo një organ me të drejta të plota për menaxhimin e karrierës së prokurorëve.

Pavarësia dhe paanësia

Pavarësia e gjyqësorit sanksionohet në Kushtetutë. Gjithsesi, në praktikë ajo rrezikohet nga mënyra tejet të politizuar me anë të secilës emërohen gjykatësit e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, si dhe nga hapësira e gjerë e diskrecionit që gëzon KLD-ja në emërimin, rritjen në detyrë dhe transferimin e gjykatësve. Në parim, gjykatësit dhe prokurorët vendosin në mënyrë të pavarur për çështjet që kanë nën shqyrtim. Në praktikë, pavarësia e tyre është e kufizuar dhe ka raportime të rregullta për drejtësi selektive dhe ndërhyrje politike në çështjet gjyqësore.

Sistemi i unifikuar për menaxhimin e çështjeve nuk përdoret nga të gjitha gjykatat **për ndarjen e çështjeve**. Praktika jo transparente, të tilla si hedhja me short, ku ndonjëherë shorti zhvillohet në zyrën e kryetarit të gjykatës, nuk janë kapërcyer në disa gjykatat. Rregullat **për përjashtimin e gjykatësve** nga çështje të caktuara përcaktohen në Kodin e Procedurës Civile, Penale dhe Administrative. Gjykatat nuk mbajnë një regjistër të çështjeve nga të cilat gjykatësit janë përjashtuar ose kanë kërkuar që të përjashtohen. Kërkesat individuale për përjashtimin e gjykatësit nga çështje të caktuara i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës. Shërbimi i prokurorisë i krijuar së fundmi për sistemin e trajtimit të rasteve nuk është ende plotësisht funksional në mbarë vendin, përveçse për qëllimin e regjistrimit të rasteve.

Besueshmëria

Ka **një Kod etike** për gjykatësit qysh prej vitit 2000, por që nuk ka patur asnjë ndikim konkret mbi besimin tek ta. Në vitin 2014, u miratua kod i sjelljes për prokurorinë. Nuk ka monitorim të mjaftueshëm për pajtueshmërinë me standardet etike dhe integritetin në procesin e emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve. Nuk ka as këshillim apo trajnim të detyrueshme në punë mbi etikën. Avokatët kanë kodin e tyre të etikës, dhe etika profesionale është një nga çështjet e trajtuara në programin e trajnimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës.

Gjykatësit monitorohen përmes **inspektimit** nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së. Pavarësisht se ka një memorandum mirëkuptimi ndërmjet këtyre dy organeve, ekziston rreziku i mbivendosjes së inspektimeve. Kuadri ligjor për **procedimet disiplinore** nuk është i qartë dhe këto procedura mund të përdoren për të ndikuar në mënyrë jo të drejtë mbi gjykatësit. Ministri i Drejtësisë ka tagra dhe diskrecion të ndërmarrë **procedime disiplinore** kundër gjykatësve, gjë që është në kundërshtim me standardet e BE-së. Ministri i paraqet KLD-së rastet për marrjen e masave disiplinore, i cili i merr në shqyrtim dhe vendos në lidhje me sanksionet.

Gjykatësit dhe prokurorët kanë **detyrimin të deklarojnë pasurinë** e tyre në baza vjetore. Megjithatë, pavarësisht rasteve të shumta të raportuara për mungesën e pajtueshmërisë me këtë kërkesë, nuk ka vendime përfundimtare për sanksione të dhëna deri më sot. Gjyqësori në përgjithësi perceptohet si shumë i korruptuar.

Profesionalizmi dhe kompetenca

Rekrutimi, emërimi dhe shkarkimi i gjykatësve është kompetencë e KLD-së, ndërsa për prokurorët është kompetencë e Prokurorit të Përgjithshëm. Kërkesa për profesionalizmin dhe integritetin nuk është reflektuar aq sa duhet në kriteret ekzistuese për gjykatësit. Për vlerësimin e prokurorëve ka kriteret, por mbeten ende për tu miratuar kriteret të qarta dhe transparente për vlerësimin dhe ngritjen në detyrë të gjykatësve. Vendimet që lidhen me rritjen në karrierë të gjykatësve nuk janë plotësisht transparente dhe jo gjithmonë bazohen në merita dhe kriteret e tjera objektive. Kundër emërimeve, vlerësimeve, transferimeve, vendimeve për ngritjen në detyrë dhe masat disiplinore mund të bëhet ankesë. Gjykatësit e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese emërohen nga Presidenti i Republikës, me pëlqimin e shumicës së thjeshtë të Kuvendit. Gjatë viteve të fundit, procesi i emërimit të gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë është dëmtuar nga seanca debati në Komisionin për Çështjet Ligjore në Kuvend dhe Kuvendi shpesh ka refuzuar kandidaturat e propozuara nga Presidenti. Për të rregulluar këtë situatë, Ligji për Gjykatën e Lartë u ndryshua në vitin 2013 dhe sërish në vitin 2015, kur u vendosën kriteret dhe procedura më specifike për përzgjedhjen e gjykatësve.

Prokurorët emërohen, ngrihen në detyrë, transferohen dhe shkarkohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm. Pavarësia dhe besueshmëria e sistemit të prokurorisë është dobësuar akoma më shumë nga fakti se Prokurori i Përgjithshëm emërohet me pëlqimin e shumicës së thjeshtë të Kuvendit. Procedurat për emërimin, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin e stafit kyç në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm karakterizohen nga mungesa e transparencës.

Cilësia e drejtësisë

Trajnimi fillestar dhe ai gjatë punës për gjykatësit ofrohen nga Shkolla e Magjistraturës, dhe financohen pjesërisht nga donatorë të huaj për shkak të mangësive të vazhdueshme në buxhet. Është një program trajnimi mbi jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por është i kufizuar trajnimi për *acquis*-in BE-së. Shqipëria ende nuk është pjesë e Rrjetit Evropian për Trajnimin Gjyqësor.

Shkolla Kombëtare e Avokatisë filloi aktivitetin e saj në tetor 2013. Qysh atëherë, shkolla ka përgatitur 705 juristë për provimin e avokatisë. Shkolla ende nuk ofron një trajnim gjatë punës për avokatët.

Ministria e Drejtësisë publikon një raport vjetor për veprimtarinë e gjykatave, dhe të gjitha gjykatat

hartojnë raporte e tyre përkatëse vjetore, pavarësisht se jo të gjitha këto raporte publikohen.

Buxheti për sektorin e përgjithshëm të drejtësisë në vitin 2015 është 3% më pak se në vitin 2014, në shumën prej 80.1 milion euro, vlerë e cila përfaqëson 0.8% të PBB-së dhe 2.4% të buxhetit të shtetit. Ajo mbulon Ministrinë e Drejtësisë, prokurorinë, gjykatat, Shkollën e Magjistraturës, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, është rritur buxheti për gjykatat, prokurorinë dhe Komisionin Shtetëror për Ndihmë Juridike, i cili arrin në shumën prej 27.6 milion euro dhe që përfaqëson 9.55 euro për banor.

Shqipëria ka 402 gjykatës profesionistë (13.9 për 100,000 banorë), 327 prokurorë (11.4 për 100,000 banorë) dhe 916 persona në stafin e gjykatës administrative (2.3 punonjës për gjykatës). Ka 55 avokatë që ushtrojnë profesionin për 100,000 banorë. Por, është e nevojshme të përmirësohet, planifikimi dhe shpërndarja e burimeve administrative dhe financiare brenda gjyqësorit.

Janë bërë investime të mëdha në infrastrukturën e gjykatave, por shumë mjedise të gjykatave kanë nevojë për rikonstruksion të mëtejshëm. Disa gjykata nuk kanë salla të mjaftueshme dhe seancat dëgjimore zhvillohen ende në zyrat e gjykatësve, gjë që rrit rrezikun ndaj praktikave korruptuese.

Legjislacioni në formë të konsoliduar nuk vihet në dispozicion për tu marrë nga interneti. Ekziston një bazë të dhënash me çështjet gjyqësore, por publikimi i vendimeve gjyqësore mbetet i parregullt dhe nuk ka mjete kërkimi efektive. Gjykata e Lartë paraqet pak vendime unifikuuese të praktikës gjyqësore. Sistemi për njoftimin e palëve dhe dëshmitarëve nuk është aspak i përshtatshëm. Ligji për **Ndërmjetësimin** ofron një mekanizëm alternativ për zgjedhjen e mosmarrëveshjeve, por zgjidhja me ndërmjetësim ndodh rrallë.

Efienca

Kohëzgjatja e përgjithshme e procedurave duke filluar nga fillimi e deri tek dhënia e vendimit përfundimtar mbetet një shqetësim i madh. Nuk ka asnjë mekanizëm monitorimi efektiv, dhe sistemi është i paaftë të prodhojë të dhëna statistikore të besueshme. Në krahasim me vendet e përzgjedhura evropiane dhe standardin e “kohës së arsyeshme”, sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), Shqipëria ka proceset civile dhe penale më të gjata në Evropë. Tej zgjatja e proceseve vjen si pasojë e vonësive të gjata përpara gjykatave të apelit. Dispozitat e paqarta të Kodeve Civile dhe të Procedurës Penale ulin gjithashtu eficientësinë e gjykatave.

Norma e përfundimit të çështjeve, d.m.th. raporti ndërmjet rasteve të zgjidhura dhe rasteve të reja të regjistruara, është rritur gjatë viteve të fundit, por me disa dallime në varësi të llojit të gjykatës. Në vitin 2014, norma e përfundimit të çështjeve ishte nën 100% në Gjykatën e Lartë, në gjykatat administrative të shkallës së parë dhe ato të apelit, si dhe në gjykatat e shkallës së parë dhe apelit të rretheve, që lidhen me çështjet penale. Numri i çështjeve të **prapambetura** vijon të jetë i lartë, veçanërisht në gjykatat administrative dhe në Gjykatën e Lartë (numri ka ardhur në rritje nga 4,094 çështje për vitin 2011, në 12,000 për vitin 2014). Për vitin 2014, numri i përgjithshëm i çështjeve të prapambetura shkon në 30,600 çështje në shkallë të parë dhe të apelit, me 7.5% më pak se për vitin 2013.

Lufta kundër korrupsionit

Historiku

Historiku i të dhënave të **hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve** në rastet e korrupsionit mbetet e kufizuar. Deri më tani, ka shumë pak dënime të dhëna në shkallë të parë për **rastet e korrupsionit që përfshijnë zyrtarë shtetërorë të nivelit të lartë**. Është dënuar një gjykatës për shkaqe të lidhura me korrupsionin. Numri i dënimeve të formës së prerë që përfshijnë zyrtarë nivelit të ulët ose të mesëm është rritur vazhdimisht qysh prej vitit 2010, por në përgjithësi mbetet i ulët.

Një numër rastesh të profilit të lartë, ku ndër to pati raste të paraqitura nga mediat ku hidheshin dyshime për shkelje të kryera nga zyrtarë shtetërorë të nivelit të lartë, gjykatës, kryetarë të komunave dhe ish-ministra, kurrë nuk u hetuan në mënyrë serioze. Autoritetet politike duhet të garantojnë që organet e zbatimit të ligjit të jenë plotësisht të autorizuar për të vepruar në siç duhet dhe në mënyrë të paanshme gjatë hetimeve të pretendimeve për korrupsion. Nevoja për të forcuar mekanizmat e kontrollit dhe inspektimit në administratën publike është çështje urgjente.

Hetimet financiare ende nuk kryhen në mënyrë sistematike në rastet e korrupsionit. Ka shumë pak raste të **konfiskimit të pasurisë** në rastet e korrupsionit. Infiltrimi i krimit të organizuar në sektorët publik dhe privat, i ndihmuar nga korrupsioni, vazhdon të jetë një nga shqetësimet kryesore për të cilin duhet të jepet zgjidhje urgjente. **Ndikimi politik** mbi organet e zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit është një çështje problematike. Aktorët politikë shpesh kritikojnë hetimet në proces të korrupsionit dhe vendimet e gjykatave.

Numri dhe frekuenca e kontrolleve mbi **deklaratat e pasurisë** është rritur në vitin 2014. Megjithatë, shumë referime nuk po ndiqen penalisht. Deri më tani, ka pasur shumë pak raste që lidhjen me shkelje të **konfliktit të interesit**. Duhet të garantohet ndjekja e duhur e rasteve. Gjithashtu, duhet të garantohet një model kontrolli i pranueshëm për deklarimin e pasurive të zyrtarëve të lartë shtetërorë. Për sa i përket **financimit të partive dhe financimin e fushatës zgjedhore**, nuk ka të dhëna për kontroll efektiv, apo gjoba ndëshkuese për kundërvajtje. Arsimi, shëndetësia, gjyqësori, prokurimi publik, ndërtimit dhe planifikimit urban, dhe pushteti vendor vazhdojnë të jenë veçanërisht të pambrojtur ndaj korrupsionit.

Ligji për të drejtën e informimit, i miratuar në shtator 2014, është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ai ka filluar të zbatohet, me inspektimet që kryhen nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave, si dhe me vendimet e marra. Kuadri ligjor për e **denoncuesve** nuk është i përshtatshëm.

Kuadri institucional

Është krijuar Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, por përgjegjësitë për aspekte të ndryshme të politikës ndahen mes institucioneve individuale. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Parandalimin e Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) është tejet i rrezikuar nga ndikimet politike, dhe pavarësia dhe besueshmëria e tij duhet të forcohen duke bërë që kontributi i tij potencial të jetë me peshë në forcimin e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit.

Përveç Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ILDKPKI-së, ka edhe dy nivele të tjera të auditimit. Institucionet shtetërore kanë njësi të kontrollit të brendshëm, si element përbërës standard i kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik. Ndërsa Njësia e Kontrollit të Brendshëm dhe Anti-Korrupsionit pranë Këshillit të Ministrave (NJKBA) të mund të kryejë kontrolle në ministritë e linjës, institucionet nën varësi të Kryeministrit apo ministrave, dhe administratën nën varësi të prefektëve dhe në shoqëritë ku shteti zotëron të gjitha ose shumicën e aksioneve. NJKBA-ja ka për detyrë të kryejë kontrolle administrative mbi bazë ankese për dyshime për korrupsion, apo për praktika administrative abuzive dhe arbitrare, si dhe ka misionin të rrisë ndërgjegjësimin e autoriteteve publike.

Megjithatë, roli i NJKBA-së duhet të qartësohen akoma më shumë, dhe parandalimi i korrupsionit duhet të japë rezultate, pasi institucionet e përfshira janë të fragmentuara. Nuk ka sistem për vlerësimin e rrezikut bazuar në shkelje të dyshuara, apo auditive të institucioneve në përputhje me sistemet publike të kontrollit të brendshëm financiar. Sfera e veprimtarisë dhe kapaciteti i ILDKPKI-së duhet gjithashtu të forcohen; bashkëpunimi dhe shkëmbimi i të dhënave të saj me institucione të tjera ka nevojë të përmirësohet; dhe duhet të ngrihet një sistem elektronik për të menaxhuar konfliktin e interesit dhe deklarimet e pasurive. Në janar, Qeveria vuri në punë një portal që ofron shërbime në linjë për ankesat e korrupsionit, por sfera e tij e veprimtarisë dhe mekanizmat e referimit kanë nevojë të bëhen akoma më shumë të qarta.

Nuk ka standarde të qarta, të zbatueshme dhe publike për të sjelljen profesionale të deputetëve, dhe nuk ka as sistem për njoftimin rast pas rasti të konfliktit të interesave. Deklaratat e pasurive të deputetëve nuk bëhen automatikisht publike, dhe kontrollohen plotësisht çdo tre vjet.

Për sa i përket **zbatimit të ligjit**, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm qysh prej vitit 2007 për të ngritur një njësi të specializuara për të hetuar veprat penale që lidhen me korrupsionin në polici dhe prokurori. Në vitin 2014, janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të siguruar hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve që përfshijnë zyrtarë të lartë të shtetit.

Megjithatë, kuadri ligjor dhe institucional ka të mangësitë rëndësishme. Juridiksion mbi veprat penale të korrupsionit është i paqartë;burimet njerëzore dhe teknike janë të pamjaftueshme;mungon bashkëpunimi efektiv dhe besimi ndërmjet policisë dhe prokurorëve, dhe nuk ka bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni aq sa duhet me institucione të tjera. Gjykatat e zakonshme nuk janë të specializuara aq sa duhet për t'u marrë me raste të ndërlikuara që kanë të bëjnë me korrupsionin, dhe trajnimi i tyre nuk është i mjaftueshëm.

Sanksionet e vendosura në rastet e korrupsionit kanë prirje të jenë tepër të butë. Gjykatat kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për autorizimin e teknikave të posaçme të hetimit dhe për pranimin e provave të marra në mënyrë të paligjshme, të tilla si regjistrimet private. Vendimet e gjykatave shpesh janë të shkruara dhe argumentuara në mënyrë të dobët.

Nuk ka pengesa ligjore për sa i përket shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve. Megjithatë, kjo gjë nuk është aspak e lehtë dhe efikase në praktikë. ILDKPKI-ja ka nevojë të marrë qasje në bazat e të dhënave dhe burimet përkatëse, përfshirë këtu regjistrin e tokës dhe informacionin bankar, për të kontrolluar deklaratat e pasurisë. Policia dhe prokuroria duhet gjithashtu të kenë qasje të drejtpërdrejtë në një sërë bazash të dhënash publike për të qenë të afta të ndjekin rastet. Megjithatë, mosbesimi i ndërsjellë ndërmjet institucioneve vazhdon të jetë i dukshëm dhe pengon këtë qasje.

Kuadri ligjor

Korrupsioni në sektorin publik, përfshirë korrupsionin aktiv dhe pasiv, shpërdorimi i detyrës, korrupsioni në nivel të lartë, korrupsioni në sektorin privat, përfitimet e paligjshme nga posti publik dhe çështjet që lidhen me deklarimin e pasurive janë të gjitha të përcaktuara në Kodin Penal. kuadri ligjor kundër korrupsionit është shumë i ndërlikuar, dhe qëndrueshmëria e tij dhe siguria juridike janë cenuar nga ndryshime të shumta dhe të shpeshta, të cilat janë shpesh objekt interpretimi kontradiktor. Mekanizmat e qeverisë për marrjen e ndihmë, këshillimit ose trajnimit janë të kufizuara dhe procedurat për t'u përgjigjur shkeljeve të etikës nuk janë aspak efektive.

Reformat e zbatuara deri më tani nuk kanë dhënë rezultate të rëndësishme, apo të kenë ndryshuar perceptimin e publikut në lidhje me nivelin e shkeljeve nga ana e nëpunësve publikë. Duhet përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar ligjin me qëllim kryerjen e hetimeve më efektive, dhe për të qartësuar përkufizimin e termave “nëpunës i lartë i Shtetit” dhe “korrupsion në shkallë të gjerë”. Rregulloret ekzistuese kryesisht përqendrohen në ndalimin dhe kufizimin, në dëm të bërjes publike të informacionit dhe transparencës, gjë që kufizon efektin e tyre. Është e nevojshme të bëhen përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar zbatimin dhe për të siguruar që informacioni me interes për publikun të përhapej në momentin e duhur dhe në mënyrë efektive.

Vendi është palë në **Konventën e OKB-së kundër Korrupsionit**. Shqipëria nuk e ka kriminalizuar pasurimin e paligjshëm, por ka kriminalizuar refuzimin për të deklaruar pasurinë, mos-deklarimin, fshehjen e pasurive, dhe bërjen e deklaratave false nga ana e personave të zgjedhur, nëpunësit publikë dhe subjektet e tjerë që kanë detyrimin ligjor të deklarojnë pasuritë. Vendi ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventat përkatëse të Këshillit të Evropës për luftën kundër korrupsionit dhe Konventën e OECD-së për luftën kundër korrupsionit të nëpunësve publikë tëhuaj në transaksionet e biznesit ndërkombëtar. Shqipëria ka ende punë për të përafuar plotësisht kuadrin e saj ligjor me rekomandimet e bëra nga seancat e vlerësimit të Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër korrupsionit (GRECO) (shiko *Kapitullin 23- Gjyqësori dhe të drejtat*

themelore).

Kuadri strategjik

Qeveria ka përcaktuar se lufta kundër korrupsionit është një nga prioritetet e saj kryesore. Në mars, Shqipëria miratoi **strategjinë e saj kombëtare kundër korrupsionit** (periudha 2015-2020) dhe planin e veprimit (2015-2017), me një buxhet prej 12 milionë euro. Palët e interesuara, përfshirë shoqëria civile dhe komuniteti i biznesit, janë konsultuar gjerësisht. Janë përcaktuar afatet kohore dhe përgjegjësi të qarta, dhe mbahet përgjegjësi individuale për veprimet. Duhet ende të përmirësohen rezultatet dhe treguesit e ndikimit në analizën e fund-vitit të planit të veprimit.

Lufta kundër krimit të organizuar

Vendi ka arritur **një farë niveli përgatitje** në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar. Gjatë vitit të kaluar, është arritur **deri diku progres** për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e policisë, në veçanti, në luftën kundër trafikimit të drogës.

Megjithatë, bashkëpunimi ndërmjet prokurorisë dhe policisë duhet të zhvillohet më tej. Duhet të sigurohet ndjekja gjyqësore reale e rasteve të krimit të organizuar dhe cilësia e akteve të akuzës. Numri i dënimeve penale të formës së prerë mbetet i papërfillshëm në krahasim me vlerën e përllogaritur të tregut kriminal rajon dhe të brendshëm të drogës. Hetimet financiare përdoren pak, dhe niveli i pasurive të konfiskuara është i ulët.

Për të përmbushur prioritetin kyç në luftën kundër krimit të organizuar, për vitin që vjen, Shqipëria, në veçanti, duhet:

→ të dëshmojë progres të mëtjshëm me qëllim krijimin e një historiku të qëndrueshëm të hetimeve paraprake, ndjekjeve dhe dënimeve penale, përfshirë shpërbërjen e rrjeteve kriminale të përfshira në të gjitha format e krimit të organizuar;

→ të ndryshojë legjislacionin përkatës në fushën e përgjimeve dhe mbikëqyrjes, afatet kohore për hetimet, dhe pranueshmërinë e provave përpara gjykatës, me qëllim rritjen e efektshmërisë së hetimeve në rastet e krimit të organizuar, në përputhje me standardet evropiane dhe praktikatat më të mira;

→ të hartojë një politikë efektive për burimet njerëzore në Policinë e Shtetit Shqiptar dhe procesin e ngritjes në detyrë dhe transferimit të bazuar në merita, dhe të sigurojë burime të mjaftueshme për policinë dhe prokurorinë për të luftuar krimin e organizuar.

Historiku i të dhënave

Numri i dënimeve përfundimtare për krim të organizuar është ende shumë i ulët, dhe është rritur shumë pak gjatë viteve të fundit. Ka shumë pak raste **kundër trafikimit të qenieve njerëzore**, pavarësisht se Shqipëria është vend burimi, transiti dhe destinacioni për persona e trafikuar.

Gjatë pesë viteve të fundit më pak se 35 persona janë dënuar për **pastrim parash** dhe asnjë gjatë gjysmës së parë të vitit 2015, megjithëse janë regjistruar 123 procedime dhe dy raste i janë dërguar gjykatës. Nuk janë përdorur prova rrethore, të tilla si rastet e pasurisë së pajustificuar, rritja e pajustificuar e pasurisë ose operacionet e jashtëzakonshme financiare. Hetimet penale shpesh kanë një sferë të ngushtë veprimi dhe personat juridikë janë hetuar shumë rrallë.

Hetimet financiare që kanë në shënjestër persona të dyshuar si anëtarë të grupeve të organizuara kriminale nuk zhvillohen në mënyrë sistematike dhe efektive. Marrja e **masave paraprake për ngrirjen e pasurisë** zbatohet rrallë gjatë fazës fillestare të hetimit. Të ardhurat nga veprimtaritë kriminale shpesh zhduken, duke rezultuar në një historik të varfër të konfiskimit të pasurive në momentin e dhënies së dënimit përfundimtar. Më pak se 50% të rasteve të krimit të organizuar çuar në konfiskimin e pasurisë përtej atyre që gjendeshin në momentin e arrestimit të të dyshuarit.

Rrjedhjet e informacionit në shtyp, shkelja e sekretit të hetimeve dhe vënia në rrezik e sigurisë së policisë, janë të shpeshta.

Kapaciteti institucional dhe operacional

Policia e Shtetit Shqiptar ka 9,997 oficerë policie, 228 për 100,000 banorë. Menaxhimi i burimeve njerëzore është përmirësuar, ndërkohë që strukturat e saj komanduese dhe kapacitetet kanë nevojë të konsolidohen. Është e nevojshme të ulen normat e larta të largimit të personelit, veçanërisht në radhët e oficerëve të policisë me përvojë që shpesh janë trajnuar me mbështetjen ndërkombëtare.

Për të luftuar krimin ekonomik dhe financiar, krimin kibernetik, parandalimin e terrorizmit, trafikimin e drogës dhe qenieve njerëzore, mjeteve motorike, veprave të artit, armëve, eksplozivëve, mbrojtja e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, dhe bashkëpunimi për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare **ka njësi të specializuara**. Njësitë e përbashkëta të hetimit kanë nevojë të zhvillojnë më tej kapacitetet e tyre të burimeve njerëzore. Hetimet efektive shpesh rrezikohen nga ndryshime të shpeshta në radhët e oficerëve të policisë gjyqësore dhe nga mungesa e personelit të specializuar në çështjet financiare dhe fiskale. Niveli i përgjithshëm i pajisjeve dhe logjistikë në policisë mbetet një çështje shqetësuese.

Bashkëpunimi ndërmjet prokurorisë dhe policisë ka nevojë të përmirësohet më tej. Kapaciteti i dobët i policisë gjyqësore dhe prokurorëve për të zbuluar dhe hetuar rastet penale të ndërlikuara nënkupton se ata mund të kryejnë vetëm hetime të thjeshta që përfundojnë me arrestimin në flagrancë, gjë që tregon se nuk ka një qasje gjithëpërfshirëse për hetimet dhe ndjekjen penale. Organet për zbatimin e ligjit janë tejet të centralizuara, duke sjellë si pasojë standarde të dobëta të hetimit në zonat e thella të vendit. Kapaciteti për të përdorur mjete hetimore të posaçme është i kufizuar. Procedurat e gjata dhe formale për të marrë madje edhe informacionin bazë gjatë hetimeve, shkaktojnë vonesa të konsiderueshme dhe rrezikojnë fshehtësinë e procesit. Në polici dhe prokurori mungojnë burimeve të mjaftueshme për të luftuar krimin e organizuar.

Pas lidhjes së një marrëveshje operationale me Europolin, shkëmbimi i informacionit është rritur ndjeshëm. Shqipërisë i është dhënë qasje në rrjetin për shkëmbimin e sigurt të informacionit (SIENA). Në vitin 2014, janë shkëmbyer 1026 mesazhe përmes programit SIENA, në krahasim me 216 të kryera në vitin 2013, duke sjellë një rritje me rreth 375%.

Policia mbledh dhe përpunon në mënyrë manuale statistika mbi krimin, proces i cili është i rëndë dhe minon besueshmërinë të të dhënave. Buxheti i sektorit të ADN-së, pranë Drejtorisë së Mjekësisë Ligjore, pavarësisht nga rritja e fundit, është i pamjaftueshëm për të mbuluar shpenzimet për mbledhjen e ADN-së, duke kufizuar kështu aftësinë për të kryer profilizimin ADN-së.

Kuadri ligjor

Ligji i ri për Policinë e Shtetit, i cili hyri në fuqi në mars, është në pajtim me rekomandimet kryesore të Kodit Evropian të Këshillit të Evropës për Etikën në Polici. Dënimet penale nuk janë bindëse aq sa duhet. Duhet të trajtohen një sërë mangësish të fazës së hetimeve, përfshirë afatet kohore për hetimet paraprake dhe procedurat për përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit. Ligji për konfiskimin e pasurive të vëna nga veprimtaritë kriminale është pjesërisht i përafuar me *acquis*-in. Është e nevojshme të përafrohet procedura për konfiskimin e pasurisë së palëve të treta, konfiskimi i zgjeruar dhe ngrirja paraprake e pasurisë. Ndryshimet e shpeshta dhe interpretimi kontradiktor kanë cenuar sigurinë ligjore. Rekomandimet e Task Forcës për Veprimin Financiar janë pasqyruar në legjisllacionin kundër pastrimit të parave. Megjithatë, është e nevojshme që të trajtohen mangësitë, si ato që lidhen me zbatimin dhe ato në lidhje me qasjen e policisë në bazat e të dhënave publike. Ndryshimet për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë në ligjin për luftën kundër mafias mbeten akoma për tu miratuar.

Kuadri strategjik

Është miratuar strategjia ndërinstitucionale e rishikuar për periudhën 2013-2020 dhe plani i

veprimet për luftën kundër krimit të organizuar, luftën kundër terrorizmit dhe trafikimin e jashtëligjshëm. Në qershor, Shqipëria miratoi një vlerësim kombëtar të rrezikut nga krimet e rënda dhe të organizuara (SOCTA). Analistë të policisë shqiptare janë trajnuar nga Europol në qershor duke përgatitur kështu kapacitetet e nevojshme për të përafuar vlerësimin kombëtar të rrezikut nga krimet e rënda dhe serioze me metodologjinë e SOCTA të BE-së. Megjithatë, Shqipëria përdor shumë pak produktet strategjike të inteligjencës së Europolit.

Lufta kundër terrorizmit

Shqipëria është prekur nga fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë dhe radikalizmi. Rastet e gjuhës së urrejtjes duhet të trajtohen akoma më shumë. Fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë duhet të zgjidhet me anë të një qasje të veçantë nga organet e inteligjencës dhe ato të zbatimit të ligjit, dhe nëpërmjet një politike gjyqësore koherente për shkelësit. Ndërkohë që, është përmirësuar në një masë të madhe bashkëpunimi ndërkombëtar, si në nivel operacional ashtu edhe strategjik, duhet ende të hartohen mekanizma për parandalimin ku të përfshihet shoqëria civile dhe bashkësitë fetare.

2.4 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve

Gjendja e përgjithshme

Kuadri ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është gjerësisht në pajtim me standardet evropiane. Megjithatë, mbetet ende i kufizuar zbatimi dhe i pamjaftueshëm realizimi në praktikë i të drejtave të njeriut.

Ka mangësi, veçanërisht në fushat e mëposhtme:

- ekzekutimi i të drejtave të pronësisë duhet të garantohet. Procesi për regjistrimin, kthimin dhe kompensimin e pronës nuk kanë përfunduar.
- komunitetet Rome dhe egjiptiane përballen me kushte tejet të vështira të jetesës dhe përjashtimin dhe diskriminimin e shpeshtë social për shkak të zbatimit të politikave joefektive dhe bashkëpunimit të dobët ndër-institucional; mbetet ende për tu ngritur një jurisprudencë e qëndrueshme kundër diskriminimit;
- mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës mbeten ende të dobët; sistemi i drejtësisë për të miturit nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare;

Për të përmbushur prioritetin kyç në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për vitin që vjen, Shqipëria, në veçanti duhet të bëjë progres të mëtjeshëm në lidhje me zbatimin e strategjisë për periudhën 2012-2020 për të drejtat e pronësisë, dhe procesin e regjistrimit, kthimit dhe kompensimit të pronës; përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve dhe egjiptianëve; të dëshmojë se po ecën përpara me krijimin e precedentit pozitiv kundër diskriminimit; dhe të shtojë përpjekjet që legjislacioni për drejtësinë e të miturve të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Më poshtë paraqitet një analizë e detajuar për lirinë e shprehjes. Për një analizë të hollësishme të zhvillimeve në të drejtat e tjera të njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve, shiko *Kapitullin 23- Gjyqësori dhe të drejtat themelore*. Për zhvillimet në fushat e të drejtave sindikale, mos-diskriminimin dhe mundësive të barabarta, shiko, gjithashtu, *Kapitullin 19- Politika sociale dhe punësimi*.

Liria e shprehjes

Vendi ka arritur **një farë niveli përgatitje** në drejtim të lirisë së shprehjes. Gjatë vitit të kaluar, është arritur **deri diku progres**.

Kushtetuta dhe legjislacioni përkatës është në pajtim me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke garantuar liritë e individit. Mjedisi, në përgjithësi, është kryesisht i favorshëm për

ushtrimin e të drejtës së shprehjes, por është i nevojshëm një zbatim më i mirë i legjislacionit. Për të trajtuar mangësitë e paraqitura më poshtë, për vitin që vjen, Shqipëria, në veçanti, duhet:

→ të rrisë transparencën e reklamave të qeverisë në media;

→ të garantojë që legjislacioni ekzistues të zbatohet në praktikë në mënyrën që siguron barazinë përpara ligjit;

→ të forcojë më tej pavarësinë e autoritetit rregullator dhe radio televizionit publik, kryesisht, me anë të krijimit të këshillit mbikëqyrës të RTSH-së dhe emërimin e krerëve të lartë drejtues.

Frikësimi i gazetarëve

Sulmet fizike ndaj gazetarëve janë të rralla. Raportohet një rast i mbetur në tentativë kundër jetës së një gazetari, megjithëse, ende nuk është konfirmuar nëse kjo tentativë është e lidhur me ushtrimin e profesionit të tij. Një gazetar tjetër është kërcënuar dhe është marrë në mbrojtje nga policia. Policia dhe autoritetet përkatëse kanë reaguar menjëherë, dhe hetimet janë në proces. Por duhet të garantohet ndjekja e duhur gjyqësore. Ka pasur raste kur, disa politikanë kanë bënë deklarata armiqësore kundër gazetarëve.

Kuadri ligjor

Kushtetuta dhe legjislacioni përkatës janë në përputhje me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, duke garantuar liritë individuale, përfshirë këtu edhe të drejtën e privatësisë, lirinë e shprehjes dhe sanksionet kundër nxitjes së urrejtjes. **Shpifja** është vepër penale, pavarësisht se nuk parashikohet dënimi me burgim si ndëshkim për to. Gazetarët janë të ekspozuar ndaj gjobave dhe dëmeve potencialisht të mëdha. Rregullat mbi gjuhën e urrejtjes janë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare. Megjithatë, vendimet e gjykatave vendase, për çështje të gjuhës së urrejtjes, nuk monitorohen. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrënjë sërë vendimesh dhe ka dhënë rekomandime në rastet që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes. Ligji i ri për **të drejtën e informimit**, i miratuar në shtator 2014, është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Propozimet e fundit, për ndryshimin e Kodit Civil dhe Ligjit për mediat audiovizive, me qëllim filtrimin e komenteve fyese dhe heqjen e kufizimeve ekzistuese për zotërimin e medias audiovizive, mund të kufizojë lirinë e shprehjes.

Zbatimi i legjislacionit/ institucionet

Ligji i vitit 2013 për median audiovizive transformoi Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit në **Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA)**. Procedura për emërimin e anëtarëve të bordit të AMA-s, e cila bazohet në mbështetjen politike qoftë të shumicës qeverisëse apo të opozitës, nuk garanton plotësisht pavarësinë e tyre. Anëtarët e rinj dhe drejtori i AMA-s u emëruan në vitin 2014. Opozita kundërshtoi në gjykatë procesin e përzgjedhjes, duke pretenduar se emërimet, të miratuara vetëm me votat e shumicës qeverisëse, janë të pavlefshme dhe në kundërshtim me ligjin. Anëtarët e AMA-s të emëruar nga opozita nuk morën pjesë në mbledhjet e bordit të AMA-s, duke vënë kështu në dyshim legjitimitetin e bordit të saj. Kjo e ka bërë të vështirë që Bordi të arrijë në kuorumin e nevojshëm për të marrë vendime kryesore. Përmbajtja dhe regjistrimi i faqeve në internet nuk janë të rregulluara me ligj.

Radio televizioni publik

Rregullorja e radio televizionit publik, RTSH-së, është në përputhje me standardet e BE. **Financimi** është kryesisht i pavarur nga qeveria. Mbledhja e taksës së RTSH-së është përmirësuar me arkëtimin e faturave të energjisë elektrike, ku mbledhet edhe taksa e RTSH-së. Zgjedhja e Këshillit Drejtues të RTSH-së është vonuar nga bllokimi politik dhe një padi e ngritur nga opozita. RTSH-ja duhet të miratojë tashmë statutin e saj, si dhe udhëzime të tjera të nevojshme, dhe të zgjedhë një drejtor të ri.

Faktorët Ekonomikë

Transparenca në drejtim të pronësisë së medias është përmirësuar. Në faqen zyrtare në internet të **Qendrës Kombëtare të Regjistrimit**, qytetarët mund të kontrollojnë aksionarët e çdo shoqërie të regjistruar. Gjithsesi, mënyra se si funksionon tregu i medias mbetet ende i errët, me një numër mediash që mbijetojnë në një treg relativisht të vogël, me burime të kufizuara. Transparenca e **reklamave të qeverisë** në media duhet të përmirësohet. Media vazhdon të përdoret si një mjet për të nxitur interesat politike dhe private.

Sindikatat profesionale, kushtet profesionale

Kapaciteti i sindikatës së gazetarëve mbetet i dobët, pavarësisht se ajo ka intensifikuar përpjekjet e saj për të ngritur degë në shumë qytete në vend. Standardet profesionale dhe etike në gazetari kanë nevojë të forcohen. Mbrojtja nga shkarkimi arbitrar duhet të garantohet për gazetarët, për të parandaluar auto censurën. Duhet të merren masa të mëtejshme për të siguruar zbatimin korrekt të drejtave të punës, veçanërisht, të drejtat e stafit të medias për të patur një kontratë pune formale dhe të drejtën e pagesës së kontributeve shoqërore.

2.5 Problemet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare

Shqipëria vazhdon të mbajë në fuqi një marrëveshje dypalëshe për imunitetin të vitit 2003 me Shtetet e Bashkuara, e cila përjashton shtetasit e SHBA-ve nga juridiksioni i Gjykatës Penale Ndërkombëtare. Duke vepruar kështu, ajo nuk është në pajtim me qëndrimet e përbashkëta të BE-së mbi integritetin e Statutit të Romës apo me parimet drejtuese të BE-së për marrëveshjet dypalëshe të imunitetit. Është e nevojshme që Shqipëria të jetë në një linjë me qëndrimin e BE-së.

Për sa i përket **bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore**, Shqipëria është aktive në nismat rajonale dhe luan një rol proaktiv. Ajo mbajti mandatin njëvjeçar të drejtimit të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Jug-Lindore (SEECP). Në vitin 2014, Shqipëria përfundoi mandatin një vjeçar të presidencës së saj të Kartës SHBA-Adriatik (A5). Shqipëria vijon të marrë pjesë në misionin EUFOR/ALTHEA në Bosnje dhe Hercegovinë, dhe në të gjitha ngjarjet që kanë të bëjnë me zbatimin e projekteve të gazsjellësit Trans-Adriatik dhe gazsjellësit Jon-Adriatik.

“**Procesi i Berlinit**” dhe 6 nismat e Ballkanit Perëndimor i dhanë një shtysë të re bashkëpunimi rajonal duke intensifikuar bashkëpunimin ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe ato me BE-në, veçanërisht në drejtim të **axhendës së lidhjes mes vendeve**. Në prill, 6 vendet e Ballkanit Perëndimor arritën në një marrëveshje për rrjetin kryesor të transportit, dhe, në qershor 2015, për zgjerimin e tre korridoreve kryesore të transportit trans-evropian në Ballkanin Perëndimor. Ato identifikuan, gjithashtu, projekte me prioritet përgjatë seksioneve të këtyre korridoreve që do të zbatohen brenda vitit 2020. Për të garantuar qëndrueshmërinë dhe, gjithashtu, për të arritur rezultate në terma afat-shkurtër, vendet ranë dakord të zbatojnë, përpara samitit të ardhshëm të Parisit, një sërë masash “të buta”, të tilla si përafrimi dhe thjeshtimi i procedurave për kalimin e kufirit, sigurisë rrugore dhe skemat e mirëmbajtjes.

Shqipëria është një partner konstruktiv në rajon, duke zhvilluar më tej **marrëdhënie të forta bilaterale** me vendet e tjera që po përgatiten të hyjnë në BE, dhe me shtetet fqinje, anëtare të BE-së. Shqipëria ka filluar tashmë negociatat me Malin e Zi dhe Serbinë, në lidhje me marrëveshjen dypalëshe për bashkëpunimin rajonal, në bazë të nenit 13 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Marrëdhëniet me **Bosnjen dhe Hercegovinën** janë të mira. Nuk ka çështje të hapura bilaterale. Shqipëria dhe Bosnja Hercegovina nënshkruan, në korrik, një marrëveshje, e cila lejon qytetarët e tyre të udhëtojnë ndërmjet dy vendeve vetëm me kartë identiteti.

Marrëdhëniet me **ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë** janë të mira, dhe zhvillohen shpesh vizita zyrtare të nivelit të lartë. Qeveria ka reaguuar ndaj ngjarjeve të majit në Kumanovë, duke bërë thirrje për qetësi, transparencë dhe zbatimin e plotë të Marrëveshjes Kuadër të Ohrit. Në janar, u nënshkrua një memorandum mirëkuptimi për mbrojtjen. Ndërkohë që në mars, u nënshkrua një marrëveshje për të njohur në mënyrë reciproke skemat përkatëse të sigurimeve shoqërore, dhe një

protokoll për bashkëpunimin në fushën e kulturës për periudhën 2015- 2020. Në gusht, Shqipëria miratoi një grant prej 50,000 euro për ndihma humanitare për të zbutur dëmet e përmbytjeve në Tetovë.

Marrëdhëniet me *Malin e Zi* janë të mira. Në shkurt, u nënshkrua një marrëveshje dypalëshe për bashkëpunimin ekonomik. Shqipëria ka shprehur vazhdimisht mbështetjen e saj për anëtarësimin e Malit të Zi në NATO. Gjatë vitit u zhvilluan dy vizita të nivelit të lartë.

Marrëdhëniet me **Kosovën**³ janë të mira. Në pikën e kalimit kufitar Morinë, janë krijuar procedura të përbashkëta doganore. Në mars, në takimin e dytë të përbashkët ndërmjet qeverive, u nënshkruan 12 marrëveshje, memorandume dhe protokolle bashkëpunimi, për bashkëpunimin dhe sigurinë, kontrollin kufitar, arsimin, bujqësinë, tregtinë dhe zhvillimin rural. Shqipëria ka mbështetur fuqishëm procesin e integritit të Kosovës dhe anëtarësimin e saj në nisma rajonale dhe në organizata ndërkombëtare. Shqipëria mbështet dialogun e vazhdueshëm ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të lehtësuar nga BE-ja.

Marrëdhëniet me *Serbinë* janë intensifikuar dhe, në përgjithësi, janë konstruktive. Në tetor, incidenti i ndodhur gjatë një ndeshje futbolli të luajtur në Beograd ndërmjet dy skuadrave kombëtare, tensionoi marrëdhëniet dypalëshe. Vizita e mëvonshme e Kryeministrit shqiptar në Beograd, i pari në 68 vjet, shënoi një hap të rëndësishëm përpara për normalizimin e marrëdhënieve dhe u pasua nga një vizitë e kryeministrit serb Vuçiç në maj. Shqipëria dhe Serbia paraqitën një propozim të përbashkët në projekte konkrete për lidhjen ndërmjet vendeve, në Samitin e Ballkanit Perëndimor, të mbajtur në prill në Bruksel. Ministrat serb dhe shqiptar për punët e jashtme morën pjesë në një takim të parë trepalësh me homologun e tyre italian, në Romë.

Shqipëria mban marrëdhënie të ngushta me *Turqinë*. Në maj, u nënshkrua një marrëveshje partneriteti strategjik për ndihmën e ndërsjellë dhe bashkëpunimin në luftën kundër krimit të organizuar dhe luftën kundër terrorizmit. Janë zhvilluar vizita të shpeshta të nivelit të lartë, përfshirë edhe vizitën e Presidentin turk Erdogan në maj.

Marrëdhëniet me *Greqinë* kanë qenë përgjithësisht pozitive, dhe janë bërë edhe më të ngushta në drejtim të sundimit të ligjit, me anë të takimeve të përbashkëta në rang përfaqësuesish të ministrive të brendshme për të ngritur bashkëpunimin në çështjet e migracionit. Bisedimet për disa çështje dypalëshe, përfshirë marrëveshjen për delimitimin e shelfit kontinental greko-shqiptar dhe zonave detare, vazhdojnë ende.

Marrëdhëniet me *Italinë* mbeten shumë të forta, veçanërisht në sektorin e tregtisë. Marrëdhëniet diplomatike janë shumë të mira. Në dhjetor, u nënshkrua një protokoll bashkëpunimi dypalësh për periudhën 2014-2016, duke u përqendruar në zhvillimin e sektorit privat, bujqësisë dhe zhvillimit rural e social.

3. KRITERET EKONOMIKE

Shifrat kyçe ekonomike	2013	2014
Prodhimi i brendshëm bruto për banorë (në % e BE28 në treguesin e standardit të fuqisë blerëse)	28	29
Rritja e PBB-së(%)	1.1	2.1
Norma e papunësisë (femra; meshkuj)(%)	15.9 (13.5;17.8)	17.5 (15.2;19.2)
Norma e aktivitetit ekonomik për person nga mosha 20-64 vjeç; përqindja e popullsisë në moshat 20-64 vjeç, ekonomikisht aktiv (femra,	67.6 (57.6;79.2)	68.6 (57.3;80.5)

³ Ky përcaktim nuk cenon qëndrimet mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/99 dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

meshkuj) (%)		
Bilanci i llogarisë korente (% e PBB)	-10.8	-13.1
Investimet e huaja të drejtpërdrejta (IHD) (% e PBB-së)	9.6	8.1

Burimi: Eurostat

Sipas përfundimeve të Këshillit Evropian në Kopenhagen, në qershor 1993, anëtarësimi në BE kërkon pasjen e një ekonomie tregu funksionale dhe kapacitetin për të përballuar presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian.

Monitorimi i këtyre kriterëve ekonomike duhet parë në kontekstin e rritjes së rëndësisë të qeverisjes ekonomike në procesin e zgjerimit. Për të përmirësuar qeverisjen ekonomike përkatëse, vendeve të zgjerimit iu kërkua, në vitin 2015, të përgatisin Programet e Reformës Ekonomike (PRE-të), të cilat përcaktojnë një kuadër afatmesëm të politikave makro-fiskale, së bashku me reformat kryesore strukturore që synojnë të mbështesin kuadrin dhe të rrisin aftësinë konkurruese. PRE-të përbëjnë bazën e rekomandimeve specifike të vendit, të miratuara në mënyrë të përbashkët nga BE-ja dhe vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqia, në takimin e mbajtur në 12 maj 2015 për Dialogun Ekonomik dhe Financiar.

3.1 Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

Shqipëria është e **disi e përgatitur** për të zhvilluar një ekonomie tregu funksionale. Është arritur **një farë mase progresi**, veçanërisht në përmirësimin e stabilitetit makroekonomik. Megjithatë, mbeten ende sfida të mëdha, në veçanti, nevoja për të ulur barrën e borxhit publik. Perspektivat e rritjes janë përmirësuar, por janë ende të dobëta nga huamarrja e kufizuar bankare. Konkurrenca e ekonomisë shqiptare është e dobët duke patur një normë të ulët eksporti dhe prodhimi. Sektori privat ka mbetur mbrapa për shkak të mangësive të theksuara në kuadrin rregullator dhe sundimin e ligjit. Norma e papunësisë dhe punësimi joformal mbeten akoma të larta.

Në përputhje me rekomandimet e PRE-së dhe për të mbështetur rritjen afatgjatë, për vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:


- mbështetjes së konsolidimit fiskal dhe fuqizimit të kuadrit të menaxhimit të buxhetit;
- zgjidhjes së nivelit të lartë të kredive me probleme;
- përmirësimit të klimës së biznesit duke vënë në zbatim reformat rregullatore dhe miratimin e ligjit të ri për falimentin.


Elementet thelbësore të politikës ekonomike

Qeveria ka dëshmuar se ka marrë zotimin të reformojë dhe zbatojë politikat makroekonomike drejt stabilitetit, në një mjedis politik sfidues. Shqipëria dorëzoi, në janar 2015, Programin e saj të Reformës Ekonomike, i cili mbulon periudhën 2015-2017. Objektivat e programit janë arritja e stabilitetit makroekonomik, heqja e pengesave për rritjen dhe përmirësimi i aftësisë konkurruese. Projektimet afatmesme makroekonomike të PRE-ve synojnë një përshpejtim të mtejshëm të rritjes dhe vazhdimin e konsolidimit fiskal mbi bazën e politikave të orientuara drejt stabilitetit. Shqipëria ka nevojë të ndjekë zotimet e saj dhe të marrë masa të mtejshme për të zbatuar rekomandimet e PRE-ve, të përcaktohen më poshtë. Marrëveshja financiare tre-vjeçare me Fondin Monetar Ndërkombëtar, e arritur në shkurt 2014, mbështet forcimin e stabilitetit makroekonomik dhe reformat e për nxitjen e rritjes.

Stabiliteti makroekonomik

Aktiviteti ekonomik pati rritje në vitin 2014 për shkak të përmirësimit të kërkesës së brendshme private. Norma e rritjes arriti në vitin 2013 nivelin më të ulët të 15 viteve, me vetëm 1.1%. Megjithatë, në vitin 2014, rritja u rimëkëmb në rreth 2.1%, pasi ulja e normës së interesit nga Banka Qendrore përmirësoi kushtet e financimit, duke rritur dërgesat nga emigrantët dhe inflacioni i ulët çoi në rritjen e shpenzimeve për familje; ndërkohë që shlyerja e një pjese të madhe të borxheve të Qeverisë përmirësuan likuiditetin e firmave dhe besimin. Rritja ekonomike vjetore arriti në 2.8% në tremujorin e parë të vitit 2015, pjesërisht falë një rritje të fortë të investimeve. PBB për frymë në treguesin e standardit të fuqisë blerëse qëndron me vetëm 29% të mesatares së BE-28 në vitin 2014 (e pandryshuar që nga viti 2009), duke nxjerrë në pah nevojën për të gjeneruar norma më të larta rritjeje për të arritur drejt standardeve të jetesës të BE-së.





Deficiti i llogarisë korente është nga ana strukturore i lartë, por financimi i tij është i shëndetshëm, dhe mbështetet kryesisht në flukset e parasë që nuk krijojnë borxh. Në përgjithësi, deficiti i llogarisë korente u rrit në 13.1% të PBB-së në vitin 2014 nga 10.8% në vitin 2013. Deficiti tregtar u rrit në 18.8% të PBB-së në vitin 2014, pas ngushtimit në vitin 2012 dhe 2013. Kjo erdhi si rezultat i importeve të larta për shkak të rikuperimit të kërkesës së brendshme, pavarësisht se u rritën edhe eksportet, në veçanti veshmbathjet dhe këpucët. Stoku në rritje i investimeve të huaja ka sjellë si rezultat riatdhesimin e lartë të të ardhurave të

investimeve. Rënia afatgjatë e dërgesave të emigrantëve u përmbys në vitin 2014, por në raport me PBB-në, ato mbeten shumë më poshtë nivelit të arritur përpara krizës globale të vitit 2008.

Gjatë periudhës 2009-2014, rreth dy të tretat e flukseve financiare neto në ekonomi përbëhej nga investimet e huaja të drejtpërdrejta (IHD). Borxhi i jashtëm arriti në rreth 68% të PBB-së në fund të vitit 2014, ku borxhi afatgjatë përbënte më shumë se 80% të totalit, kryesisht në formën e huamarrjes së qeverisë dhe huadhënies ndërmjet shoqërive. Ky profil borxhi nuk krijon shqetësime në lidhje me mundësitë e ri-financimit. Për më tepër, rezervat zyrtare në valutë, të cilat mbulojnë rreth 5.3 muaj importe dhe që arrijnë në shumën pothuajse sa dyfishi i stokut të borxhit të jashtëm afatshkurtër në tremujorin e parë të vitit 2015, siguron mbrojtjen e duhur kundër goditjeve negative. Për të zgjidhur problemin e deficitit të vazhdueshëm të llogarisë rrjedhëse, Shqipëria ka nevojë të bëjë më të larmishme ekonominë e saj dhe të përmirësojë produktivitetin duke tërhequr kapital të huaj, ndër të tjera, në sektorët e tregtisë.

Papunësia mbetet e lartë, pavarësisht nga një rritje në normën e punësimit. Punësimi, në përputhje me rimëkëmbjen ekonomike, u rrit në 1.6%, por për shkak të rritjes së fuqisë punëtore, shkalla e papunësisë u rrit nga 15.9% në 17.5% në vitin 2014, përpara se të binte në 17.3% në tremujorin e dytë të vitit 2015. 56.6% e popullsisë në moshë pune ishin të punësuar në vitin 2014, pothuajse e pandryshuar nga viti 2013. Megjithatë, mbizotërimi i papunësisë afatgjatë dhe papunësisë së të rinjve dhe dallimet e mëdha gjinore në pjesëmarrjen e fuqisë punëtore tregojnë pengesa të rëndësishme strukturore. Gati një e treta e të punësuarve janë anëtarë pa pagesë të familjes (kryesisht në bujqësi) dhe punësimi joformal vazhdon të jetë i përhapur. Kjo gjë ndikon në sigurinë e punës, të drejtën për të gëzuar sigurime shoqërore dhe pengon zhvillimin e shoqërive. Është arritur një farë mase progresi në drejtim të forcimit të politikave të tregut të punës, në pajtim me strategjinë kombëtare të punësimit dhe aftësisimit për periudhën 2014-2020, të miratuar në nëntor të vitit 2014. Megjithatë, duhet bërë ende më shumë për të përmirësuar funksionimin e shërbimit kombëtar të punësimit, forcimin e programeve për nxitjen e punësimit, modernizimin e shërbimeve të trajnimit dhe zhvillimin e një sistemi koherent të informacionit mbi tregun e punës.

Inflacioni vijon të jetë i dobët, duke lejuar Bankën Qendrore të ulë normën bazë të interesit. Inflacioni mesatar vjetor mbeti nën objektivin me 3% të Bankës së Shqipërisë (BSH) si në vitin 2013 (në 1.9%) dhe 2014 (në 1.6%). Kjo ka ardhur si pasojë e ushtrimit të aktivitetit ekonomik nën potencialin e tij, inflacionit të ulët tek partnerët e tregtisë dhe një norma e qëndrueshme e këmbimit kundrejt euros. Gjatë shtatë muajve të parë të vitit 2015, inflacioni ishte i paqëndrueshëm si pasojë e përmblytjeve që përkohësisht ndërprejnë prodhimet bujqësore dhe rritën çmimet e ushqimeve. Megjithatë, ai mbeti mesatarisht shumë poshtë normës së synuar. Inflacioni vazhdimisht i ulët lejo që Banka e Shqipërisë të ulte normën bazë të interesit me disa nivele duke arritur në një masë të ulët të re historike prej 2% në janar 2015, duke u përpjekur të nxisë aktivitetin ekonomik dhe të çojë inflacionin drejt objektivit. Banka e Shqipërisë ka arritur sukses me uljen e normave të interesit të tregut dhe mbështetjen që i dha rritjes së kredihënies,

pavarësisht se rritja e rrezik për bankat pengoi kalimin e stimujve monetar në ekonomi. Shkalla në të cilën sistemi financiar përdor monedhën euro u ul, por, gjithsesi, mbetet e lartë. Kjo përfshin rrezikun e kredive në rast të ndryshimeve të menjëhershme në kursin e këmbimit dhe zvogëlon hapësirën për manovrim të politikës monetare.

Buxheti, në vitin 2014, pati një performancë të mirë, por të ardhurat nuk arritën objektivin për gjysmën e parë të vitit 2015.


Rezultati i deficitit për vitin 2014, në 5.2% PBB-së së llogaritur për vitin plotë, mbetet shumë poshtë objektivit fillestar në 6.6%. Të ardhurat u rritën me 12.1%, si rrjedhojë e rritjes së taksave dhe përpjekjeve me sukses për të përmirësuar mbledhjen e taksave. Njëkohësisht, shpenzimet totale ishin 3.9% më poshtë se ato të parashikuara në buxhet për shkak të investimeve dhe shpenzimeve publike pa rezultate. Në vitin 2014 buxheti duhej gjithashtu të financonte shlyerjen e borxheve të qeverisë ndaj bizneseve, të cilat arrinin në 2.4% të PBB-së.

Rekomandimi nr.2 i PRE-ve: “Të arrihet progres në drejtim të eliminimit të rreziqeve të larta fiskale që vijnë nga sektori i energjisë elektrike, duke ulur me 5% humbjet në shpërndarje për vitin të

Rekomandimi PRE-ve nr. 1: “Të arrihet konsolidimi fiskal në pajtim me objektivin për të çuar raportit e borxhit publik drejt rënies dhe ta ulur atë në më pak se 66% të PBB-së në vitin 2017. Njëkohësisht, të ruhet hapësira fiskale për investime publike që nxisin rritjen, duke siguruar që performanca e të ardhurave të mbetet në rrugën e duhur, dhe duke lejuar që shpenzimet kapitale fillestare të pasqyruara në buxhet të kryhen.”

Pa këtë shpenzim të jashtëzakonshëm, buxheti aktual reflektonte një suficit primar të vogël për herë të parë qysh prej vitit 2010. Në gjysmën e parë të vitit 2015, të ardhurat nga tatim-taksat ishin nën nivelin e objektivave, kryesisht për shkak të supozimeve më tepër optimiste seç duhej për rritjen e të ardhurave, inflacionit më të ulët nga sa pritej, dhe rënies në çmimet e naftës. Buxheti u rishikua në korrik, dhe objektivat për të ardhurat u ulën, por falë kursimeve nga pagesat e interesit dhe shpenzimeve tejet të ulëta në investime, objektivi i përgjithshëm i deficitit u mbajt i pandryshuar në 4% të PBB-së (ku përfshihet edhe pagesa e borxheve të prapambetura me vlerën 1.3% të PBB-së). Parashikimet më tepër optimiste nga sa duhej për të ardhurat nga tatim-taksat dhe shpenzimi në investime janë probleme të përsëritura, të cilat është e nevojshëm të trajtohen.

Niveli i lartë i borxhit publik, gati sa gjysma e borxhit afat-shkurtër, mbetet një burim kryesor i rrezikut makroekonomik. Borxhi publik është rritur ndjeshëm në 71.8% të PBB-së për vitin 2014, nga 55.1% që ishte në vitin 2008, në prag të ngadalësimit ekonomik. Një përqindje e madhe e borxhit afatshkurtër kthehet në ekuivalentin e borxhit me rreth 20% të PBB-së që duhet të shtyhet për çdo vit, duke u mbështetur kryesisht në



bankat e vendit, gjë që krijon rrezik për gjetjen e burimeve tëri-financimit. Për rrjedhojë, objektivi i deklaruar për vitin 2015 dhe më tej është të vazhdohet me konsolidimin fiskal dhe reduktimin e borxhit publik, në përputhje me rekomandimin nr.1 të PRE-ve. Kjo jo vetëm që do të ndihmojë në rindërtimin e amortizatorëve fiskalë për të luftuar çdo rënie ardhshme, por do të nxisë stabilitetin financiar duke qenë se një pjesë e madhe e borxhit qeveritar është me bankat.

Një reformë ambicioze e pensioneve është zbatuar gjërësisht me qëllim përmirësimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të sistemit. Qeveria ka arritur deri diku progres për trajtimin e rre rreziqeve fiskale që vijnë nga sektori i energjisë elektrike. Ky sektor i shërbimit publik karakterizohet nga humbje tejet të larta në shpërndarje dhe arkëtimin në mënyrë jo të përshtatshme të faturave, duke bërë që financat publike të mbajnë barrën e shpenzimeve, përfshirë edhe ato të importeve urgjente të energjisë elektrike. Ndërkohë që Qeveria

ka marrë tashmë masa për ulur vjedhjen e energjisë elektrike dhe lidhjet e paligjshme në rrjet, është e nevojshme të bëhet përpjekje të vazhdueshme për ta bërë sektorin e energjisë elektrike financiarisht të qëndrueshëm, në përputhje me rekomandimin nr. 2 të PRE-ve.

Rreziqe të tjera fiskale përfshijnë detyrimin që ka shteti për të paguar kompensimin e ish-pronarëve të pronave të konfiskuara gjatë regjimit komunist, e konfirmuar kjo edhe nga vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në përputhje me rekomandimin nr. 2 të PRE-ve, Shqipëria ka përgatitur një projektligj i cili do të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të skemës aktuale të kompensimit

Është e nevojshme të forcohet dukshëm kuadri për menaxhimin e buxhetit, në përputhje me rekomandimin nr. 3 të PRE-ve. Ndër të metat e menaxhimit të financave publike (MFP) mund të

përmendim planifikimin dhe monitorimin e dobët të buxhetit, parashikimet më tepër optimiste nga sa duhet për rritjen dhe të ardhurat, si dhe mbledhjen e shkujdesur të taksave, sidomos në vitet zgjedhore. Me kalimin e viteve, këto të meta kanë kontribuar në rritjen e borxhit publik dhe akumulimin e një niveli të lartë pagesave të prapambetura që Qeveria ka kundrejt sektorit privat. Për të zgjidhur këto të meta, qeveria miratoi një strategji ambicioze për MFP-në për periudhën 2014-2020, e mbështetur nga asistenca e Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA). Ajo parashikon plane për të forcuar buxhetet shumë-vjeçare, vendos rregulla për kufizuar rritjen e shpenzimeve të paparashikuara të motivuara politikisht dhe të eliminuar paragjykimet sistematike në parashikimet buxhetore. Besueshmëria fiskale duhet të forcohet duke miratuar një rregullore fiskal, hollësitë e të cilës mbeten për tu përgatitur.

Rekomandimi nr.6 i PRE-ve: “ Të përmirësohet klima e përgjithshme e biznesit, ndër të tjera, me anë të bashkimit në një të vetëm të QKR-së (Qendra Kombëtare e Regjistrimit) dhe QKL-së (Qendra Kombëtare e Licencimit) për të lehtësuar më tej barrën rregullatore dhe administrative që rëndon mbi bizneset. Të fillojë zbatimi i regjimit të thjeshtuar për autorizimet. Të vihet në funksionim të plotë Këshilli i sapo krijuar për investimet.”

Ndërveprimi i forcave të tregut

Liberalizimi i tregut dhe privatizimi kanë ecur përpara. Procesi i liberalizimit të çmimit dhe tregtisë është kryer gjatë fazës së hershme të procesit të tranzicionit, dhe privatizimi është mjaft i përhapur. Përfshirja e shtetit në ekonomi mbetet e kufizuar dhe është e përqendruar në disa sektorë, si energjia. Sektori privat vijon mbizotërojnë, duke zënë më shumë se 80% të fuqisë punëtore. Përpjekjet e privatizimit tashmë janë përqendruar në ndërmarrjet shtetërore të vogla dhe të mesme (NVM-të) në sektorët jo strategjikë. Disa shoqëri me performancë të dobët ekonomike u likuiduan gjatë periudhës raportuese, ndërkohë që asetet e pashfrytëzuara të shoqërive të tjera iu ofruan me qira investitorëve vendas dhe të huaj. Për më tepër, u mor vendimi për privatizimin e shoqërisë shtetërore të sigurimeve, INSIG, përmes një tenderi të hapur që mblodhi katër oferta. Për të identifikuar mundësinë më të mirë për ristrukturimin dhe privatizimin e ndërmarrjes së naftës Albpetrol, u ngrit një grup pune.

Hyrja dhe dalja nga tregu

Përmirësim i mëtejshëm i procedurave për hyrjen dhe daljen nga tregu mund të lehtësojë shpërndarjen efektive të burimeve. Regjistrimi i biznesit vazhdon të funksionojë relativisht mirë nëpërmjet rrjetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR). Numri i shoqërive të reja u rrit me

Rekomandimi nr.3 i PRE-ve: “Të forcohet kuadri i menaxhimit të buxhetit duke zbatuar strategjinë për menaxhimin e financave publike, të rënë dakord me Komisionin, dhe të miratuar në dhjetor 2014, në veçanti, të bëhen përpjekje për të miratuar një rregull fiskal të besueshëm, i cili do të sigurojë siç duhet qëndrueshmërinë e financave publike në terma afat-gjatë dhe të forcojë parashikimin e buxhetit.”

të
për
ende

43% në vitin 2014 dhe arriti në normën më të lartë në gjashtë vjet. ndërsa në vitin 2015 regjistrimet e biznesit kanë vazhduar të rriten, duke reflektuar pjesërisht përpjekjet për të bërë formale pjesën e madhe të ekonomisë joformale.

Planet për të modernizuar më tej procedurat duke bashkuar QKR-në me autoritetin e licencimit për të krijuar një dritare të vetme të shërbimit për regjistrim dhe licencim duhet të zbatohet në përputhje me rekomandimin nr. 6 të PRE-ve. Gjithashtu janë ndërmarrë hapa për krijimin e një inventari të autorizimeve me qëllim heqjen e atyre që janë të panevojshme. Qasje e firmave në financat formale, sidomos gjatë fazës fillestare, mbetet ende një sfidë. Procedurat e falimentimit vazhdojnë të jenë të ngadalta dhe norma e rimëkëmbjes për debitorët, në shumicën e rasteve, rezultojnë të jetë e ulët. Është arritur disi progres në drejtim të rishikimit të ligjit për falimentin.

Sistemi ligjor

Ka të meta të mëdha në drejtim të sundimit të ligjit, zbatimit të të drejtave të pronësisë dhe luftën kundër korrupsionit, të cilat mbeten aspekte kyçe për përmirësimin e mjedisit të biznesit.

Janë marrë masa për të trajtuar këto sfida komplekse (shiko Kapitullin 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore), por mbetet ende shumë për të Gjithashtu, janë bërë përpjekje për të përmirësuar komunikimin e qeverisë me bizneset, kryesisht me krijimin e një këshilli investimet dhe konsultimin e detyrueshëm

Rekomandimi nr.4 i PRE-ve: “Të merren masa të mëtejshme për të zgjidhur çështjen e kredive me probleme, me përfshirjen e të gjithë aktorëve kryesorë, dhe po qe e nevojshme edhe të Bankës së Shqipërisë, me qëllim uljen e qëndrueshme të nivelit të tyre. Në këtë drejtim, do të ishte e udhës, të jepet zgjidhje për pengesat që lidhen me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore.”

bërë.

për të

palëve të interesuara në lidhje me hartimin e projekt-akteve të reja ligjore, dhe për të zvogëluar barrën rregullatore që rëndon mbi bizneset. Gjithsesi, duhet akoma që rezultatet të materializohen.

Zhvillimi i sistemit financiar

Ka hapësirë që bankat të zgjerojnë huadhënien dhe të mbështesin më mirë rimëkëmbjen ekonomike.

Sektori bankar, i dominuar nga bankat e huaja, mban 90% të të gjitha asetëve të sistemit financiar. Duke qenë se kreditë për bizneset dhe familjet arrijnë në më pak se 40% të PBB-së, ka shumë hapësirë për rritjen e rolit të huadhënies bankare në ekonomi. Megjithatë, rritja e kredidhënies ka filluar duke arritur pikun nga fundi i vitit 2014, pavarësisht nga likuiditeti i mjaftueshëm që kanë bankat dhe rënia graduale e normave të kredisë. Ndërkohë që ngadalësimi ekonomik ka ulur kërkesën për kredi, përqindja e lartë e kredive me probleme (KMP), e cila arriti pikun në 24.9% në vitin 2014, dhe ishte ende 21% në qershor 2015, ka kontribuar në rritjen e rrezikut dhe kreditimin e kujdesshëm nga bankat.

Ndryshime të ndryshme rregullatore dhe legjislativë janë kryer tashmë për të trajtuar problemin, dhe është ngritur një grup pune ndërinstitucional për të zhvilluar një strategji gjithëpërfshirëse për reduktimin e KMP-ve. Megjithatë, sipas rekomandimit nr. 4 të PRE-ve, është e nevojshme të kryhen përpjekje të mëtejshme për të nxitur rakordimin e bilanceve bankare dhe rritjen e kreditimit, përfshirë trajtimin e pengesave në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore mbi kolateralin.

Sistemi bankar paraqitet i qëndrueshëm, por është i ekspozuar ndaj rreziqeve të kredive dhe borxhit në valutë. Në përgjithësi, raportet ndërmjet kapitalit dhe likuiditetit në sistemin bankar tejkalojnë pëlqyeshëm minimum rregullator, dhe rentabiliteti është përmirësuar në vitin 2014 dhe në gjysmën e parë të vitit 2015.

Tre bankat me pronësi greke veprojnë si degë më vete, me kapital dhe mbulim të mjaftueshëm të likuiditetit dhe nuk kanë ekspozim të rëndësishëm ndaj bankave të tyre mëmë. Banka qendrore ka zbatuar masat shtesë të kujdesshme duke ndjekur vendosjen e kontrollit të kapitalit në Greqi. Për rrjedhojë, rreziqet ndaj problemeve ngjithëse financiare janë të mirë kontrolluara. Aktiviteti bankar vijon të finanohet kryesisht nga depozitat, dhe raporti ndërmjet huave dhe depozitave shkon rreth

55%. Provigjionet për humbjet e mundshme të kredive me probleme janë përmirësuar, por diferenca ndërmjet kredive me probleme minus provigjionet arrinte ende në 36% të kapitalit bankar në korrik.

Bankat janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të kredisë që rrjedhin nga huatë në valutë, shlyerja e të cilave është e ndjeshme ndaj zhvlerësimit të mundshëm të monedhës shqiptare (Lek). Gjithashtu, duke qenë se letrat me vlerë të Qeverisë përbëjnë rreth një të katërtën e aseteve bankare, rritja e barrës së borxhit të keq në valutë do të dëmtonte aftësinë paguese të bankave.

Madhësia e sektorit financiar jo-bankar është rritur, por vazhdon të jetë e vogël. Ai përbëhet nga biznese të sigurimit dhe të pensioneve private, si edhe fondet e investimeve. Totali i aseteve përbën 6.5% të PBB-së. Kuadri rregullator dhe mbikëqyrës për këtë sektor ka nevojë të forcohet akoma më tej. Tregu i kapitalit mbetet ende në faza fillestare. Ka hapësirë të madhe për zgjerimin e financimit të kapitalit të vet.

3.2 Aftësia për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së

Shqipëria ka njëfarë niveli të përgatitjes në aspektin e aftësive për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së. Janë bërë **disa përparime** veçanërisht përsa i përket infrastrukturës së transportit dhe energjisë. Sidoqoftë, investime të rëndësishme në kapitalin njerëzor dhe fizik janë të nevojshme për të përmirësuar konkurrueshmërinë e vendit. Ka hapësirë të konsiderueshme për zhvendosjen e papunësisë në sektorë më produktiv dhe për diversifikimin e tregjeve dhe produkteve të eksportit. Në përputhje me rekomandimet e ERP dhe me qëllim mbështetjen e ngritjes afatgjatë, vitin e ardhshëm Shqipëria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ përmirësimit të cilësisë së arsimit të lartë dhe vazhdimin të ristrukturimit të arsimit dhe formimit profesional për të përmirësuar relevancën e tregut të tyre;

→ miratimit dhe zbatimit të strategjive kombëtare të transportit dhe energjisë;

→ uljes së barrierave jo-tarifore ndaj tregtisë.

Kapitali njerëzor dhe fizik

Megjithë përmirësimet e rëndësishme gjatë dekadës së fundit, Shqipëria ka ende boshllëqe të konsiderueshme për të mbyllur në lidhje me vitet e shkollimit, shkallën e regjistrimit në shkollën e mesme, cilësinë e arsimit dhe rëndësinë e tregut të kualifikimeve. Shpenzimet publike për arsimin mbeten në nivel të ulët me rreth 3 % të GDP-së dhe pritet të bien pak në vitin 2015 për shkak të investimeve më të ulëta buxhetore të bëra në këtë fushë. Shqipëria ka miratuar dhe filluar zbatimin e strategjisë kombëtare për punësim dhe aftësi për periudhën

2014-2020. Ndryshimet institucionale pritet të ndiqen nga futja e sistemit të praktikantëve dhe përmirësimit të kurrikulave në përputhje me nevojat e tregut. Sipas rekomandimit 5 të ERP ky fakt duhet të mbetet prioritet së bashku me hartimin e një strategjie të re për arsimin e lartë dhe ngritjen e një sistemi të ri akreditimi për universitetet. Rezultatet e ulëta të marra nga studentët shqiptarë në testet PISA të OSBE theksojnë nevojën për përmirësimin e cilësisë së arsimit bazë (*shih gjithashtu Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura*).

Rekomandimi 5 i ERP: 'Të miratohet dhe të fillojë zbatimi i ligjit për arsimin e lartë, si dhe strategjia e re për arsimin e lartë. Të vendoset një sistem i pavarur akreditimi për të gjitha universitetet publike dhe private. Të vazhdojë ristrukturimi i sistemit të arsimit dhe formimit profesional me qëllim përmirësimin e relevancës së trajnimit për nevojat e tregut të punës.'

Përmirësimi i kapitalit fizik dhe nxitja e novacionit janë elementë të rëndësishëm për rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë. Investimet si përqindje e GDP-së kanë rënë nga 33.9 % në vitin 2008 në 24.9 % në vitin 2014, nxitur nga investimet e dobëta në ndërtim, makineri dhe pajisje. Ndërkohë që janë në proces projekte të mëdha investimesh të huaja direkte në sektorin e energjetikës, duke përfshirë ndërtimin e një hidrocentrali të madh dhe seksionin shqiptar të Gazsjellësit

Trans-Adriatik, investimet ka të ngjarë të rriten në vitet e ardhshme. Megjithatë, një klimë më e favorshme investimi është e nevojshme për të tërhequr kapitalin në një gamë më të gjerë sektorësh. Ligje të reja janë miratuar në muajin maj me qëllim nxitjen e investimeve në sektorët strategjik dhe zhvillimin e zonave ekonomike nëpërmjet reduktimit të pengesave administrative dhe sigurimit të stimujve fiskalë për projekte të tilla. Investimet publike përbënin 5.1 %-5.5 % të GDP-së në vitet e fundit, por kanë qenë shpesh objekt i shkurtimeve të shpenzimeve *ad hoc* kur nevojiteshin rregullime

buxhetore. Shpenzimet publike në kërkim dhe zhvillim kanë vazhduar të përfaqësojnë vetëm 0.01 % të GDP-së dhe mbetet shumë për të bërë për zhvillimin e një kulture novative dhe lidhjeve ndërmjet shkencës dhe industrisë.

Ndërkohë që ka pasur progres gjatë këtyre viteve, infrastruktura e transportit dhe energjisë ende nuk është zhvilluar sa duhet. Finalizimi dhe zbatimi i strategjisë së transportit 2016-2020 pritet të përmirësojnë infrastrukturën e përgjithshme të transportit në vend dhe janë theksuar si prioritet i rekomandimit 7 të ERP. Përqendrimi i investimeve në rrjetin kryesor, në veçanti, do të përmirësonte lidhjen ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor si dhe me BE-në.

Rekomandimi 7 ERP: ‘Të miratohet dhe të fillojë zbatimi i strategjisë së transportit dhe plan veprimi për periudhën 2016-2020. Investimet të përqendrohen në rrjetin kryesor. Të miratohet dhe të fillojë zbatimi i strategjisë kombëtare të energjisë dhe Ligjit për Sektorin e Energjisë, duke përfshirë ndarjen e sektorit të energjisë. Të përgatiten tubacione të veçanta sektoriale për investimet kryesore si për transportin dhe energjinë.’

Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

Ekonomia shqiptare dominohet nga sektori i shërbimeve dhe bujqësia ende luan një rol të rëndësishëm. Në vitin 2014, shërbimet përbënin rreth gjysmën e vlerës së shtuar bruto, vlerë kjo e pandryshuar prej vitit 2008, e ndjekur nga bujqësia me një kuotë prej

Rekomandimi 8 ERP: ‘Të miratohet një strategji për kadastrën e tokës dhe të merren masa konkrete për t’i dhënë hov konsolidimit të tokës bujqësore.’

22.6 %. Roli i industrisë është rritur gjatë viteve të fundit (që përbën 14.2% të ekonomisë në vitin 2014 nga 11.4% në vitin 2008) kryesisht për shkak të rritjes së nxjerrjes së naftës. Në të njëjtën kohë pjesa e ndërtimit të ekonomisë ka rënë në 11 % në vitin 2014 nga 18 % që ishte në vitin 2008 pas krizës ekonomike dhe ngadalësimit të kreditimit. Bujqësia ofron një përqindje punësimi gradualisht në rënie, por ende shumë të lartë (rreth 42.7 % në vitin 2014), ku pjesa më e madhe është në formën e punës së papaguar familjare. Sipas rekomandimit 8 të ERP, pritet të miratohet një strategji për regjistrin e tokës (kadastra).

Përbërja sektoriale e eksporteve të mallrave ka mbetur mjaft e përqendruar, me 82% të eksporteve totale në vitin 2014 që përbëheshin nga produkte minerale (33.6%), tekstile dhe veshjet e këmbës (33.6%) si dhe materiale ndërtimi dhe metale (14.5%). Një mungesë e tillë diversifikimi kontribuon në deficitin e jashtëm të lartë dhe ekspozon ekonominë ndaj tronditjeve specifike të industrisë.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) luajnë një rol të rëndësishëm në ekonomi. Ato sigurojnë 81 % të punësimit dhe 70 % të vlerës së shtuar në sektorin privat jo-bujqësor. Mikro-bizneset në veçanti përbëjnë një përqindje të lartë të numrit të kompanive dhe përbëjnë 46% të punëve. Skema të ndryshme të financuara nga shteti dhe donatorët mbështesin konkurrueshmërinë dhe aksesin në financë të NVM-ve. Strategjia për zhvillimin e biznesit dhe investimeve 2014-2020 i ka dhënë prioritet shërbimeve mbështetëse për NVM-të dhe hapjes së tyre. Përveç vënies në zbatim të kësaj strategjie, përpjekje të mëtejshme mund të bëhen për zbatimin e testit të NVM për t’u siguruar se rregulloret dhe legjislacioni nuk e pengojnë zhvillimin dhe rritjen e NVM-ve.

Ndikimi i shtetit në konkurrueshmëri

Subvencionet e raportuara shtetërore për ekonominë kanë mbetur në nivel relativisht të ulët por sektori i energjisë elektrike po i bjerr vazhdimisht burimet publike. Ndihma totale e raportuar shtetërore ka qëndruar në vlerën 0.5 % të GDP-së në vitin 2014, duke shënuar një rënie të konsiderueshme nga 1.5 % në vitin 2013. Rreth dy të tretat e subvencioneve janë dhënë në mënyrë spekulative për qëllime të përgjithshme biznesi më pak shtrembëruese, të tilla si në kërkim, zhvillim dhe punësim. Megjithatë, pjesën më të madhe të ndihmës së përgjithshme të biznesit kanë vijuar ta përfitojnë disa industri të tilla si industria e hidrokarbureve apo e veshjeve. Të dhënat mbi ndihmën shtetërore nuk përfshijnë garancitë bankare të dhëna për kompaninë shtetërore

KESH për të lehtësuar vështirësitë e saj financiare. Ekzistojnë hapësira për të përmirësuar zbatimin e rregullave të konkurrencës.

Integrimi ekonomik me BE-në

BE është partneri dominues tregtar për Shqipërinë, me lidhje të forta në mënyrë të veçantë me Italinë. Ekonomia shqiptare ka rritur hapjen e saj ndaj tregjeve, ku shuma e totalit të importeve dhe eksporteve ka arritur në 92.3 % të GDP-së në 2014 kundrejt 86 % në 2008. BE mbetet partneri më i madh tregtar i Shqipërisë deri tani, me një pjesëmarrje prej 77.4 % të eksportit të mallrave dhe 61.1 % të importit të mallrave në 2014. Italia është destinacioni kryesor për eksportet shqiptare, duke tërhequr mbi gjysmën e mallrave shqiptare të shitura jashtë vendit në 2014 dhe duke ofruar pothuajse një të tretën e importit të mallrave të saj. Lidhjet tregtare me vendet e Marrëveshjes së Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA) janë gjithashtu relativisht të rëndësishme pasi ato zinin rreth 12 % të eksportit të mallrave shqiptare dhe 8 % të importit të mallrave të saj në 2014, por këto përqindje janë kryesisht të pandryshuara që prej vitit 2008, duke treguar një potencial të madh të pashfrytëzuar për rritje në të ardhmen.

Progres i konsiderueshëm është bërë në uljen e barrierave teknike në tregti. Megjithatë, duhet të bëhen më shumë përpjekje në fushën e masave sanitare dhe fitosanitare si dhe barrierave administrative, të tilla si futja e zhdoganimit elektronik të mallrave dhe thjeshtëzimi i procedurave doganore.

4 AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT

4.1 Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave

Lëvizja e lirë e mallrave garanton se shumë mallra mund të tregtohen lirisht në BE mbi bazën e rregullave dhe procedurave të përbashkëta. Kur lëvizja e produkteve drejtohet nga rregulla të brendshme, parimi i lëvizjes së lirë të mallrave parandalon krijimin e barrierave të pajustificuara në tregti.

Shqipëria ka bërë **përgatitje të moderuar** në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Ka pasur **disa përparime**, kryesisht në fushën e standardizimit dhe akreditimit. Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ përafrimit të legjislacionit me *acquis* në fushat e metrologjisë, legjislacionit të produkteve dhe masave procedurale të 'përqasjes së re dhe globale';

→ krijimit të inspektoratit për mbikëqyrjen e tregut.

Ka pasur disa përparime në fushën e **masave horizontale**. Në fushën e **standardizimit**, Shqipëria ka vazhduar të miratojë standardet Evropiane, kryesisht me metodën e përkthimit të 'faqes së parë'. Në vitin 2014, u miratuan 1 269 standarde Evropiane, nga të cilat 597 standarde të Komitetit Evropian të Standardizimit (CEN), 149 standarde të Komitetit Evropian për Standardizimin Elektroteknik (CENELEC) dhe 523 standarde nga Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit. Gjithashtu janë miratuar 187 standarde të tjera ndërkombëtare, nga të cilat 99 standarde ISO dhe 88 standarde të Komisionit Ndërkombëtar Elektroteknik (IEC). Amendamentet në Ligj për Standardizimin janë miratuar në maj nga Parlamenti, me synim përafrimin me *acquis* në lidhje me njoftimin e standardeve për rregullat teknike. Është miratuar strategjia për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut, duke mbuluar edhe akreditimin dhe metrologjinë. Në shkurt, qeveria ka ndryshuar Rregulloren për Bordin Drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit.

Në fushën e **vlerësimit të konformitetit**, në maj Shqipëria u bë anëtare me të drejta të plota në organizmin Evropian të Akreditimit (EA). Nënshkrimi nga ana e Shqipërisë i marrëveshjeve shumëpalëshe të EA për laboratorët testues është në pritje të vendimit nga EA.

Një bord i ri këshillues për akreditimin u ngrit në dhjetor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA), me synimin për të balancuar më mirë përfaqësimin e institucioneve publike dhe private në procesin e vendimmarrjes. DPA ka nënshkruar në tetor një memorandum mirëkuptimi me Dhomën e Tregtisë Tiranë.

Në fushën e **metrologjisë**, Ligji i ri për Metrologjinë u miratua në shtator 2015. Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë ka mbledhur rreth 75% të gjobave për shkelje të legjislacionit të hartuar në vitin 2014. Nuk janë bërë përparime në përafrimin me Direktivën e Instrumenteve Matëse.

Nuk ka pasur progres në **mbikëqyrjen e tregut**. Baza ligjore për krijimin e inspektoratit për mbikëqyrjen e tregut pritet të miratohet. Në shkurt, janë përgatitur ndryshimet në ligjin për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre por nuk janë miratuar ende.

Janë bërë disa përparime në fushën e **legjislacionit të produkteve të ‘Përqasjes së Vjetër’**, nëpërmjet miratimit në korrik të vendimit të qeverisë për rregullimin teknik dhe kërkesat thelbësore, vlerësimin e konformitetit dhe markimit CE të pajisjeve mjekësore të implantueshme.

Nuk janë bërë përparime në fushën e **legjislacionit të produkteve të ‘Përqasjes së Re dhe të Vjetër’** dhe në fushën e masave procedurale.

4.2 Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punëtorëve

Qytetarët e një Shteti Anëtar kanë të drejtë të punojnë në një Shtet tjetër Anëtar dhe duhet t’u sigurohen kushte të njëjta pune dhe sociale si punëtorëve të tjerë.

Shqipëria është në **fazë të hershme** në fushën e lirisë së lëvizjes për punëtorët. **Nuk** është bërë **progres** në këtë fushë.

Për sa i përket aksesit në tregun e punës, nuk janë bërë përparime të mëtjshme në garantimin e trajtimit të barabartë për qytetarët e BE-së në tregun shqiptar të punës.

Pësa i përket **koordinimit të sistemeve të sigurimeve shoqërore**, janë nënshkruar marrëveshje dypalëshe për transferimin e sigurimeve shoqërore me Kosovën dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, respektivisht në shkurt dhe mars. Marrëveshje të ngjashme me Hungarinë dhe Rumaninë duhet të ratifikohen, ndërkohë që vazhdojnë negociatat me Republikën Çeke dhe Gjermaninë. Parashikohen negociata me Luksemburgun, Belgjikën dhe Austrinë.

4.3 Kapitulli 3: E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime

Personat fizik dhe juridik të BE-së kanë të drejtë të vendosen në çdo Shtet Anëtar dhe të ofrojnë shërbime ndërkufitare. Për disa profesione të rregulluara, ekzistojnë rregulla për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve. Shërbimet postare po hapen gradualisht ndaj konkurrencës.

Shqipëria ka bërë **përgatitje të moderuar** në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime. Ka pasur **përparim të mirë**, kryesisht në përafrimin e legjislacionit me *acquis* për shërbimet postare. Vitin e ardhshëm, vendi duhet t’i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ përafrimit në vazhdimësi të legjislacionit me Direktivën e Shërbimeve dhe Direktivën e Kualifikimeve Profesionale;

→ forcimit të kapaciteteve institucionale për të drejtën e vendosjes dhe njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale.

Për sa i përket **lirisë për të ofruar shërbime ndërkufitare**, kanë vazhduar përgatitjet për përafrimin e mëtjshëm me *acquis* nëpërmjet përgatitjes së ligjit të përgjithshëm për shërbimet. Kanë filluar përgatitjet për bashkimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dhe Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL).

Legjislacioni i sektorit është duke u shqyrtuar për përputhshmëri me Direktivën e Shërbimeve: janë përfunduar raportet e para monitoruese për sektorin e minierave dhe sektorin e veterinarisë, ndërkohë ka filluar të shqyrtohet legjislacioni në fushën e sektorit të taksave, shërbimeve sociale dhe atyre ligjore. Parlamenti ka miratuar në shkurt ndryshimet e legjislacionit për regjistrimin dhe licencimin, autorizimet dhe lejet e kompanive.

Në fushën e **Shërbimeve Postare** Parlamenti ka miratuar një Ligj të ri në maj. Ky ligj ka për qëllim sigurimin e shërbimeve postare universale në të gjithë vendin dhe përafrimin e mëtejshëm të ligjit shqiptar me Direktivën 2008 të BE-së.

Për sa i përket **njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale**, Parlamenti ka miratuar ligjet për shoqatat profesionale të mjekëve dhe infermierëve, dhe ndryshimet e ligjeve përkatëse për shoqatat profesionale të infermierëve dhe farmacistëve. Profesionet e punonjësit social dhe psikologut janë përfshirë në listën e profesioneve të njohura. Nevojitet ende që legjislacioni të përafrohet me Direktivën e Kualifikimeve Profesionale (2005/36/EC) duke përfshirë profesionet për të cilat janë harmonizuar kërkesat minimale të trajnimit.

4.4 Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit

Në BE, kapitali dhe investimet duhet të jenë në gjendje të lëvizin pa kufizime dhe ekzistojnë rregulla të përbashkëta për pagesat ndërkufitare. Bankat dhe operatorët e tjerë ekonomik zbatojnë rregulla të caktuara për të mbështetur luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Në tërësi, Shqipëria ka bërë **përgatitje të moderuar** në këtë fushë. Janë bërë **disa përpertime** në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit, kryesisht për shkak të përmirësimit të performancës në luftën kundër pastrimit të parave. Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ zbatimit me efektivitet të legjislacionit kundër pastrimit të parave në të gjitha nivelet dhe forcimit të mëtejshëm të sistemit kombëtar të luftës kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit (AML/CFT);

→ zbatimit të plan veprimit për blerjen e pronës nga të huajt.

Përgatitjet për **lëvizjen e kapitalit dhe pagesave** kanë mbetur në nivel të dobët. Një plan veprimi është miratuar në mars për të lehtësuar blerjen e pronës nga shtetas të huaj.

Për sa i përket **sistemit të pagesave**, Sistemi i Pagesave Ndërbankare ka përpunuar 86 430 transaksione në 2014 (0.09 % më shumë se në 2013 në numër dhe 5.1 % më shumë në vlerë). Numri i transaksioneve të përpunuara nëpërmjet Sistemit Shqiptar të Klerimit të Pagesave me Vlerë të Vogël u rrit me 22 % krahasuar me 2013, dhe vlera ishte 14.2 % më e lartë se në 2013. Ky trend ka vazhduar në gjysmën e parë të 2015. Ministria e Financave ka vazhduar të dominojë sistemin e Klerimit të pagesave, me 54 % të numrit të transaksioneve dhe 49 % të vlerës totale.

Për sa i përket **luftës kundër pastrimit të parave**, në shtator Shqipëria është hequr nga lista e vendeve të monitoruara nga Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (Moneyval) në procesin e saj të vazhdueshëm të përputhshmërisë për të luftuar financimin e terrorizmit. Numri i raporteve për transaksione të dyshimta është rritur në 2014 dhe në gjashtëmujorin e parë të 2015.

4.5 Kapitulli 5: Prokurimi publik

Rregullat e BE-së sigurojnë se prokurimi i sektorit publik të mallrave dhe shërbimeve në çdo Shtet Anëtar është i hapur për të gjitha kompanitë e BE-së mbi bazën e parimit të mosdiskriminimit.

Shqipëria ka **njëfarë nivel të përgatitjes** në prokurimet publike. Prokurimet përbëjnë një fushë vulnerabël ndaj korrupsionit dhe nevojiten më shumë përpjekje për të parandaluar korrupsionin në ciklin e prokurimeve. Janë bërë **disa përparime** në vitin e kaluar, në veçanti nëpërmjet miratimit të ndryshimeve në ligjin e prokurimit publik. Për sa i përket koncesioneve ka pasur kthim prapa, me futjen e masave të papajtueshme me *acquis*. Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ sigurimit të funksionimit efektiv, efikas dhe transparent të sistemit të prokurimeve publike duke zbatuar pjesë të prokurimeve publike nga strategjia e reformës së menaxhimit të financave publike;

→ zbatimin të një plani përafrimi ligjor për të siguruar rritjen e harmonizimit me rregullat e prokurimit publik të BE-së, përfshirë fushën e koncesioneve dhe prokurimin në fushën e mbrojtjes;

→ marrjes së masave për të forcuar sistemin e rishikimit të prokurimeve publike duke siguruar pavarësinë funksionale të Komisionit të Prokurimit Publik nga qeveria.

Kuadri institucional dhe përafrimi ligjor

Në fushën e **kuadrit ligjor**, Ligji për Prokurimin Publik është në masë të gjerë në përputhje me direktivat e BE-së për prokurimin klasik dhe utilitar dhe është harmonizuar me dispozitat përkatëse administrative dhe buxhetore. Megjithatë, duhet të arrihet harmonizimi me direktivat e rishikuara mbi prokurimin publik (Direktiva 2014/24/EU) dhe për prokurimin e subjekteve që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare.

Legjislacioni shqiptar ende nuk është në përputhje me Direktivën 2009/81/EC për prokurimin në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes dhe Rregulloren Nr. 2195/2002 për Fjalorin e Përgjithshëm të Prokurimit dhe ka mangësi në përputhje me Direktivën e Masave Korrigjuese.

Ligji për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat ishte pjesërisht në përputhje me Direktivën 2014/23/EU. Ndryshimet e ligjit miratuar në korrik futën alternativën e dhënies së bonusit prej 10 % për propozime të pakërkua, gjë që është në shkelje të *acquis*. Infrastruktura rrugore me rëndësi kombëtare është përjashtuar nga objekti i ligjit. Nevojiten masa urgjente për të adresuar këto mospërputhje ndërmjet ligjit dhe direktivës.

Strategjia (PFM) përfshin masat për përafrimin e mëtejshëm të prokurimit publik dhe koncesioneve me *acquis* dhe për forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional. APP duhet të miratojë një plan të detajuar veprimi për prokurimin publik në kuadrin e strategjisë së PFM dhe të raportojë për zbatimin e tij.

Agjencia e Prokurimit Publik (APP) është një institucion i mirë-organizuar. Duhet të funksionojnë mekanizmat e koordinimit me aktorët dhe palët e interesit për të forcuar rolin e APP. Pas krijimit të njësisë të reja të qeverisjes vendore si rezultat i reformës administrative territoriale, nevojitet të forcohen aftësitë e punonjësve lokalë të caktuar për çështje të prokurimit publik.

Aftësitë zbatuese

Tregu i prokurimeve publike të vendit në raport me prodhimin e brendshëm bruto (GDP) ka qëndruar në nivelin 3.2 % në 2014, krahasuar me 3.6 % në 2013, me trend në rënie gjatë vitit të kaluar për shkak të shkurtimeve buxhetore. Planifikimi, përgatitja dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik në përgjithësi respektojnë parimin e transparencës dhe efikasitetit. Përdorimi i procedurave me negociim pa shpalljen paraprake të njoftimit të kontratës, në 2014 ka rënë në 31.2 % për të gjitha procedurat, krahasuar me

33.6 % në 2013, dhe në 11.4 % në aspektin e vëllimit, krahasuar me 19 % në 2013. Megjithatë, në gjysmën e parë të 2015 numri i procedurave të prokurimeve me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës është rritur në mënyrë të ndjeshme, me një total prej 2 224 procedurash krahasuar me 2 121 procedura për të gjithë vitin 2014. Portali qendror i prokurimit publik funksionon dhe përdoret gjerësisht. Sistemi i prokurimit elektronik është i detyrueshëm dhe plotësisht funksional, përfshirë për prokurimet me vlerë të ulët. Në Ministrinë e Brendshme funksionon një organ i centralizuar prokurimi për disa lloje prokurimesh por rekomandohet centralizimi i mëtejshëm për të reduktuar vulnerabilitetin ndaj korrupsionit.

Monitorimi i procedurave të prokurimit dhe dhënies së kontratave ka nevojë për përmirësime të mëtejshme. Ai fokusohet në pajtueshmërinë me ligjin dhe nuk shtrihet në vlerësimin e plotë të praktikave në tregun e prokurimeve publike. APP duhet të rrisë më tej kapacitetet për monitorimin e sistemit elektronik të prokurimit dhe të bëjë më transparent procedurat e koncesioneve dhe planet.

Aftësitë e autoriteteve kontraktuese **për të menaxhuar proceset e prokurimit publik** janë përmirësuar. APP ka miratuar dokumente të reja standarde të tenderit për çdo lloj procedure (punimet, mallrat, shërbimet, shërbimet këshillimore dhe konkurrimin e projektit) dhe në janar ka nxjerrë udhëzime për disa procedura. Qeveria është angazhuar për adresimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit në prokurimin publik si pjesë e strategjisë anti-korrupsion. Megjithatë Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vlerësuar se humbjet financiare në buxhetin e shtetit nga prokurimet publike arrijnë në 4.8 milion euro në 2014, pothuajse dyfishi krahasuar me 2013.

Sistemi i mjeteve ligjore efektive

E drejta për një **proces të rregullt ligjor** është e përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligjin e prokurimit publik. Kjo e drejtë është në përputhje të gjerë me parimet e përgjithshme të Traktatit të BE-së dhe Direktivën e Mjeteve Ligjore efektive, por nevojiten përmirësime të mëtejshme nëpërmjet përcaktimit të kuadrit ligjor mbi paefektshmërinë e kontratave, dënimet alternative dhe njoftimet *ex ante* vullnetare të transparencës. Sistemi i mjeteve ligjore efektive përfshin rishikimin administrativ nga Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), vendimet e të cilit mund të kundërshtohen në Gjykatën Administrative. Pajtueshmëria e vendimeve për rastet e prokurimit publik duhet të përmirësohet me anë të organizimit të trajnimeve të përbashkëta për gjyqtarët, stafin e APP dhe KPP. Zëvendësimi i kryetarit të KPP dhe disa anëtarëve të tij jep shkak për shqetësim lidhur me pavarësinë e organit. Duhet të merren masa për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e KPP, të cilat janë dëmtuar rëndë për shkak të varësisë së këtij organi nga Këshilli i Ministrave.

KPP ka marrë 834 ankesa në 2014, ose 48 % më shumë se në 2013. Pothuajse 60 % e tyre janë konsideruar të pabazuara dhe pjesa më e madhe e ankesave të pranura kishin të bënin me procedurat e prokurimit për shërbime sigurie. Në rreth 40 % të rasteve, koha maksimale ligjore për përpunimin e ankesave është tejkaluar. Rreth 8 % e vendimeve të tij në 2014 janë kundërshtuar në Gjykatën Administrative. Dispozitat nuk lejojnë depozitimimin e ankesave kundër procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit. Kjo dispozitë përjashton nga mekanizmi i shqyrtimit 31 % të procedurave të prokurimit.

Ndërkohë që procedurat e mjeteve ligjore efikase janë përcaktuar gjerësisht, duhet të forcohet **kapaciteti** i KPP dhe Gjykatës Administrative për të trajtuar një numër kompleks dhe në rritje të ankesave për prokurimin për të siguruar përpunimin në kohë të ankesave.

4.6 Kapitulli 6: E drejta e shoqërive tregtare

BE ka rregulla të përbashkëta në lidhje me kërkesat për formimin, regjistrimin dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të një shoqërie tregtare, me rregulla plotësuese për kontabilitetin dhe raportimin financiar, si dhe auditin ligjor.

Shqipëria ka bërë **përgatitje të moderuar** në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare. Janë bërë disa përpftime në këtë fushë. Vitin e ardhshëm Shqipëria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ forcimit të kapaciteteve dhe pavarësisë së Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Në fushën e të **drejtës së shoqërive tregtare**, në tetor u miratuan ndryshimet e Ligjit 2008 për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare me qëllim përafrimin e mëtejshëm me *acquis*. Dispozitat përfshijnë kërkesat për raportimin dhe dokumentacionin për bashkimet dhe ndarjet, si dhe mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe palëve të treta. Ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit u ndryshua në shkurt në funksion të përafrimit të mëtejshëm me *acquis* duke parashikuar dorëzimin online të bilanceve vjetore dhe raporteve të auditimit nga shoqëritë tregtare.

Në **fushën e kontabilitetit**, standardet kombëtare të kontabilitetit të miratuara në korrik 2014 zbatohen për pasqyrat financiare të depozituara që prej janarit 2015 e në vazhdim. Ende nuk ka përfunduar përkthimi dhe transpozimi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit në nivel kombëtar. Megjithatë njoftimi online i bilanceve është aktualisht i disponueshëm, duhet të ndërmerren hapa për të siguruar që shoqëritë tregtare të dorëzojnë një paketë të vetme pasqyrash financiare (d.m.th versionin e miratuar sipas rregullave) në qendrën kombëtare të regjistrimit të biznesit. Aksesit i publikut në pasqyrat financiare të shoqërive tregtare duhet të përmirësohet më tej.

Në fushën e **auditimit**, Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka paraqitur propozime që synojnë rritjen e buxhetit për të promovuar pavarësinë e tij dhe për të siguruar se është strukturë e përhershme. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të siguruar pavarësinë e plotë.

4.7 Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale

BE ka harmonizuar rregullat për mbrojtjen ligjore të së drejtës së autorit dhe të drejtave që lidhen me të. Këtu përfshihen, për shembull, programet kompjuterike, transmetimi dhe markat tregtare, planet, shpikjet bioteknologjike dhe barnat farmaceutike.

Shqipëria ka **njëfarë niveli të përgatitjes** për sa i përket të drejtave të pronësisë intelektuale. Janë bërë **disa përpftime** në vitin e kaluar. Megjithatë, Shqipëria ende nuk ka përmbytur detyrimet e saj sipas Nenit 73 të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale. Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ miratimit të një ligji të ri për të drejtën e autorit në përputhje me standardet Evropiane;

→ përmirësimit të funksionimit të agjencive të menaxhimit kolektiv dhe pagesave të komisioneve për mbajtësit e të drejtave.

Në fushën e **të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera që lidhen me të**, pritet të miratohet ligji i ri i të drejtës së autorit.

Në fushën e **të drejtave të pronësisë intelektuale**, është miratuar legjislacioni dytësor që synon zbatimin e ligjit të ndryshuar për Pronësinë Industriale. Dy rregulloret mbi miratimin e tarifave për pronësinë industriale dhe nxjerrjen e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit kanë hyrë në fuqi respektivisht në janar dhe shkurt. Tre rregulloret shtesë për regjistrimin e markave tregtare dhe të shërbimeve, treguesit gjeografikë dhe planet industriale u miratuan në qershor.

Për sa i përket **ekzekutimit**, në qershor u miratua struktura e re e Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave. Është forcuar bashkëpunimi i kësaj Drejtorie me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Drejtoria e Përgjithshme ka zhvilluar aktivitete sensibilizuese dhe ka parë rritjen e numrit të kompanive që regjistrojnë markat e tyre.

Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit ka kryer inspektime dhe ka monitoruar përdoruesit e pronësisë intelektuale, dhe ka lëshuar certifikatat e të drejtave të autorit dhe transferimin e të drejtave ekonomike dhe kontratave të regjistruara. Bashkëpunimi i saj me autoritetet lokale, policinë dhe disa universitete është përmirësuar. Në vitin 2014, numri i gjobave të vendosura nga zyra është rritur në krahasim me vitin 2013. Kapaciteti i saj administrativ është përmirësuar, por mbetet i pamjaftueshëm. Agjencitë e menaxhimit kolektiv kanë vazhduar të përballen me vështirësi në kryerjen e punës së tyre, dhe ka pasur vonesa të konsiderueshme në rinovimin e licencave të tyre.

Numri i produkteve të falsifikuara në vend është ende i lartë dhe Inspektorati i Mbikëqyrjes së tregut nuk është ngritur akoma. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka vazhduar të konfiskojë produkte të falsifikuara në pikat doganore. Është kryer një operacion i përbashkët për të luftuar shkeljet e të drejtave të pronësisë intelektuale si dhe prodhimin dhe trafikimin e mallrave të falsifikuara, duke rezultuar në 61 procedime penale dhe gjoba që arrijnë në 15 000 euro. Ankesat në polici nga palët e interesuara për shkeljet e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe prodhimin e paligjshëm të mallrave janë rritur, duke rezultuar në ndjekjen e 67 autorëve në 2014. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të rritur ndërgjegjësimin e palëve të interesuara, përfshirë gjyqtarët.

4.8 Kapitulli 8: Politika e konkurrencës

Rregullat e BE-së mbrojnë konkurrencën e lirë. Ato përfshijnë rregullat antikartel kundër marrëveshjeve kufizuese ndërmjet kompanive dhe abuzimit me pozitën dominuese. Rregullat e BE-së u ndalojnë gjithashtu qeverive dhënien e ndihmës shtetërore e cila shtrembëron konkurrencën.

Shqipëria ka bërë **përgatitje të moderuar** në fushën e politikës së konkurrencës. Janë bërë **disa përpertime** sidomos në lidhje me antikartelët dhe bashkimet. Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ rritjes së pavarësisë operacionale të Komisionit të Ndhmës Shtetërore.

→ forcimit të kapaciteteve administrative të Njësisë për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore.

Në fushën **antikartel dhe bashkimet**, Autoriteti i Konkurrencës (AK) ka miratuar udhëzimet për vlerësimin dhe abuzimin e pozitës dominuese në treg dhe ka hartuar udhëzime të reja për mjetet ligjore bazuar në njoftimin e Komisionit Evropian për mjetet ligjore. Kapaciteti administrativ i AK-së është i mjaftueshëm dhe stafi i tij ka nivel të mirë ekspertize. Megjithatë, vonesat në proceset gjyqësore janë shumë të gjata dhe duhen bërë përpjekje të mëtejshme për të rritur disponueshmërinë dhe cilësinë e trajnimit për gjyqtarët mbi politikën e konkurrencës.

Në fushën e **ndihmës shtetërore**, është ngritur një grup pune ndërministror për të përmirësuar bashkëpunimin. Shqetësim mbeten kapacitetet administrative të Njësisë për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes. Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore është duke u rishikuar për të forcuar pavarësinë e autoriteteve zbatuese, por ky ligj mbetet vetëm pjesërisht i përafuar me *acquis*. Shuma e ndihmës shtetërore të dhënë në 2014 ishte 46.4 milion euro, e cila është mënyrë të konsiderueshme më e vogël se në vitin e kaluar. Aksesit në informacionin e vendimeve të Komisionit të Ndhmës Shtetërore është përmirësuar me publikimin e vendimeve të tij online.

Për sa i përket liberalizimit, një vlerësim *ex post* i AK-së zbuloi se autoritetet kontraktuese nuk kishin përmbushur detyrimet e tyre për të kërkuar vlerësimin e AK-së kur u jepeshin të drejtat ekskluzive.

4.9 Kapitulli 9: Shërbimet financiare

Rregullat e BE-së synojnë sigurimin e konkurrencës së drejtë ndërmjet institucioneve financiare dhe stabilitetin e tyre, konkretisht në sektorin bankar, sigurimet, pensionet suplementare, shërbimet e investimit dhe tregjet e letrave me vlerë.

Shqipëria ka bërë **përgatitje të moderuar** në fushën e shërbimeve financiare. Janë bërë **disa përpertime** në këtë fushë. Për bankat dhe konglomeratet financiare është ndryshuar legjislacioni për koeficientin e mjaftueshmërisë së kapitalit. Përgatitjet në infrastrukturën e tregut financiar, tregun e letrave me vlerë dhe shërbimet e investimit kanë mbetur në fazë të hershme. Vitin e ardhshëm:

→ Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) duhet të plotësojë strukturën e bordit në përputhje me ligjin për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Në fushën e **bankave dhe konglomerateve financiare**, Banka e Shqipërisë ka miratuar rregulloren mbi kërkesat e kapitalit për bankat e nivelit të dytë bazuar në koeficientin e mjaftueshmërisë së kapitalit Bazel III. Janë miratuar rregulloret mbi funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe likuiditetin e letrave me vlerë si dhe kreditë konsumatore dhe hipotekare. Ndryshime janë bërë në rregulloret për sistemet e pagesave të mëdha ndërbankare; aktivitetet e bankave; aktivitetet në lidhje me monedhën e huaj; dhe për menaxhimin e riskut të ekspozimeve të mëdha ndërmjet bankash ndaj falimentimit të palës tjetër. Është rritur kapaciteti institucional dhe administrativ i Departamentit të Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë. Që prej janarit, vlerësimi i bankave është bazuar në metodologjinë e re të vlerësimit të riskut, në përputhje me *acquis*. Sistemi bankar ka mbetur i qëndrueshëm dhe me likuiditet.

Në fushën e **sektorit jobankar**, Parlamenti ka emëruar në muajin mars kreun e ri të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), pas ndryshimeve të vitit 2014 në Ligjin për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. AMF ka ndërmarrë hapa për rritjen e kapaciteteve të veta institucionale, por duhet të miratohet struktura e tij e re organizative dhe të plotësohen vendet vakante në bordin e tij. Në qershor është licencuar një institucion i ri financiar i mikro-kreditit.

Në fushën e **sigurimeve dhe pensioneve të punës**, AMF ka nxjerrë rregullore mbi parimet dhe procedurat që lidhen me kontabilitetin e kompanive të sigurimeve, duke përfshirë sistemet e kontrollit të brendshëm të riskut dhe detyrimet e likuiditetit. Gjithashtu ky autoritet ka miratuar rregulloret për njoftimin, korrigjimin dhe ndalimin e prospektiveve.

Për sa i përket **infrastrukturës së tregut financiar**, Bursa e Tiranës u pezullua në dhjetor meqenëse nuk kishte listuar asnjë kompani dhe nuk ishin tregtuar letra me vlerë. Ajo ka mbetur në *stand-by* në rast se kompanitë interesohen për t'u listuar në tregun e bursës.

Në fushën e **tregjeve të letrave me vlerë dhe shërbimeve të investimit**, vëllimi i fondeve të investimit ka vazhduar të rritet në 2014 dhe është dominuar nga letrat me vlerë të qeverisë, të cilat zinin 85% të aseteve totale. Janë miratuar rregulloret për administrimin e likuiditetit të fondeve të investimeve dhe për njoftimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

4.10 Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe media

BE mbështet funksionimin e mirë të tregut të brendshëm për komunikimet elektronike, tregtinë elektronike dhe shërbimet audiovizive. Rregullat mbrojnë konsumatorët dhe mbështesin disponueshmërinë universale të shërbimeve moderne.

Shqipëria ka bërë **përgatitje të moderuar** në fushën e shoqërisë së informacionit dhe medias audiovizive. Ka pasur disa përpertime në vitin e kaluar. Është forcuar kapaciteti i Agjencisë për Komunikimet Elektronike dhe Postare (AKEP) dhe i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Është miratuar strategjia e re e agjendës dixhitale 2015-2020. Janë rritur shërbimet elektronike të ofruara për institucionet publike dhe qytetarët. Vitin e ardhshëm, vendi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

- rritjes së pavarësisë së entit rregullator të medias dhe transmetuesit publik;
- zbatimit, si një çështje urgjente, të kalimit nga transmetimi analog në atë dixhital.

Në fushën e **komunikimeve elektronike dhe teknologjive të informacionit dhe komunikimit**, u miratua në 2014 legjislacioni për njoftimin dhe konsultimin publik me qëllim përafrimin me *acquis* dhe parimet e Axhendës Dixhitale për Evropën. Për sa i përket rregullimit të tregut, janë ulur më tej tarifat fundore të telefonisë celulare (për thirrjet e marra) dhe AKEP ka vendosur një plan tarifash që do të miratohet nga të gjithë operatorët deri në janar 2016. Gjithashtu u dha licenca e katërt UMTS/3G. Progres është bërë në zbatimin e planit për përdorimin e frekuencave të miratuar nga AKEP në shkurt 2014. Është rritur kapaciteti administrativ i AKEP; megjithatë, nuk janë bërë përparime në rritjen e pavarësisë së saj operacionale. Nuk është bërë progres për vënien në funksion të numrit të emergjencave 112.

Ndërkohë që përdorimi i përgjithshëm i celularit është i lartë dhe përdorimi i brezit të gjerë celular ka arritur në 35 %, penetrimi i brezit të gjerë fiks ka mbetur i ulët në 7.3 % në 2014.

Në fushën e **shërbimeve të shoqërisë së informacionit**, në prill u miratua strategjia ndërsektoriale 'axhenda dixhitale' 2015-2020, që gjithashtu përfshinte rishikimin e planit kombëtar të transmetimit të vitit 2013. Është rritur numri i shërbimeve *e-government* të ofruara nëpërmjet portalit *e-Albania.al* për publikun dhe bizneset. Një infrastrukturë e centralizuar së bashku me një kapacitet të modernizuar dhe sigurimin e shërbimeve online për të gjitha institucionet e lidhura me rrjetin qeveritar është ngritur në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Kapaciteti i saj është dyfishuar dhe ka miratuar një strukturë të re organizative.

Në fushën e **politikës audiovizive**, progresi ka qenë i ngadaltë. Anëtarët e rinj të Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA) dhe kryetari i ri u emëruan në 2014. Opozita e kundërshtoi procesin e zgjedhjes në gjyq me pretendimin se nuk ishin ndjekur procedurat e duhura ligjore. Puna e AMA-s është penguar nga mungesa e anëtarëve të emëruar nga mbledhjet e opozitës. Ndërkohë që zbatimi i strategjisë për kalimin nga transmetimet analoge në ato dixhitale ka filluar në 2015 – pas përfundimit të çështjes gjyqësore të ngritur kundër entit rregullator nga disa transmetues – nuk është përmbushur afati për qershorin për të cilin ishte rënë dakord në nivel ndërkombëtar. Përpjekje thelbësore janë të nevojshme për të zbatuar kalimin dixhital sa më shpejt që të jetë e mundur. Kjo vlen gjithashtu për dixhitalizimin e vonuar të transmetuesit të shërbimit publik (RTSH), i cili nevojitet të përshpejtojë përgatitjet për të siguruar se mund të organizojë programet e veta dhe ato të operatorëve lokalë. Sistemi për mbledhjen e taksës së RTSH është përmirësuar. Që prej majit, Këshilli Drejtues i RTSH është plotësisht funksional. Pritet që ky autoritet të miratojë rregullat e tij të procedurës, zgjedhjes së anëtarëve të organit të ri të menaxhimit dhe të miratojë dokumentacionin dhe udhëzimet e nevojshme.

4.11 Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural

Politika e përbashkët bujqësore mbështet fermerët dhe zhvillimin rural. Kjo kërkon sisteme të forta menaxhimi dhe kontrolli. Ekzistojnë gjithashtu rregulla të përbashkëta të BE-së për politikën e cilësisë dhe bujqësisë organike.

Përgatitjet në bujqësi dhe zhvillimin rural janë në **fazë të hershme**. Janë bërë **disa përparime** në forcimin e kapaciteteve të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor Rural në përpjekje për t'i ngarkuar detyra që lidhen me zbatimin e buxhetit. Vitin e ardhshëm, vendi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

- rritjes së kapaciteteve të Zyrtarit Kombëtar Autorizues dhe Fondit Kombëtar për zbatimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit për Zhvillim Rural;
- krijimit të një regjistri fermash, ku të përcaktohet sistemi i informacionit kadastral për tokat dhe të konsolidohet regjistri i kafshëve, si pjesë përbërëse e administrimit të integruar dhe sistemit të kontrollit.

Për sa i përket **çështjeve horizontale**, qeveria ka vijuar me mbështetjen e saj të drejtpërdrejtë dhe skemat kombëtare në bujqësi dhe agropërpunim që arrijnë në 12,5 milion euro në 2015. Megjithë mbështetjen financiare të BE-së për kryerjen e censusit bujqësor, rezultatet përfundimtare të censusit nuk janë publikuar. Me qëllim përmirësimit të statistikave bujqësore, qeveria ka vendosur të kthejë detyrën e kryerjes së aktiviteteve statistikore nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Në fushën e **organizimit të tregut të përbashkët**, pritet për miratim zbatimimi i legjislacionit për ligjin e ri për vajin e ullirit. Aktiviteti në këtë fushë është kufizuar me miratimin e rregulloreve për standardet e marketingut për farëra. Nuk janë bërë përparime në hartimin dhe miratimin e standardeve për marketingun e produkteve bujqësore.

Strategjia 2014-20 për bujqësinë dhe **zhvillimin rural** u miratua në tetor. Strukturat operative të Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit për Zhvillim Rural (IPARD) (Agjencia e Pagesave dhe Autoriteti i Menaxhimit në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave) kanë fituar eksperiencë të mëtjshme pas zbatimit të skemës IPARD-like. Megjithatë, kapacitetet për menaxhimin e decentralizuar IPARD të strukturave të tjera operative, të tilla si Zyrtari Kombëtar Autorizues dhe Fondi Kombëtar në Ministrinë e Financave, ende nevojitet të forcohen në përputhje me kërkesat për t'u ngarkuar detyra që lidhen me zbatimin e buxhetit. Pas ratifikimit nga Parlamenti në prill të marrëveshjes kuadër, qeveria miratoi në korrik marrëveshjen sektoriale ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit Evropian që përcakton rregullat për menaxhimin dhe zbatimin e fondeve IPARD. Programi IPARD 2014-2020 u miratua në korrik. Zbatimimi i strategjisë për konsolidimin e tokës, që pritet të miratohet, kërkon forcimin e kapaciteteve administrative në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Në fushën e **politikës së cilësisë**, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ende nuk ka hartuar legjislacionin zbatues për ligjin e ndryshuar mbi të drejtat e pronësisë industriale.

Për sa i përket **bujqësisë organike**, ka vazhduar dhënia e subvencioneve nëpërmjet skemave të drejtpërdrejta dhe trajnimeve mbi prodhimin organik. Ende nuk ka një ligj për bujqësinë organike.

4.12 Kapitulli 12: Politika e sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare

Rregullat e higjienës sipas BE për prodhimin e produkteve ushqimore sigurojnë nivel të lartë të sigurisë së ushqimit. Shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve dhe siguria e ushqimit me orgjinë shtazore mbrohen sipas këtyre rregullave së bashku me cilësinë e farërave, materialin për mbrojtjen e bimëve, organizmat e dëmshëm dhe ushqimin e kafshëve.

Shqipëria ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në politikën e sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare. Ka pasur **disa përparime**, kryesisht në lidhje me kontrollin e sigurisë ushqimore. Përmirësimet në këtë fushë do të ndihmonin shumë në rritjen e potencialit për eksport. Vitin e ardhshëm, vendi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ trajnimit të stafit dhe përmirësimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përkatëse me qëllim forcimin e kapaciteteve në lidhje me përafrimin me legjislacionin e BE-së në këtë fushë;

→ miratimit të strategjisë për ristrukturimin e sektori;

→ zbatimit të rregullave për sigurinë ushqimore, duke përfshirë kontrollet zyrtare, kushtet e importit dhe kontrollet, kërkesat për gjurmueshmërinë e ushqimit për njerëzit dhe kafshët, dhe nivelet maksimale të mbetjeve pesticide.

Në fushën e **sigurisë së përgjithshme ushqimore**, ende nuk janë miratuar procedurat e brendshme dhe planet operacionale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Nuk është ndërmarrë asnjë hap në aspektin e kuadrit ligjor dhe institucional

për sistemin e sigurisë ushqimore nëpërmjet përcaktimit të përgjegjësive dhe bashkëpunimit ndërmjet organeve zbatuese. Rregullat për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Komitetit Shkencor dhe Paneleve nuk janë finalizuar.

Për sa i përket **politikës veterinare**, janë zhvilluar tre vaksinime masive të dhelprës së kuqe kundër tërbimit, dhe janë ngritur kapacitetet laboratorike përkatëse për diagnostikimin dhe monitorimin e sëmundjes së tërbimit. Është zhvilluar gjithashtu vaksinimi i kafshëve zëvendësuese kundër brucelozës në bagëtitë e imëta. Shërbimi veterinar është i fragmentuar, me procedura të paqarta dhe burime të kufizuara njerëzore dhe financiare. Bazat e të dhënave të kafshëve nuk janë përditësuar rregullisht, për shkak të mungesës së raportimit për lëvizjet e kafshëve dhe veçanërisht për therjen e kafshëve. Raportimi i sëmundjeve duhet të përmirësohet.

Në fushën e **hedhjes në treg të ushqimit për njerëz dhe kafshë dhe nënprodukteve shtazore**, ka filluar të përdoret baza e të dhënave e stabilimenteve ushqimore (AKUnet) për përgatitjen e planeve të inspektimeve zyrtare. Programet e monitorimit të mbetjeve për substancat e padëshiruara të tilla si ilaçet veterinare, mykotoksinat dhe metalet e rënda janë duke u zbatuar në bagëti të imëta, derra, vezë, qumësht, mjaltë dhe peshk. Programet duhet të përcaktojnë kapacitetet sasiore të testimit për praninë e aflatoksinave në produktet ushqimore.

Për sa i përket **rregullave të sigurisë ushqimore**, nuk janë bërë përparime në përditësimin e rregulloreve për etiketimin e ushqimit, materialet në kontakt me ushqimin dhe agjentët ndotës në përputhje me *acquis* relevante. Frekuenca e monitorimit mikrobiologjik të qumështit të papërpunuar duhet të rritet në përputhje me rregulloret ekzistuese, dhe duhet të rriten masat që detyrojnë prodhuesit të adoptojnë praktikën e mira të higjenes për prodhimin e qumështit më të sigurtë.

Legjislacioni për **rregullat specifike për ushqimet e kafshëve** mbetet i paplotë dhe i pakonsoliduar.

Në fushën e **politikës fitosanitare**, kapacitetet administrative dhe teknike mbeten të limituara. Nuk janë bërë përparime në sektorët e organizmave të dëmshëm dhe materialeve për shumimin e farërave dhe bimëve.

Në lidhje me **organizmat të modifikuara gjenetiki** (OMGJ), Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, është ende duke vlerësuar legjislacionin relevant të BE-së.

4.13 Kapitulli 13: Peshkimi

Politika e përbashkët e peshkimit mbron burimet e gjalla të detit dhe kufizon impaktin mjedisor të peshkimit. Kjo përfshin përcaktimin e kuotave të zënive, menaxhimin e kapaciteteve të flotës së peshkimit, rregullat për akuakulturën, si dhe mbështetjen për komunitetet e peshkimit dhe ato bregdetare.

Përgatitjet për peshkimin janë në **fazë të hershme. Nuk janë bërë përparime** në këtë fushë. Vitin e ardhshëm, vendi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ miratimit të strategjisë së sektorit;

→ forcimit të kapaciteteve administrative për të siguruar menaxhimin e duhur të burimeve peshkore dhe zbatimin e rregulloreve.

Menaxhimi i burimeve dhe flotës së peshkimit vazhdojnë të vuajnë nga mungesa e detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara qartë, bashkëpunimit institucional dhe kapaciteteve. Libri i anijes nuk përditësohet vazhdimisht. Statistikat për sasinë e peshkut të zbarkuar mbeten të pasakta, sidomos në lidhje me të dhënat për peshkimin e vogël nga ujërat bregdetare, lagunat dhe ujërat e brendshme. Ligji për akuakulturën ende nuk është miratuar.

Në fushën e **inspektimit dhe kontrollit**, janë bërë disa përparime në parandalimin e peshkimit të paligjshëm dhe të parregulluar në liqenet kryesore. Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës vazhdon të ketë mungesa në burimet e nevojshme dhe bashkëpunimin e nevojshëm me organet e tjera për të siguruar parandalimin efektiv të praktikave të paligjshme të peshkimit, veçanërisht në ujërat detare. Funksionimi i Sistemit të Monitorimit të Anijeve

i ngritur në 2011, ka qenë objekt ndërprerjesh për shkak të vonesave në procedurat e prokurimit për sigurimin e shërbimeve. Kjo rrezikon zgjidhje praktike dhe afatgjata për mirëmbajtjen dhe funksionimin e tij.

Për sa i përket **ndihmës shtetërore**, mbështetja e drejtpërdrejtë e qeverisë për akuakulturën ka vazhduar, me subvencione deri në 25 % të çmimit të paguar për peshqit e vegjël dhe për ushqim. Qeveria ka miratuar gjithashtu një vendim që përjashton mjetet lundruese të peshkimit nga taksa e karbonit dhe nga TVSH e karburantit.

Në fushën e **marrëveshjeve ndërkombëtare**, Shqipëria ka vijuar bashkëpunimin me Komisionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut dhe ka marrë pjesë rregullisht në takimet e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (GFCM). Megjithatë, janë raportuar mangësi në zbatimin e vendimeve të GFCM dhe vështirësi në transmetimin e të dhënave nga Shqipëria.

4.14 Kapitulli 14: Politikat e transportit

BE ka rregulla të përbashkëta për standardet teknike dhe të sigurisë, standardet sociale, ndihmën shtetërore dhe liberalizimin e tregut në transportin rrugor, hekurudhor, ujërat e brendshme, rrugët ujore, transportin e kombinuar, aviacionin dhe transportin detar.

Shqipëria ka **njëfarë niveli të përgatitjes** në këtë fushë, ku disa përparime janë bërë në politikat e transportit. Vitin e ardhshëm, vendi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ shtimit të përpjekjeve për zbatimin e reformës në sektorin hekurudhor, në veçanti duke siguruar pavarësinë e nevojshme të lëvizjes së trenave nëpërmjet menaxhimit të infrastrukturës në përputhje me *aquis*;

→ forcimit të kapaciteteve administrative për të gjitha llojet e transportit, veçanërisht për të siguruar zbatimin e legjislacionit për mallrat e rrezikshme;

→ miratimit dhe zbatimit të strategjisë së transportit

Në fushën e **transportit rrugor**, është ndryshuar kodi rrugor me qëllim përafrimin me direktivën e BE për lejet e drejtimit. Siguria rrugore mbetet problem serioz; legjislacioni për transportin e mallrave të rrezikshme është përafruar plotësisht me *aquis*, por nuk është zbatuar plotësisht sepse mungojnë kapacitetet në Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor. Legjislacioni për infrastrukturën rrugore dhe inspektimin e automjeteve duhet të përafrohet më tej me *aquis*. Nuk janë bërë përparime në përafrimin me *aquis* në fushën e lejimit të veprimtarisë së sipërmarrësit të transportit rrugor dhe aksesit në tregun e transportit rrugor. Në mars, ka filluar procesi për vendosjen e limiteve për emetimet e gazeve.

Në fushën e **transportit hekurudhor**, ligji i ri për hekurudhat ende nuk është finalizuar. Pas miratimit, ky ligj duhet t'i hapë rrugë ndarjes së Sistemit Hekurudhor Shqiptar aktual, duke ndarë kështu lëvizjen e trenave nga menaxhimi i infrastrukturës në përputhje me *aquis*, si dhe krijimit të autoritetit të pavarur të sigurisë dhe autoritetit rregullator. Niveli i investimeve në infrastrukturën hekurudhore mbetet i papërfillshëm, duke rezultuar në përkeqësimin e shërbimeve të transportit.

Për sa i përket **transportit ajror**, Shqipëria ka përmbushur angazhimet e iniciativës për Qiellin e Përbashkët Evropian për fazën e parë kalimtare të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit, por më shumë punë nevojitet për të plotësuar kërkesat e mbetura. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar (AAC) duhet të adresojë gjetjet e mospërputhjes sipas inspektimit të kryer nga Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit në lidhje me administrimin e trafikut ajror dhe shërbimet e navigacionit ajror. Në dhjetor ndryshoi ligji për AAC me qëllim rritjen e autonomisë së tij institucionale, organizative dhe menaxhuese; megjithatë AAC-së ende i mungojnë kapacitetet për të siguruar mbikëqyrjen e të gjitha organizatave që operojnë nën mbikëqyrjen e tij. Shqipëria merr pjesë në mënyrë aktive në iniciativën e zonës për sigurimin e shërbimeve të përbashkëta (JSPA).

Në fushën e **transportit detar**, si rezultat i daljes nga shërbimi të një numri mjetesh lundrimi, koha e qëndrimit e mjeteve të lundrimit që mbajnë flamur shqiptar ka rënë dhe flota kombëtare e peshkimit ka mbetur në listën gri të Memorandumit të Mirëkuptimit të Parisit (MoU) për Kontrollin Shtetëror Portual. Shqipëria duhet të vazhdojë përpjekjet për anëtarësimin e saj në MoU të Parisit dhe për të ulur më tej kohën e qëndrimit të mjeteve të saj të lundrimit. Nevojitet më shumë përparim për përafrimin me *acquis* të legjislacionit për raportimin e formaliteteve për mjetet e lundrimit.

4.15 Kapitulli 15: Energjia

Politika e BE-së për energjinë mbulon konkurrencën dhe ndihmat shtetërore, aksesin e barabartë në burimet, tregun e brendshëm të energjisë, efikasitetin e energjisë, energjinë bërthamore dhe sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimet.

Shqipëria ka bërë **përgatitje të moderuar** në këtë fushë. Janë bërë **disa përparime** në përafrimin me *acquis* të energjisë, më specifiku në përafrimin e legjislacionit për sektorin e energjisë elektrike me *acquis* relevant dhe përmirësimin e normës së arkëtimeve. Vitin e ardhshëm, vendi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ përmirësimin të rimëkëmbjes financiare të kompanisë shtetërore të prodhimit të energjisë dhe sigurimit të qëndrueshmërisë ekonomike të sektorit të energjisë elektrike duke reduktuar humbjet në sektorin e shpërndarjes dhe duke përmirësuar normën e arkëtimeve;

→ miratimit dhe zbatimit të strategjisë kombëtare të energjisë dhe zbatimit të ligjit të miratuar në prill 2015 për sektorin e energjisë elektrike;

→ miratimit të planit kombëtar të veprimit për efikasitetin e energjisë dhe për energjinë e rinovueshme.

Në lidhje me **sigurinë e furnizimit me energji**, vazhdojnë përgatitjet për ndërtimin e linjës së interkonjeksionit 400 kV ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës por që u shtynë për shkak të zbulimit të një vendi të lashtë historik. Ka vijuar puna për ndërtimin e një linje transmisioni 100 kV në jug të Shqipërisë. Ka përfunduar studimi i fizibilitetit dhe vlerësimi i ndikimit mjedisor për ndërtimin e linjës së interkonjeksionit 400 kV me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Në janar, u nënshkrua një marrëveshje për funksionimin e përhershëm të sistemit shqiptar të transmetimit të energjisë elektrike në sinkron me sistemin Evropian kontinental, si një hap drejt anëtarësimin të plotë të Shqipërisë në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit (ENTSO-E). Shqipëria ka arritur të mbulojë 100% të kërkesave të saj nga burimet ujore, megjithëse ka prodhuar 32% më pak energji elektrike në 2014 krahasuar me 2013 si rezultat i kushteve të këqija hidrologjike. Puna ndërtimore për projektin e Gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP) ka filluar në korrik. Ndërtimi i Gazsjellësit Jon Adriatik (IAP) ka filluar në mars dhe u konkretizua me një deklaratë të përbashkët për IAP të nënshkruar ndërmjet Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Malit të Zi dhe Kroacisë. Shqipëria ka vijuar me përgatitjet për zhvillimin e një masterplani të gazit. Termocentrali i Vlorës ende nuk është funksional.

Legjislacioni për hidrokarburet u ndryshua në mars për të parashikuar kërkesa të reja për një raportim sa më transparent. Si rezultat i kontrollit të parë dhe verifikimeve të kryera në muajin maj, Shqipëria ka revokuar 23 licenca të kompanive të tregtimit të hidrokarbureve. Shqipëria vazhdon të plotësojë gjerësisht detyrimin për të mbajtur rezerva vendase që korrespondojnë me 90 ditë të importeve.

Në fushën e **tregut të brendshëm energjetik**, ligji i ri për sektorin e energjisë elektrike i përafuar me paketën e tretë të BE-së për energjinë u miratua në prill dhe ligji për sektorin e gazit natyror u miratua në shtator 2015. Enti Rregullator i Energjisë ka miratuar strukturën e re për tarifën e energjisë elektrike për vitin 2015. Në 2014, humbjet jo-teknike në shpërndarjen e energjisë elektrike u reduktuan në 44% të humbjeve në shpërndarje, krahasuar me 61% vitin e kaluar. Norma e arkëtimeve u rrit në 92.6% në 2014, krahasuar me 83% në 2013. Në shkurt, qeveria miratoi një plan financiar për rimëkëmbjen për sektorin e energjisë elektrike dhe një plan veprimi për pesë vitet e ardhshme. Megjithë përpjekjet për të likuiduar detyrimet e prapambetura të akumuluar para vitit 2014, detyrimet e prapambetura nga operatori publik i energjisë vazhdojnë të krijojnë vështirësi financiare për operatorët privatë në këtë sektor.

Në fushën e **energjisë së rinovueshme**, Komuniteti i Energjisë hapi procedurë formale hetimore duke dërguar opinionin e tij të arsyetuar në shkurt dhe një kërkesë të arsyetuar në maj për mos-dorëzimin nga Shqipëria të një plan veprimi mbi energjinë e rinovueshme. Në tetor, u ndryshua legjislacioni për sektorin e hidrokarbureve dhe përfshinte prodhimin, transportimin dhe tregtimin e *bio-fuels* dhe burimeve të tjera të rinovueshme. Çdo zhvillim i mëtejshëm i energjisë hidrike duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin mjedisor të BE-së. Ligji për **eficencën e energjisë** në ndërtesa ende nuk është miratuar nga Parlamenti. Shqipëria humbi afatin e përcaktuar nga Komuniteti i Energjisë për të përafuar ligjin e saj me Direktivën 2006 për Eficencën e Energjisë për Përdoruesit Fundorë dhe Shërbimet e Energjisë. Plani i dytë kombëtar për eficientë të energjisë mbetet për t'u miratuar.

Në fushat e **energjisë bërthamore, sigurisë bërthamore dhe mbrojtjes nga rrezatimet**, u miratua në dhjetor rregullorja për mbrojtjen e punëtorëve nga risqet që lidhen me rrezatimin jo-jonizues në vendin e punës, me synim përaftrimin me *acquis* relevant.

4.16 Kapitulli 16: Tatimet

Rregulla e BE-së për tatimet mbulojnë tatimin mbi vlerën e shtuar dhe detyrimet e akcizës si dhe aspekte të tatimit të të ardhurave nga kursimet e individëve dhe të taksave korporative. Gjithashtu këto rregulla kanë të bëjë me bashkëpunimin ndërmjet administratave tatimore, përfshirë shkëmbimin e informacionit për parandalimin e evazionit tatimor.

Shqipëria ka bërë **përgatitje të moderuara** në fushën e tatimeve. Janë bërë disa përparime, veçanërisht për sa i përket përaftrimin legjislativ me *acquis* për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe akcizën. Performanca e të ardhurave në 2014 është rritur, si rezultat i rritjes së taksave dhe përmirësimeve në administratën tatimore, por që nuk është rritur sa ishte buxhetuar për 2015. Vitin e ardhshëm, vendi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ zbatimit me efektivitet të legjislacionit të ri të TVSH, gjë që kërkon rritjen e ndërgjegjësimit të bizneseve dhe trajnimin e punonjësve tatimorë;

→ zbatimit me rigozitet të masave për parandalimin e detyrimeve të reja të papaguara të TVSH dhe adresimit të ankesave të bizneseve për vonesat në rimbursimin e TVSH;

→ garantimit se sistemi i ri i IT është efektiv në reduktimin e praktikave arbitrare, mashtrimin dhe korrupsionit dhe në përmirësimin e shkëmbimit të informacionit.

Në fushën e **tatimit të tërthortë**, ligji për *tatimin mbi vlerën e shtuar* dhe legjislacioni zbatues kanë hyrë në fuqi në janar. Ligji kërkon përaftrimin me Direktivën e TVSH por ende përmban përjashtime (normat zero) të cilat nuk janë në përputhje me *acquis*. Ai përcakton afate të qarta për pagesat e kërkesave për rimbursimin e TVSH-së. Janë marrë masa për të rimbursuar pothuajse të gjitha detyrimet e prapambetura të TVSH. Legjislacioni për TVSH dhe procedurat tatimore ka ndryshuar në korrik për të parashikuar ngritjen e një njësie qendrore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve e cila do të përpunojë kërkesat për rimbursimin e TVSH-së të bazuar në një model risku me qëllim shkurtimin e kohëzgjatjes së procedurës. Udhëzimet zbatuese për disa procedura për përjashtimin e TVSH-së u miratuan gjithashtu në qershor. Ligji i *akcizës* u ndryshua në dhjetor, duke rritur akcizën për produktet e duhanit, duke bërë ndryshime të akcizës për pijet energjike dhe duke hequr akcizën për bitumin natyror. Më shumë punë nevojitet për përaftrimin e normave të akcizës me *acquis*.

Në fushën e **tatimit të drejtpërdrejtë**, norma e tatimit mbi të ardhurat personale të vënë mbi aksionet, dhënien me qira të pasurisë të paluajtshme dhe të drejtën e autorit ka arritur në 15%, ndërkohë që janë përjashtuar të ardhurat nga skemat e pensioneve vullnetare. Hapa të mëtejshme nevojiten për të përmirësuar transparencën dhe konsultimet publike për hartimin e legjislacionit fiskal.

Për sa i përket **bashkëpunimit administrativ dhe asistencës së ndërsjellë**, Shqipëria ka marrë pjesë në programin Fiscalis 2020 të BE-së që prej janarit. Administrata tatimore është duke bashkëpunuar me agjencitë italiane të të ardhurave për çështje që lidhen me transferimin e çmimit në kuadrin e programit të OECD.

‘Inspektorë tatimorë pa kufi’. Marrëveshjet për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit tatimor janë nënshkruar me Islandën dhe Federatën Zvicerane.

Për sa i përket fushës së **kapaciteteve operacionale dhe të kompjuterizimit**, një sistem i ri IT është instaluar në administratën tatimore që nga janari. Deklarimi i të ardhurave tatimore personale duhet të bëhet në rrugë elektronike. Problemet fillestare teknike të hasura nga taksapaguesit janë zgjidhur. Bashkëpunimi ndërmjet administratës tatimore dhe doganore është forcuar duke siguruar interoperabilitetin ndërmjet sistemeve të tyre IT. Janë marrë masa për të luftuar evazionin fiskal në tregun e karburanteve. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka forcuar bashkëpunimin e saj me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Kapacitetet e administratës tatimore për menaxhimin dhe grumbullimin e të ardhurave nevojitet të rriten për të siguruar përputhshmërinë tatimore dhe për të parandaluar luhatje të mëtejshme të të ardhurave.

4.17 Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare

Rregullat e BE-së kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore dhe ndalojnë financimin e drejtpërdrejtë nga ana e tyre të sektorit publik. Shtetet Anëtare koordinojnë politikat e tyre ekonomike dhe janë objekt i mbikëqyrjes fiskale, ekonomike dhe financiare.

Shqipëria ka bërë **përgatitje të moderuar** në fushën e politikave ekonomike dhe monetare. Janë bërë disa përpjekje në veçanti nëpërmjet përmirësimit të buxhetimit shumë-vjetor dhe transparencës në përgatitjen e buxhetit, por nevojiten konsultime të mëtejshme me komunitetin e biznesit për hartimin e masave fiskale. Vitin e ardhshëm, vendi duhet t’i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ forcimit të mëtejshëm të kornizës afatmesme buxhetore dhe rritjes së funksionit *commitment control*, pjesërisht duke miratuar një rregull fiskal të mirë-hartuar në përputhje me Direktivën për kërkesat në lidhje me kornizat buxhetore;

→ sigurimit të koordinimit të brendshëm më të mirë dhe konsultimeve me aktorët e jashtëm kur formulohen prioritetet e reformave strukturore, për të forcuar pronësinë dhe zbatimin.

Në fushën e **politikës monetare**, Ligji për Bankën e Shqipërisë duhet të përafrohet me *acquis* në lidhje me pavarësinë personale të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe përgjegjshmërinë e Bankës. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë është plotësisht funksional pas emërimit respektivisht në shkurt dhe prill të guvernatorit të ri dhe kryeinspektorit të ri. Siguria, transparenca dhe auditimi i brendshëm i bankës janë forcuar. Ligji për Bankën qendrore përcakton objektivin kryesor për stabilitetin e çmimeve, në përputhje me objektivin kryesor të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. Banka e Shqipërisë ka ulur normën bazë të interesit në disa hapa gjatë gjashtë viteve të fundit deri në uljen e re historike prej 2% në janar 2015 në përpjekje për të orientuar inflacionin drejt normës së synuar prej 3%. Megjithatë, inflacioni mbetet nën objektivin përkatës.

Në fushën e **politikës ekonomike**, Shqipëria miratoi në janar Programin e Reformës Ekonomike (PRE) Korniza fiskale dhe ajo makroekonomike e programit janë përmirësuar; lidhjet ndërmjet hipotezave fiskale dhe makroekonomike dhe masave të reformës strukturore janë bërë edhe më eksplicite. Megjithatë, duhet të përmirësohen më tej kapacitetet për formulimin e politikës ekonomike dhe zbatimin e saj. Bashkëpunimi i brendshëm i programit dhe konsultimet me aktorët e jashtëm mbetet i dobët. Për herë të parë, si pjesë e ligjit për buxhetin, Parlamenti miratoi perspektivat për shpenzimet buxhetore dhe të ardhurat për periudhën 2015- 2017. Buxheti për vitin 2015 dhe Korniza Makroekonomike dhe Fiskale 2016–2018 janë rishikuar në korrik 2015 për arsye të deficitit në të ardhurat. Parashikimi i Buxhetit duhet të përmirësohet.

Standardet 2010 të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010) janë zbatuar pjesërisht në të dhënat vjetore të GDP-së dhe përpjekje të mëtejshme nevojiten në këtë fushë (*shih gjithashtu Kapitulli 18: Statistikat*). Janë bërë përpjekje për menaxhimin financiar publik nëpërmjet miratimit të strategjisë së menaxhimit financiar publik dhe plan veprimt.

4.18. Kapitulli 18: Statistikat

Për sa i përket **infrastrukturës statistikore**, kuadri ligjor është në përputhje me statistikatat Evropiane. Kodi i Praktikës dhe klasifikimet janë në përputhje me standardet evropiane dhe aplikohen në anketimet statistikore. INSTAT është prodhuesi dhe koordinatori kryesor i statistikave dhe pavarësia e tij profesionale është parashikuar në ligj, por ka nevojë të përforcohet në praktikë nëpërmjet pavarësisë në përcaktimin e stafit dhe buxhetit. Në mars, INSTAT nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave. Roli koordinues i tij në sistemin kombëtar të statistikave duhet të forcohet nëpërmjet përmbylljes së Memorandumit të Mirëkuptimit dhe rritjes së statusit dhe qëndrimit të tij në administratën publike.

Për sa i përket **statistikave makroekonomike**, INSTAT përmirësoi të dhënat e llogarive kombëtare bazuar në konceptet dhe metodologjinë e Sistemit Evropian të Llogarive 2010 (ESA 2010). Të dhënat vjetore dhe tremujore për prodhimin e brendshëm bruto (PBB) janë nxjerrë me çmimet konstante dhe aktuale. Shqipëria ka përgatitur statistikatat financiare të qeverisë dhe tabelat informuese të procedurës të deficitit të tepruar (PDT) dhe INSTAT i paraqiti ato tek EUROSTAT në dhjetor 2014. Është prezantuar një metodë e re vlerësimi për llogaritjen vjetore të PBB bazuar në qasjen e shpenzimeve, e pavarur nga qasja e prodhimit. Në shkurt, INSTAT publikoi për herë të parë, tabelat furnizim/përdorim dhe tabelat input dhe output për vitet 2009-2011 sipas ESA 2010. Burimet e të dhënave për statistikatat makroekonomike kanë nevojë për përmirësim, veçanërisht nga mbajtësit e të dhënave jashtë INSTAT-it.

Statistikatat strukturore të biznesit dhe statistikatat afat-shkurta për industrinë dhe ndërtimin janë në përputhje me acquis, por nevojiten përmirësime të cilësisë si dhe përpjekje për të përmirësuar statistikatat për sektorin e shërbimeve. Klasifikimi i rishikuar statistikor i aktiviteteve ekonomike (NACE Rev, 2) filloi të zbatohet në janar 2015 nga qendrat statistikore, ministritë, institucionet qendrore dhe vendore, personat fizikë dhe juridikë, të cilët kryejnë aktivitete ekonomike në vend. Statistikatat mbi kërkimin dhe zhvillimin, teknologjitë e informacionit dhe komunikimit dhe mbi inovacionin kanë nevojë për përputhje. Në qershor, INSTAT zhvilloi një rishikim sektorial të biznesit.

Në **statistikatat sociale**, statistikatat demografike kanë dalë gjerësisht. Një studim pilot për të ardhurat dhe kushtet e jetesës u krye në nëntor. Statistikatat e tregut të punës janë gjerësisht në përputhje me acquis. Anketimi i fuqisë punëtore zhvillohet dhe publikohet rregullisht dhe rezultatet nga anketimi për koston e punës për vitin 2012 është publikuar. Indeksi për koston e punës dhe struktura e të dhënave të fitimit ende nuk janë nxjerrë. Në qershor, shteti adoptoi versionin e fundit Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit (ISCED 2011). Statistikatat e migracionit të jashtëm duhen të përmirësohen.

Statistikatat bujqësore janë pjesërisht në përputhje me acquis. Në qershor, INSTAT prezantoi statistikatat për bujqësinë dhe bagëtitë për 2014. Rezultatet e censusit për pronat bujqësore nuk janë publikuar ende, si dhe regjistri statistikor për ferma nuk ka përfunduar. Transferimi i përgjegjësisë për të zhvilluar sondazhet bujqësore nga INSTAT tek Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave do të kërkojë përmirësim të kapacitetit teknik dhe mekanizmin e duhur të koordinimit me INSTAT.

Statistikatat mjedisore dhe energjitike janë pjesërisht në përputhje me acquis. Bilanci për energjinë elektrike u dha për periudhën 2000-2014; Bilanci i energjisë për burime të tjera energjitike ende mungon. Si pjesë e Rrjetit Evropian për Informacion dhe Vëzhgim të Mjedisit (EIONET), Ministria e Mjedisit raporton në kohë dhe në mënyrë korrekte në Agjencinë Evropiane për mbrojtjen e Mjedisit për cilësinë e ajrit dhe ujërave. Megjithatë statistikatat

mjedisore nuk janë të plota dhe nuk përditësohen rregullisht. Statistikat mbi mbetjet, ujërat dhe mbi ujërat e zeza kanë nevojë të përmirësohen. Bilanci i qarkullimit të materialeve dhe statistikat e shpenzimeve për mbrojtjen e mjedisit nuk kanë dalë ende.

Përfundim

Ka pasur përparime për sa i përket përgatitjes së statistikave. Është bërë progres në përafrimin e metodologjisë me standardet e BE-së në disa fusha të statistikave. Megjithatë, nevojiten përpjekje të konsiderueshme në veçanti për forcimin e burimeve financiare dhe njerëzore të Institutit të Statistikave (INSTAT) për të përmbushur standardet evropiane, për përmirësimin e cilësisë së statistikave dhe për të siguruar përafrimin e statistikave bujqësore, të biznesit dhe sociale. Roli i INSTAT-it si koordinator i sistemit kombëtar të statistikave duhet të përmirësohet.

Shqipëria duhet të forcojë pozitën e INSTAT-it në administratën publike nëpërmjet ndryshimeve në strukturat e pagave dhe pozicioneve të punës për nëpunësit civilë. Duhet të përmirësohet pavarësia profesionale e INSTAT-it me ndryshime në ligjin për statistikën, ndër të tjera, duke garantuar pavarësinë profesionale të INSTAT-it në rekrutim dhe staf. Duhet të përafrohen statistikën me sistemin Evropian të llogarive (ESA 2010)

4.19. Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi

Për sa i përket **ligjit të punës**, ndryshimet në Kodin e Punës janë aprovuar nga qeveria, por mbeten për t'u miratuar nga Kuvendi. Ato synojnë synon përafrimin e Kodit në linjë me *acquis* për shëndetin dhe sigurinë në punë, mosdiskriminimin, marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve, dhe parashikimin e sigurimit shoqëror për disa profesione të pambrojtura. Ato gjithashtu reflektojnë rekomandimet e Komitetit të Ekspertëve të Këshillit të Evropës për të Drejtat Sociale dhe angazhimet për zbatimin e konventave dhe rekomandimeve përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Për sa i përket **shëndetit dhe sigurisë në punë**, janë miratuar katër rregullore të reja, të cilat mbulojnë risqet që vijnë nga fushat elektromagnetike, rrezatimi optik artificial, zhurmat dhe vibracionet, duke synuar përafrimin e legjislacionit me *acquis*. Qeveria miratoi legjislacionin dytësor lidhur me masat e sigurisë për gratë shtatëzane, mbrojtjen e të miturve në vendin e punës dhe industrinë e peshkimit. U bënë përpjekje për të përmirësuar inspektimet e punës duke trajnuar inspektorët për zbatimin e legjislacionit tëri për sigurinë dhe shëndetin dhe duke zgjeruar raportimin elektronik tek Inspektoriatet Rajonale të Punës. Raportimi i aksidenteve dhe inspektimet e punës për zbulimin e punonjësve të padeklaruar u përmirësua. Numri i aksidenteve të raportuara në punë është rritur nga 86 në 2013, në 111 raste në vitin 2014.

Në lidhje me **dialogun social**, Këshilli Kombëtar i Punës (KKP) po funksionon plotësisht; megjithatë nevojiten më shumë përpjekje për marrëveshjet kolektive në të gjitha nivelet dhe për rritjen e kapaciteteve të partnerëve socialë për të negociuar marrëveshje kolektive. Disa partnerë social shprehën shqetësim për përjashtimin e tyre nga 6 Këshillat (KKP) tripalësh. Dialogu social dypalësh duhet të përmirësohet dhe autonomia e partnerëve socialë ka nevojë të rritet. Mbetet shumë për t'u bërë për zhvillimin e dialogut social në nivel vendor dhe ndërmarrjesh.

Në lidhje me **politikën e punësimit**, janë miratuar Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim dhe Plani i Veprimit 2014 - 2020, por nuk ka ende në funksion një mekanizëm monitorimi për zbatimin e tyre. Në qershor, qeveria miratoi Planin Kombëtar të Veprimit për të Rinjtë 2015-2020. Shkalla e papunësisë e vlerësuar nga Anketa e Fuqisë Punëtore ka rënë nga 18.2% që ishte në tremujorin e parë të 2014 në 16.9 % në tremujorin e parë të 2015. Megjithatë papunësia mbetet e lartë, sidomos tek gratë, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara. Shkalla e punësimit për burra u rrit nga 50.7% në 2013, në 51.4% në 2014, ndërkohë që shkalla e punësimit për gratë ra nga një përqindje e ulët 38.0% në 2013 në 37.6% në 2014. Në 2014, papunësia afatgjatë përfaqësoi rreth 54.2% të papunësisë së përgjithshme. Kapacitetet

administrative për vende pune u rritën, me krijimin e pesë zyrave të reja punësimi. Statistikat e tregut të punës janë të përafuara me *acquis*. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar mbulimin e të dhënave. Bujqësia mbetet ofruesi kryesor i punës, ndjekur nga shërbimet e tregut dhe shërbimet jo të tregut. Ekonomia informale mbetet një ofrues i rëndësishëm i vendeve të punës, që përbën rreth 40% të punësimit në sektorin jo-bujqësor. Nuk ekziston një qasje gjithëpërfshirëse për inspektimin e aktivitetit informal të punësimit.

Nuk ka pasur përmirësime mbi **Fondin Social Evropian**. Marrëveshja e pjesëmarrjes së Shqipërisë në Programin për Punësimin dhe Inovacionin Social (EaSI) u nënshkrua.

Përsa i përket **përfshirjes sociale**, ka nisur një reformë për mbrojtjen sociale. Shërbimet themelore sigurohen për banorët shqiptarë, por duhet të përmirësohen. Shumë shërbime sociale varen nga donatorë të huaj dhe shoqëria civile, dhe kanë një bazë ligjore të paqartë dhe buxhet të pamjaftueshëm.

Përsa i përket përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara, është siguruar trajnim për të gjithë punonjësit socialë, stafin e Qendrave për Mbrojtjen e Fëmijëve, për mësuesit e shkollave dhe kopshteve për të nxitur përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Megjithatë, personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me vështirësi në aksesin në arsim, banim, ndihmë ligjore, punësim, kujdes shëndetësor dhe shërbime sociale. Dispozitat ligjore për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk zbatohen efektivisht. Pagesat për aftësi të kufizuara janë të lidhura me indeksin e çmimit të konsumatorit të publikuar nga INSTAT.

Në fushën e **mbrojtjes sociale**, po vazhdon procesi i reformës së pensioneve. Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që bashkitë luajnë në sigurimin e shërbimeve sociale, të gjitha strategjitë dhe politikat për përfshirjen dhe mbrojtjen sociale duhet të jenë ngushtësisht të koordinuara me reformën territoriale dhe administrative, e cila uli ndjeshëm numrin e bashkive.

Përsa i përket **anti-diskriminimit**, numri i ankesave të trajtuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) u rrit; megjithatë, kërkohet një informim dhe qasje më proaktive. KMP ka rritur ndjeshëm pjesëmarrjen në proceset gjyqësore, duke marrë pjesë në 18 procese gjyqësore në 2014, krahasuar me 6 në 2013.

Në fushën e **mundësive të barabarta**, duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të rritur përfaqësimin e grave në tregun e punës dhe për të siguruar mundësi dhe trajtim të barabartë. Gratë përbëjnë vetëm 24% të forcës punëtore por 60% të papunësisë afatgjatë të regjistruar. (*Shih gjithashtu - Kapitullin 23 - Sistemi gjyqësor dhe të drejtat themelore*)

Përfundim

Ka pasur disa përparime në fushën e politikave sociale dhe punësimit. Janë bërë përpjekje drejt përafrimit me *acquis* të BE-së për shëndetin dhe sigurinë në punë. Reformat kyçe në fushën e mbrojtjes sociale kanë filluar. Ndryshimet në Kodin e Punës dhe Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësim u miratuan. Shkalla e punësimit dhe pjesëmarrja në tregun e punës mbetet e ulët dhe ekonomia informale është ende një ofrues i rëndësishëm pune. Për vitin e ardhshëm, vendi duhet të finalizojë dhe miratojë strategjinë e mbrojtjes sociale 2015-2020 dhe të sigurojë zbatimin efektiv. Ka nevojë për më shumë progres në reformën e mbrojtjes sociale. Statistikat e tregut të punës dhe zhvillimi i statistikave sociale duhet të përmirësohen më tej në përputhje me anketimet evropiane.

4.20. Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe politika industriale

Në lidhje me **parimet e ndërmarrjeve dhe politikave industriale**, në tetor të vitit 2014 u miratua Strategjia e zhvillimit të biznesit dhe investimeve dhe Plani i Veprimit. Ato janë në linjë me parimet e aktit të BE-së për biznesin e vogël, planet kombëtare për Evropën Juglindore

Strategjinë 2020 dhe indikatorët e “Të bësh biznes” të Bankës Botërore. Legjislacioni për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe për licencat, autorizimet dhe lejet u ndryshua në janar duke ulur pengesat administrative dhe rregullatore për bizneset. Nevojiten përpjekje të tjera për formalizimin e Vlerësimit e Impaktit Rregullator. Në prill, u krijua Këshilli i Investimeve, me pjesëmarrjen e gjashtë anëtarëve nga institucione shtetërore dhe gjashtë përfaqësues të biznesit, për përmirësimin e klimës së biznesit dhe lehtësimin e dialogut midis qeverisë, biznesit dhe donatorëve. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi u miratua në 2014. Ligji për investimet strategjike dhe ndryshimet në ligjin për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike u miratuan nga Kuvendi në maj me qëllim përmirësimin e klimës së investimeve.

Për sa i përket **instrumenteve të ndërmarrjeve dhe të politikave industriale**, Shqipëria ratifikoi në qershor një marrëveshje për të marrë pjesë në programin e konkurrencës COSME të BE-së. Shqipëria vazhdoi të mbështesë financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) me një kredi prej 15 milion Euro të lidhur me qeverinë italiane, Projektit të Zhvillimit dhe Inovacionit të ndërmarrjeve për Ballkanin Perëndimor dhe Fondit Evropian për Evropën Juglindore. Megjithatë, aksesin për kredi i NVM dhe mungesa e një stafi të kualifikuar mbeten shqetësimet e biznesit. Qeveria prezantoi një paketë ligjore për mbështetjen e industrisë së përpunimit, duke reduktuar formalitetet administrative.

Për sa i përket **politikave sektoriale**, në qershor u miratua një ligj i ri për turizmin, për promovimin dhe për të tërhequr investime strategjike kombëtare dhe të huaja në turizëm, në përputhje me Ligjin për Investimet Strategjike të miratuar në maj. Bizneset e turizmit hasin vështirësi lidhur me informalitetin, nevojën për përmirësime infrastrukturore (duke përfshirë menaxhimin e mbetjeve dhe aksesin për energji) dhe çështjet e pronave. Ndryshimet në ligjin për sektorin minerar u miratuan në tetor 2014, për të përmirësuar legjislacionin për aprovimin e operacioneve minerare.

Përfundim

Shqipëria është e përgatitur mjaftueshëm në fushën e ndërmarrjeve dhe politikave industriale. Janë bërë përpjekje në këtë fushë, veçanërisht në përafrimin me Aktin Evropian për Biznesin e Vogël. Për vitin e ardhshëm, vendi duhet të forcojë kapacitetet e Agjencisë Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, duke përfshirë kapacitetet për shërbimet për investitorët shqiptarë dhe të huaj. Duhet të përmirësohen më tej politikatat e konsultimit.

4.21. Kapitulli 21: Rrjetet trans-evropiane

Për sa i përket **rrjeteve të transportit**, Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë në Observatorin e Transportit në Evropën Juglindore (SEETO). Shqipëria luajti një rol aktiv në procesin 6 të Ballkanit Perëndimor dhe mbështeti shtrirjen në Ballkanin Perëndimor të Rrjetit Trans Evropian të Transportit (TEN-T) dhe korridoreve për përmirësimin e lidhjeve në Ballkanin Perëndimor dhe në BE.

Përmirësimet në rrjetin rrugor kanë vazhduar. Ndërtimi i by-passit të Fierit dhe Rrogozhinës po ecin. Në korridorin Veri - jug, segmenti Damës - Tepelenë, unaza e Shkodrës dhe zgjatja e rrugës Durrës - Rrogozhinë kanë përfunduar. Përsa i përket korridorit VIII, ndërtimi i rrugës Tiranë - Elbasan është pezulluar.

Një program 5-vjeçar për **mirëmbajtjen e rrugës** filloi, me fokus mirëmbajtjen dhe sigurinë e rrjetit kryesor rrugor. Rrjeti hekurudhor nuk ka pasur progres dhe seksioni nga Librazhdi në Pogradec mbeti jo funksional për shkak të mungesës së mirëmbajtjes. Përsa i përket infrastrukturës portuale, thellimi i punës për të përmirësuar aksesin në portin e Shëngjinit ka përfunduar; porti tani është funksional dhe kapacitetet e tij janë rritur.

Për sa i përket **rrjeteve energjetike**, Shqipëria ka bërë progres për përgatitjet e projektit të Gazsjellësit Trans-Atlantik. Progres është bërë në lidhjen rajonale të energjisë. Ka filluar ndërtimi i linjës së

interkonjeksionit 400 kV midis Shqipërisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

Përfundim

Janë bërë përparime në fushën e rrjeteve trans-evropiane, ku vazhdon zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe ndërlidhja e rrjeteve energjetike. Zhvillimi i infrastrukturës së transportit dhe rrjeteve energjetike duhet të jetë në përputhje me prioritetet e investimit në infrastrukturë për rrjetin bazë, sipas axhendës rajonale të lidhjes. Duhet të bëhen më tepër përpjekje për mirëmbajtjen e infrastrukturës së transportit dhe shpronësimin e tokave.

4.22. Kapitulli 22 : Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore

Për sa i përket **kuadrit legjislativ**, duhen ndërmarrë hapa të mëtjshëm për të siguruar programimin sektorial shumëvjeçar, në përputhje me qasjen e sektorit të ri sipas kuadrit IPA për 2014-2010, fleksibilitetin e buxhetit afat-mesëm dhe kapacitetet bashkë-financuese për projektet e BE-së në nivel kombëtar dhe vendor.

Për sa i përket **kornizës institucionale**, strukturat kombëtare kompetente po zbatojnë projektet sipas Programit IPA 2013, duke ndjekur delegimin e kompetencave të menaxhimit nga Komisioni Evropian sipas komponentit I të IPA 2007-2013. Përgatitjet për menaxhimin e fondeve të IPA në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural duhet të përmirësohen në funksion të fillimit të menaxhimit të fondeve në 2016. (*Shih gjithashtu Kapitulli 11 - Bujqësia*).

Për sa i përket **kapaciteteve administrative**, veprime të mëtjshme duhet të ndërmerren për të siguruar personel të mjaftueshëm në të gjitha strukturat e IPA-s në funksion të ngarkesës së punës që rrjedh nga përgjegjësitë indirekte të menaxhimit.

Në lidhje me **programimin**, duhet të forcohet koordinimi i Ministrisë së Financave me ministrinë e linjës për të qenë në gjendje të hartojnë dhe zbatojnë politika sektoriale realiste, në përputhje me planin e buxhetit afat-mesëm. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për periudhën 2015-2020 ende nuk është miratuar. Nuk është paraqitur ndonjë projekt i maturuar i investimeve për zhvillimin rajonal. Si rezultat i reformës territoriale administrative, qeveritë vendore duhet të forcojnë ndjeshëm kapacitetet e tyre për të gjeneruar projekte të maturuara, që të përfitohet nga mbështetja kombëtare dhe e IPA-s.

Për sa i përket **monitorimit dhe vlerësimit**, struktura ekzistuese e grupeve sektoriale të punës është riorganizuar me qëllim për të monitoruar zhvillimet e politikave dhe për të ofruar këshilla strategjike. Katër grupe të integruar politikash menaxhimi (menaxhimi i ujërave, reforma e administratës publike; konkurrenca dhe inovacioni; dhe aftësitë e punësimit dhe politika sociale) u krijuan për të mbështetur Komitetin e Planifikimit Strategjik dhe Komisionet e tjera ndër-ministrorë të nivelit të lartë, me detyrë vendosjen e politikave kyçe.

Në fushën e **menaxhimit financiar, kontrollit dhe auditit**, duhet të forcohen kapacitetet administrative të Njesisë Financiare dhe Kontraktore në Ministrinë e Financave, si dhe autoriteti i auditit kërkon shtim të burimeve njerëzore me ekspertizë të lartë në audit.

Përfundim

Janë bërë disa përparime në fushën e politikës rajonale, sidomos në fillimin e projekteve për menaxhimin indirekt të programit kombëtar IPA 2013. Gjithsesi, ky sistem menaxhimi duhet të forcohet më tej për të minimizuar rrezikun e vonesave dhe vonesat e fondeve. Duhet të përmirësohen kapacitetet programuese për përgatitjen e politikave sektoriale dhe projekteve të maturuara për gazsjellësin në nivel kombëtar dhe vendor.

4.23. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Funksionimi i sistemit gjyqësor

Dokumentet strategjike

Në nëntor 2014, u krijua Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi, i përbërë nga anëtarë të mazhorancës dhe opozitës. Komisioni u asistua nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, të cilët përfunduan analizën e sistemit të drejtësisë në qershor dhe hartuan strategjinë për reformën në drejtësi, shoqëruar me Planin e Veprimit.

Organet drejtuese

Dy anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), përfshirë edhe Zëvendës kryetarin, u shkarkuan nga Kuvendi, në 2014, ndjekur nga miratimi i ndryshimeve të kundërshtuara për ligjin e KLD-së dhe një procesi parlamentar debatues. Apelimi kundër shkarkimeve u refuzua nga Gjykata Administrative dhe Zëvendëskryetari i ri i KLD-së nuk është emëruar ende. Arsyetimi i vendimeve të KLD-së nuk publikohet dhe ekziston ende qëllimi për përmirësimin e transparencës së procesit vendim-marrës të Këshillit. Buxheti i KLD-së është rritur me 5.85% krahasuar me vitin e kaluar. Rregullorja për funksionimin e Këshillit të Prokurorëve u ndryshua në nëntor, duke përfshirë kritere të detajuara për vlerësimin e prokurorëve për qëllime promovimi. Në shkurt, u miratua manuali me qëllim zhvillimin e konkurseve për prokurorët.

Pavarësia dhe paanshmëria

Funksionimi i sistemit gjyqësor vazhdon të jetë i ndikuar nga një nivel i lartë politizimi dhe bashkëpunim i dobët ndër-institucional. Pavarësia dhe paanshmëria e Gjykatës së Lartë ende nuk është e garantuar plotësisht. Që nga Shtatori 2014, Kuvendi ka hedhur poshtë të shtatë kandidaturat e Presidentit për anëtarë të Gjykatës së Lartë dhe këto vende vakante ende nuk janë plotësuar. Janë ende në diskutim aktet ligjore kyçe për reformimin e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë si dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Gjyqtarët ende nuk kanë kushtet e përshtatshme të punës dhe sigurisë. Mbrojtja e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndaj kërcënimeve dhe presioneve mbetet joadekuate. Seancat dëgjimore vazhdojnë të mbahen në disa në raste në zyrat e gjyqtarëve, gjë që çon në ushtrimin e ndikimit të paligjshëm dhe praktikave korruptive.

Llogaridhënia

Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë për inspektimet vazhdoi të zbatohet normalisht. Të dy institucionet zhvilluan inspektime respektivisht në zyrat e prokurorëve dhe gjykata. Kërkesat për nisjen e procedimeve disiplinore ndaj tetë gjyqtarëve kanë rezultuar në një shkarkim dhe dhënie vërejtje për tre gjyqtarë. Çështjet ndaj katër gjyqtarëve të tjerë u pushuan. Sistemi disiplinor për gjyqtarët duhet të përmirësohet ndjeshëm, përfshi përmes një sistemi inspektimi më transparent dhe eficient. Gjithashtu, duhet të rishikohet roli i Ministrit të Drejtësisë në këtë proces si edhe të krijohet një historik solid sanksionesh.

Me propozim të Këshillit të Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme ka dhënë masa ndaj tre prokurorëve, një vërejtje, një vërejtje dhe një propozim për shkarkim.

KLD lançoi një website i cili mundëson plotësimin dhe monitorimin e ankesave ndaj gjyqtarëve. Kjo u shoqërua me një fushatë për rritjen e ndërgjegjësimit mbi ankesat disiplinore ndaj gjyqtarëve.

Procedurat për emërimin dhe shkarkimin e personelit kyç në Prokurorin e Përgjithshme duhet të jenë transparente dhe të paanshme, dhe roli i Këshillit të Prokurorëve duhet të forcohet. Mungesa e llogaridhënies së Prokurorisë së Përgjithshme mbetet shqetësuese, si dhe mundësia e ndikimit politik në

procesin e emërimit të Prokurorit të Përgjithshëm.

Deklaratat e pasurive të gjyqtarëve u kontrolluan në 2014 dhe ato të prokurorëve janë planifikuar për t'u kontrolluar në 2015. Nga tetori 2014, KLD pezulloi dy gjyqtarë për mospërbushje të kërkesave të deklarimit të pasurive. Korrupsioni në sistemin gjyqësor vazhdon të mbetet një problem shqetësues. Përpjekje substanciale nevojiten për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies dhe për të zbatuar rekomandimet e raundit të katërt të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) mbi raportin vlerësues për parandalimin e korrupsionit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Profesionalizmi dhe kompetenca

Kriteret për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve kanë nevojë të përmirësohen. Procesi i vlerësimit të performancës së gjyqtarëve për vitet 2007-2009 ende nuk ka përfunduar; kjo ka penguar KLD në emërimin e Kryetarëve të Gjykatave në përputhje të plotë me dispozitat përkatëse ligjore. Rregullorja e re e KLD për vlerësimin e Inspektorëve të KLD-së filloi të zbatohet në qershor. Vlerësimi për performancën e prokurorëve dhe policëve gjyqësorë është bërë për vitin 2013.

Procedurat për emërimin e gjyqtarëve administrative ka nevojë të rishikohet nisur nga pjesëmarrja e ulët deri më sot në provimin e pranimit. Shtatë vende vakante në gjykatat administrative ende nuk janë plotësuar. Këshilltarët ligjorë janë emëruar në të gjitha gjykatat administrative. Emërimet e gjyqtarëve të cilët sapo janë diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës ende nuk ka përfunduar.

Cilësia e drejtësisë

Planifikimi i buxhetit ka nevojë të përmirësohet dhe burimet e përshtatshme buxhetore për sistemin e drejtësisë të sigurohen. Përveç disa përpjekjeve, trajnimi i stafit administrativ gjyqësor mbetet i pamjaftueshëm. Shkolla e Magjistraturës ende varet nga ndihma të huaja. Njëmbëdhjetë përqind e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të Apelit janë duke u trajnuar mbi legjislacionin evropian.

Sistemi i regjistrimit audio u shtri më tej dhe filloi të zbatohet në shumicën e gjykatave administrative. Sistemi i unifikuar i menaxhimit të çështjeve përdoret pothuajse nga të gjithat gjykatat, përfshirë seksionin e dhomës civile të Gjykatës së rrethit Tiranë. Megjithatë, sistemi është pak i përdorur, jo tërësisht funksional, dhe në disa gjykata ende nuk është instaluar. Sistemi duhet të përmirësohet për plotësimin e nevojave të gjykatave dhe për të siguruar të dhënat statistikore të kërkuara nga Ministria e Drejtësisë.

Alokimet buxhetore në gjykata për çështjet e Teknologjisë së Informacionit janë ende të pamjaftueshme. Sistemi i menaxhimit të çështjeve për Prokurorinë duhet të bëhet tërësisht funksional.

Akresi online i jurisprudencës nuk është i garantuar plotësisht dhe nuk ka një bazë të dhënash të aksesueshme. Vendimet e gjykatave nuk publikohen sistematikisht; kur publikohen, jo gjithmonë përmbajnë arsyetimin dhe jo gjithmonë afatet respektohen. Nevojiten përpjekje për të përmirësuar aftësitë hartuese të gjyqtarëve. Publikimi i vendimeve gjyqësore në mënyrë anonime nuk është ende i mundur.

Që nga tetori, 70 persona janë pajisur me licencë si ndërmjetës dhe janë 367 ndërmjetës të licensuar në krahasim me 285 në 2014. Në praktikë, vetëm 61 ndërmjetës janë funksionale dhe numri i shërbimit të ndërmjetësimit ende mbetet shumë modest.

Që në qershor 2014, funksionimi i sistemit të përbarimit privat është përmirësuar nga ndryshimet në kuadrin rregullator që përcaktojnë heqjen e tarifave lidhur me pagesat për përfundimin me sukses të procesit të përbarimit. Sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve përbarimore private dhe publike 'ALBIS' nuk është përdorur më për shkak të buxhetit të mirëmbajtjes, megjithatë përbaruesit privatë

kanë zhvilluar sistemin e tyre elektronik.

Për sa i përket aksesit në drejtësi, duhet të përmirësohet funksionimi i Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike për të përballuar nevojat e një numri të konsiderueshëm personash vulnerabël. Gjashtë zyra vendore për ndihmën juridike ende nuk janë ngritur.

Eficienta

Burimet e pamjaftueshme financiare dhe njerëzore dhe mungesa e organizimit racional të stafit administrativ minon eficientën e sistemit të gjykatave. Kohëzgjatja e procedimeve mbetet shqetësuese. Procesi i sistemit të numrit të gjyqtarëve në secilën gjykatë mbetet për t'u përfunduar. Lajmërimi i palëve për procedimet gjyqësore është i mangët dhe ende nuk ka një regjistër adresash të saktë. Bllokimi mbetet i lartë, veçanërisht në gjykatat administrative, gjykatat e apelit dhe Gjykatën e Lartë.

Ministria e Drejtësisë ka ngritur një grup punë për të trajtuar mangësitë serioze të identifikuara në procesin e nxjerrjes dhe mbledhjes së të dhënave statistikore të gjykatave.

Lufta kundër korrupsionit

Historiku i rezultateve

Rezultatet bindëse në **hetime, ndjekje penale dhe dënime** në çështje korruptive mbetet i limituar në Shqipëri. Numri i hetimeve të çështjeve të lidhura me korrupsionin, të dorëzuara në Prokurori është rritur. Megjithatë, numri i çështjeve të nxjerra para gjykatave mbetet i ulët, megjithëse është rritur me 82% në 2014 krahasuar me vitin 2013. Numri i dënimeve përfundimtare, duke përfshirë zyrtarët e nivelit të ulët apo të mesëm gati është dyfishuar në gjysmën e parë të 2015, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në 2015, ka pasur një dënim të shkallës së parë për një çështje korrupsioni të një kryebashkiaku dhe një dënim nga gjykata e apelit për një gjyqtar të korruptuar. Prokuroria e Përgjithshme ka shkarkuar një prokuror në lidhje me një vepër penale lidhur me korrupsionin.

Performanca e Inspektoriatit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë dhe kundër Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) është përmirësuar ndjeshëm. Në 2014 inspektoriatit dërgoi 74 raste në prokurori, nga të cilat 25 u dërguan në gjykatë. Në 2015, ILDKPI dërgoi 82 referime për Prokurorinë, 5 nga të cilat u dërguan në gjykatë. Këto referime rezultuan në tre dënime me burgim dhe 17 dënime me gjobë. Ndër referimet e ILDKPI janë 12 gjyqtarë, dy prokurorë dhe gjashtë anëtarë të kuvendit. Ndjekja e rregullt e referimeve nga inspektoriatit, duke përfshirë rezultate bindëse të ndjekjes penale të suksesshme dhe dënime përfundimtare, mbeten ende për t'u demonstruar. Në 2014, inspektoriatit vendosi 400 sanksione administrative, dhe 420 në 2015. Nuk ka një sistem elektronik për dorëzimin, kontrollin dhe publikimin e deklaratave të pasurive. Procesi i përzgjedhjes së deklaratave të pasurive të zyrtarëve publikë për t'u kontrolluar duhet ende të sigurojë një model të mjaftueshëm të zyrtarëve të lartë shtetërorë, përfshirë anëtarë të Kuvendit, ministrat dhe gjyqtarë. Parandalimi i konfliktit të interesit kërkon rritje ndërgjegjësimi, veçanërisht në fushat me rrezik të lartë korrupsioni.

Është bërë progres me ngritjen e sistemit të unifikuar elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS dhe prezantimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në disa prokurori. Megjithatë, mbledhja e statistikave të integruara dhe ndër-institucionale dhe rezultatet bindëse mbeten një sfidë. Nevojiten më shumë përpjekje për të krijuar një sistem të menaxhimit të çështjeve, në të cilin të gjithë organet ligjzbatuese, në kuadër të luftës kundër korrupsionit të japin informacion, në mënyrë që çështjet e korrupsionit të mund të ndiqen nga fillimi në fund. Buxheti për mirëmbajtjen dhe zbatimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykata dhe prokurori duhet të jetë i sigurt.

Kryerja e hetimeve aktive dhe vlerësimet e rreziqeve në shërbimet e taksave dhe doganave është rritur. Korrupsioni në administratën tatimore dhe doganore mbetet një çështje shqetësuese.

Në lidhje me **mekanizmat e kontrollit të brendshëm**, inspektimet e Njësisë së Kontrollit të Brendshëm dhe Anti-Korrupsionit të Ministrisë së Brendshme duhet të rriten ndjeshëm. Këshilli i Ministrave, Njësia e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Anti-korrupsionit (UIACA) zhvilloi 20 kontrolle administrative në 2014, të cilat rezultuan në 39 masa disiplinore dhe 3 referime penale. Në 2015, UIACA zhvilloi 17 kontrolle administrative, të cilat rezultuan në 46 rekomandime për masa disiplinore dhe administrative dhe katër referime penale. Rekomandimet e UIACA-s përgjithësisht janë zbatuar.

Lidhur me **aksesin për informacion**, 214 ankesa u regjistruan në Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave. Në këtë periudhë, u kryen 73 inspektime, u morën 45 vendime dhe 21 ankesa janë akoma duke u shqyrtuar. Një sistem që të përfshijë numrin e përgjithshëm të kërkesave bërë institucioneve shtetërore mbetet akoma për t'u krijuar.

Ligji për mbrojtjen e **bilbilfryrësve** ende nuk është miratuar.

Korniza institucionale

Masat parandaluese

Kapacitetet e rrjetit **anti-korrupsion** në ministritë e linjës dhe në nivel vendor kanë nevojë të forcohen. Nevojiten burime të mjaftueshme njerëzore për portalin anti-korrupsion dhe qëllimin e tij. Mekanizmat e bashkëpunimit me organet vendimmarrëse duhet të përcaktohen në mënyrë që ankesat të trajtohen në mënyrën e duhur. Mekanizmi i raportimit ende nuk ka demonstruar efektivitet dhe paanshmëri.

Buxheti i ILDKPI për 2015 ishte rreth 30% më i lartë se në 2014. Megjithatë, kapacitetet e saj administrative, teknike dhe financiare kane nevojë të forcohen, veçanërisht në numrin më të madh dhe shpeshtësinë e kontrolleve të ILDKPI. Ndryshimet në ligjin e ILDKPI të cilat zgjeruan qëllimin e deklarimit të pasurive.

Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të forcuar rolin e Këshillit të Lartë të Shtetit (KLSH) në kuadër të anti-korrupsionit, duke ngritur një mekanizëm eficient për Kuvendin dhe qeverinë për të ndjekur gjetjet e tij. Çështjet e abuzimit me detyrën apo me tender publikë të referuara nga KLSH-ja në prokurori kanë rezultuar në shumë pak hetime dhe asnjë dënim.

Në lidhje me **financimin e partive politike**, vendet vakante në Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ) janë plotësuar. KQZ duhet të përcaktojë përgjegjësi të qarta brenda vetes për mbikëqyrjen e financimit të partive dhe duhet të kryejë inspektime thelbësore që shkojnë përtej qasjes veçse formale të kontrollimit të deklarimeve të partive politike. Hapësirat në kuadrin ligjor dhe institucional duhet të adresohen urgjentisht, duke përfshirë mundësinë për të ushtruar normalisht funksionet e mbikëqyrjes dhe monitorimit të shpenzimeve gjatë fushatave elektorale dhe zbulimin e financave të fushatës parazgjedhore, para ditës së zgjedhjeve.

Rekomandimet e bëra në raundit e katër nga Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) në raportin për parandalimin e korrupsionit të deputetëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve mbetet akoma për t'u zbatuar.

Zbatimi i ligjit

Hetimet aktive, bazuar në analizat e rrezikut duhet të rriten ndjeshëm për të zhvilluar rezultate bindëse me hetime, ndjekje penale dhe dënime në çështjet e korrupsionit. Hapat e mëtejshëm

duhet të përfshijnë forcimin e kapaciteteve hetimore të agjencive ligjzbatuese dhe kryerjen e hetimeve proaktive dhe efektive duke ndryshuar Kodin e Procedurës Penale në lidhje me përgjimin dheurvejimin, limitet kohore për hetime dhe pranimin e provës para gjykatës. Hetimi, ndjekja penale dhe gjykimi i veprave të korrupsionit duhet të përmirësohet duke siguruar një autonomi dhe stabilitet të policisë dhe stafit të prokurorisë, dhe juridiksion të qartë për krimet e korrupsionit, veçanërisht për zyrtarët shtetërorë të lartë. Njësitë e Përbashkëta të Hetimit, **Gjykata e Krimeve të Rënda dhe Prokuroria e Përgjithshme**, dhe ILDKPI duhet të garantohen me burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare dhe trajnime.

Bashkëpunimi ndër-agjenci ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm. Bashkëpunimi ndërmjet prokurorisë dhe policisë ka nevojë të përmirësohet me qëllim që hetimet para-seancës gjyqësore të sillen si rezultat i inteligjencës proaktive për të marrë dhe aksesuar informacion nga bazat e të dhënave publike dhe private. Ekuilibri ndërmjet udhëzimeve efektive të prokurorisë dhe nivelit të mjaftueshëm të autonomisë dhe iniciativës së policisë duhet ende të vendoset. Shqetësimet mbeten në lidhje me bashkëpunimin e dobët ndërmjet institucioneve anti-korrupsion dhe pamjaftueshmërisë së shkëmbimit të informacionit, që pengojnë zhvillimin efektiv të hetimeve dhe ndjekjeve penale, veçanërisht për funksionarët shtetërorë të lartë. Organet e përfshira në luftën korrupsionit vazhdojnë të vuajnë alokimet e pamjaftueshme nga buxheti i shtetit.

Kuadri legjislativ

Zbatimi i legjislacionit për ligjin për të drejtën e informimit u miratua në janar. Ligji i ri për Policinë e Shtetit për të sanksionuar ngritjen e një Byroje Kombëtare të Hetimit, e ngarkuar me hetimin e çështjeve të korrupsionit, u shfuqizua me vendim të Gjykatës Kushtetuese në prill.

Kuadri strategjik

Në mars u miratuan Strategjia ndër sektoriale anti-korrupsion (2015-20) dhe plani i veprimit (2015-17). Të dy dokumentet u konsultuan gjerësisht, përfshirë akordimin e një buxheti për masat e planit të veprimit. Buxheti për planin e veprimit është 12 milion Euro. Përmban indikatorët specifikë dhe buxhetet për shumicën e aktivitetet. Një mekanizëm për zbatimin e planit të veprimit është vendosur, por kuadri për monitorimin dhe organi përgjegjës ende nuk është krijuar. Është planifikuar përfaqësimi i organizatave të shoqërisë civile në mekanizmin e monitorimit.

Të drejtat themelore

Lidhur me **instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut**, Shqipëria miratoi në maj Protokollin e 16-të të Konventës së Këshillit të Evropës duke bërë të mundur që Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut të japi opinione këshillimore. Edhe pse Shqipëria ka ratifikuar shumicën e konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përpjekje të mëtejshme nevojiten për të garantuar zbatimin e plotë të tyre.

Nga shtatori 2014, **Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ)** ka konstatuar se vendi ka shkelur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) në tre raste lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë, mbrojtjen e pronës, të drejtën e lirisë dhe sigurisë dhe të drejtën për kompensim. 130 aplikime të reja i janë alokuar një organi vendimmarrës, duke çuar numrin e aplikimeve në 402. Vazhdon të ketë vonesa në ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sidomos në lidhje me të drejtat e pronësisë, procedimet gjyqësore, të drejtën për gjykim të drejtë dhe kujdesin shëndetësor joadekuat gjatë burgosjes.

Për sa i përket **promovimit dhe zbatimit të të drejtave të njeriut**, Avokati i Popullit ka vazhduar të promovojë të drejtat e njeriut dhe të drejtat e grupeve vulnerabël, dukë përfshirë paraqitjen e raporteve dhe rekomandimeve. Janë zhvilluar trajnime dhe fushata sensibilizuese; megjithatë, të drejtat e njeriut

nuk janë zbatuar mjaftueshmërisht. Ndryshimet në ligjin për Avokatin e Popullit i japin atij të drejtën për të publikuar raportet e tij nëse Kuvendi nuk i diskuton ato. Ato sigurojnë një përzgjedhje më transparente dhe përfshirëse të kandidatëve për komisionerë, por nuk parashikojnë rritjen e buxhetit të Avokatit të Popullit dhe as autonominë organizative. Ndryshimet krijojnë Komisionerin për Fëmijët dhe Komisionerin për mekanizmin kombëtar për parandalimin e torturës. Kapacitetet e institucioneve me përgjegjësi mbrojtje dhe garantimin e të drejtave të njeriut mbeten të ulëta, dhe ka një nevojë të veçantë për staf të specializuar dhe të trajnuar mirë në gjyqësor dhe polici.

Për sa i përket **të drejtës për të jetuar**, fenomeni i gjakmarrjes vazhdon të mbetet problem, megjithëse në shkallë të limituar. Në mars, kuvendi miratoi një rezolutë dhe rekomandime mbi gjakmarrjen, bazuar në gjetjet e raportit të Avokatit të popullit. Rezoluta parashikon rivendosjen e Këshillit të koordinimit për gjakmarrjen të krijuar në 2005, programe edukative dhe sociale në zonat rurale dhe zhvillimin e mëtejshëm të hetimeve nga prokuroria dhe policia dhe investim për parandalimin e konflikteve.

Në fushën e **parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit**, mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës ka kryer 115 inspektive, kontrole dhe vizita monitorimi. 81 nga rekomandimet janë marrë parasysh, por shumica nuk janë adresuar. Në 2014, mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës dhe Avokati i Popullit kanë dorëzuar 35 ankesa për përdorimin e tepruar të forcës dhe dhunës nga oficerët e policisë dhe garda e burgut, nga të cilat 8 u vlerësuan të bazuara. Shumë pak hetime kanë filluar ndaj oficerëve policorë. Në disa burgje janë ngritur njësi të kujdesjes speciale të cilat ofrojnë mbështetje psikologjike. Nuk është bërë progres në lidhje me krijimin e një instituti mjekësor për trajtimin e të burgosurve me sëmundje mendore, të cilët vazhdojnë të mbahen në kushte të papërshtatshme në spitalin e burgut të Krujës. Nevojiten përpjekje të tjera për të siguruar trajtim të specializuar për këtë kategori vulnerabel të të burgosurve në të gjitha mjediset.

Për sa i përket **sistemit të burgjeve**, mbipopullimi mbetet një shqetësim. Numri total i shkelësve në shërbimin e provës u rrit nga 700 në vitin 2009 kur u ngrit shërbimi, në 13 359 në dhjetor 2014. Janë ngritur zyra vendore të shërbimit të provës në 22 rrethe gjyqësore. Megjithatë, numri i stafit nuk është rritur, gjë që pengon funksionimin efektiv të shërbimit të provës dhe dhënien e dënimeve alternative. Sistemi elektronik i monitorimit është i përhapur në të gjitha rrethet gjyqësore që nga shkurti, por ende nuk është bërë funksional. Nevojiten më shumë përpjekje për të përmirësuar kushtet e burgjeve dhe për të adresuar mbipopullimin në burgje dhe qendrat e paraburgimit, i cili u rrit me 26% mbi kapacitetet në 2014. Vazhdon të ekzistojë infrastruktura e dobët dhe problemet me mirëmbajtjen e dobët të mjediseve të ndërtruara rishtas.

Çështja e privatësisë dhe mungesa e konfidencialitetit të bisedave të të burgosurve duhet të adresohet, dhe aksesit për shërbimet shëndetësore duhet të sigurohet si dhe standardet e higjienës dhe shëndetit. Të burgosurit vazhdojnë të varen nga familjet e tyre për ushqim, pajisje dhe ilaçe. Rrjetet e mbështetjes, para dhe pas lirit të të burgosurve janë të nevojshme për të bërë të mundur integrimin në shoqëri. Kurset e trajnimit në burgje si pjesë e programeve të para lirit, të parashikuara nga nëntori mbeten akoma për t'u vënë në praktikë. Ato pak të burgosur që punojnë marrin ulje të dënimit dhe jo kompensim; kuadri ligjor për pagesat e punës duhet të përmirësohet. Legjislacioni ekzistues penitenciar ka nevojë të zbatohet efektivisht dhe të jetë në përputhje me standardet e BE.

Në fushën e **mbrojtjes së të dhënave personale**, numri i ankesave të dorëzuara pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka pësuar rritje. Numri i telefonit falas për ankesat e qytetarëve është funksional dhe formulari i ankesës gjendet në faqen e internetit të Komisionerit. Trajnimet dhe aktivitetet sensibilizuese janë rritur. Komisioneri është konsultuar për nisma legjislative të propozuara. Kapacitetet e Komisionerit duhet të forcohen siç duhet, për të siguruar zbatimin efektiv të ligjit për të drejtën e informimit. Publikimi i vendimeve të gjykatave jo gjithmonë është në përputhje me dispozitat e mbrojtjes së të dhënave. Media e shkel shpesh të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Pavarësia e Komisionerit duhet të forcohet, veçanërisht për sa i përket procedurave të emërimit dhe shkarkimit të parashikuara në statut.

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit është respektuar në përgjithësi dhe toleranca fetare ka

mbizotëruar. Në gusht, një Kishë Ortodokse në Dhërmi u prish nga autoritetet shqiptare me arsyetimin se ishte ndërtuar pa leje, duke nxitur protesta nga Komuniteti i Kishës.

Për sa i përket **lirisë së shprehjes**, është raportuar një tentativë për vrasjen e një gazetari në dhjetor 2014. Një tjetër gazetar mori kërcënime për vdekje pasi raportoi një operacion policor droge. Ndjekja penale dhe gjyqësore e rregullt ka nevojë të garantohet. Megjithëse të rralla, këto raste mbeten shkak për shqetësim.

Ligji për Median Audiovizive po zbatohet ngadalë, kryesisht për shkak se mandati i Kryetarit të Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA) u pezullua dhe ka pasur vonesa për plotësimin e vendeve vakante të AMA-s. Autoriteti harroi një plan veprimi për procesin e dixhitalizimit dhe miratoi një rregullore e cilat lejon lançimin e një procesi për licensimin e rrjeteve dixhitale.

AMA nuk ka qenë në gjendje të japë vendime në fushëveprimin e saj në 2014, pasi Kryetari u pezullua ndërkohë që prokurorët zhvilluan një hetim. Klima konfrontuese në Parlament gjithashtu ka ndikuar në punën e rregullatorit. Emërimi i dy anëtarëve të rinj të Bordit të AMA-s dhe kryetarit, bazuar vetëm në votat e mazhorancës u kundërshtua nga opozita në gjykatë. Anëtarët e nominuar nga opozita nuk morën pjesë në mbledhjet e AMA-s, duke kundërshtuar legjitimitetin e Bordit, dhe kjo e ka bërë të vështirë arritjen e një kuorumi të nevojshëm për vendime të rëndësishme.

Janë raportuar disa raste padish për shpifje nga drejtues të administratës publike ndaj gazetarëve, por nuk ka pasur asnjë rast padish për shpifje ndaj gazetarëve nga politikanët. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të garantuar zbatimin e duhur të ndryshimeve për shpifjen si edhe udhëzime për dëmshpërblime në nivel të arsyeshëm, sidomos përmes trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ndryshimi i ri në Kodin Civil u propozua për përgjegjësinë e administratorëve të portaleve të lajmeve për të filtruar komentet të cilat ofendojnë dinjitetin njerëzor. Kjo mund të imponojë kufizime të panevojshme për të drejtën e shprehjes.

Pronësia e mediave është bërë më transparente, por vazhdojnë të mbeten shqetësime për pronësinë e fshehur. Mungesa e transparencës në financimin e medias mbetet problematike. Mbetet shqetësim shpërndarja e reklamave shtetërore dhe fondeve publike për pronarë të mediave dhe bizneseve afër qeverisë, pasi kjo ndikon në konkurrencën e ndershme ndërmjet bizneseve të medias. Ndryshimi i propozuar për të hequr limitet e pronësisë për median audiovizive ka shkaktuar shqetësime se do të lehtësojë krijimin e monopolit në sektorin e medias audiovizive.

Shumë gazetarë nuk janë të organizuar apo përfaqësuar në ndonjë formë. Zbatimi i dobët i Kodit të Punës për gazetarët me kohë të plotë dhe ata të pavarur është një problem shqetësues. Shumica e gazetarëve punojnë pa kontrata pune ose kanë kontrata të cilat mund të përfundojnë arbitrarisht. Shumë gazetarë përballen me vonesa në pagesat e rrogave të tyre dhe/ose humbasin vite për sigurimet shoqërore.

Liria e tubimit dhe e organizimit është respektuar në përgjithësi. Një numër protestash paqësore dhe demonstrime politike u zhvilluan pa shkaktuar incidente të mëdha.

Nevojiten më shumë përpjekje për të përditësuar dhe zbatuar strategjinë 2012 - 2020 për të **drejtat e pronësisë** dhe për të përfunduar procesin e regjistrimit të pronave, për të siguruar zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe vazhduar procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave.

Në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mbi të drejtat e pronësisë, kompensimet financiare vendosur nga gjykatat i janë dhënë aplikuesve individualë përkatës. Për të zbatuar planin e veprimit 2014 të rënë dakord me Komitetin e Ministrave të Këshillit Evropian, qeveria po finalizon ligjin e ri për ngritjen e një mekanizmi për ekzekutimin e vendimeve për kthimin apo kompensimin e pronave, të shtetëzuara gjatë regjimit komunist.

Në fushën e **politikave anti-diskriminim**, numri i çështjeve të trajtuara nga Komisioneri për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit (KMD) është rritur dhe kompetencat e tij ex-officio u përdorën në 18 raste në 2014. KMD ka rritur pjesëmarrjen në proceset gjyqësore. Trajnimet dhe fushatat sensibilizuese të Komisionerit rezultuan në rritje të numrit të ankesave. Megjithatë, kërkohet një qasje më aktive dhe gjithëpërfshirëse. Zbatimi i ligjit për mbrojtjen ndaj diskriminimit duhet të përmirësohet. Të dhënat mbi krimin e urrejtjes nuk mblidhen.

Barazia **gjinore**, është minuar nga funksionimi i dobët i mekanizmave për të adresuar barazinë gjinore dhe dhunën gjinore. Sistemi online për raportimin dhe monitorimin e rasteve të dhunës gjinore vazhdon të jetë funksional në 29 nga 61 bashki. Numri i raportimeve të shkeljeve të rënda dhe rastet e dhunës në familje ndaj grave janë shtuar, duke treguar rritje të besimit në sistem, por pjesa më e madhe e çështjeve vazhdon të mbetet e paraportuar. Numri i procedimeve penale për dhunën në familje është rritur. Gjykatat kanë filluar të ndjekin penalisht raste të dhunës në familje më efektivisht - veçanërisht në Tiranë. Numri i strehave kombëtare dhe shërbimet e ri-integrimit kanë nevojë të rriten, dhe strehat ekzistuese vullnetare mbeten për t'u mbështetur nga autoritetet. Për shkak të burimeve të pakta financiare dhe njerëzore, mekanizmi kombëtar i referimit për dhunën në familje është funksional në shumë pak bashki, dhe aplikon kritere pranimit që s'ka pse të jenë aq të shtrenguara. Shërbimet për viktimat e dhunës në familje duhet të përmirësohen në cilësi, sasi, aksesueshmëri dhe shpërndarje gjeografike dhe duhet të bëhet më shumë punë për ri-integrimin dhe fuqizimin ekonomik.

Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të shfuqizuar dispozitat diskriminuese me bazë gjinore në disa sektorë si edhe për të adresuar paragjykimin gjinor në vendimet e gjykatave dhe institucionet ligjzbatuese. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor u miratuan në prill dhe sigurojnë 50% kuota gjinore si kusht për listat e kandidatëve në këshillat bashkiakë, dhe refuzimin e listave të cilat nuk përmbushin këtë kuotë. Dhjetë përqind e kandidatëve për kryebashkiakë në zgjedhjet elektorale të qershorit, ishin gra dhe nëntë gra u zgjodhën si kryebashkiake, duke shënuar një rritje të konsiderueshme. Në 2015, nga 140 deputetë të Kuvendit, 29 ishin gra (21%).

Për sa i përket **të drejtave të fëmijëve**, sistemi i mbrojtjes së të miturve nuk ka mjetet buxhetore, vazhdimësinë e stafit dhe standarde funksionale të mjaftueshme. Nevojitet më shumë punë për ta bërë të aksesueshëm për të miturit. Një direktivë e përbashkët e katër ministrave u miratua, duke identifikuar procedurat për mbrojtjen e fëmijëve në rrezik, duke përfshirë të miturit e abuzuar seksualisht. Numri i Qendrave për Mbrojtjen e Fëmijëve (QMF) u rrit në 196 në nivel vendor; megjithatë shumë të mitur në zona rurale nuk kanë akses në to. Vetëm pesë qendra të të drejtave të fëmijëve punojnë në nivel rajonal; shtatë nuk funksionojnë më për shkak të mungesës së fondeve. QMF duhet të integrohen me shërbimet shoqërore dhe të pajisen me udhëzime të qarta raportimi dhe monitorimi. Bashkëpunimi me institucionet në nivel rajonal dhe kombëtar duhet të rritet.

Nevojitet më tepër punë për rikthimin e të miturve në mjediset familjare, duke zmadhuar qendrat e birësimit dhe siguruar mbrojtje speciale për të miturit në institucionet banuese. Nevojitet një rishikim i Kodit të Familjes për të lehtësuar vendosjen e fëmijëve në familjet birësuese dhe për të garantuar procedurat e adoptimit në përputhje me standardet ndërkombëtare. Emigrimi i të miturve të pashoqëruar nga Shqipëria drejt BE mbetet një çështje shqetësuese.

Ende nuk ka një sistem të drejtësisë për të miturit, i cili të vendosë legjislacionin ekzistues në përputhje me standardet evropiane. Shumica e 96 të miturve të ndaluar mbahen në institucionit e korrektimit në Kavajë dhe në mjediset e paraburgimit në Vlorë, ku ofrohen kushte më të mira sesa në mjediset tjera. Megjithatë, të miturit vazhdojnë të mbahen të ndaluar më shumë se parashikon ligji për ndalimin dhe paraburgimin për shkelje të vogla. Kohëzgjatja e tepruar e ndalimit para procesit gjyqësor është shqetësues. Niveli i përsëritjes së shkeljeve nga të miturit është i lartë dhe nuk ka mundësi për ofrimin e riedukimit. Vazhdon të ketë mungesë koordinimi ndërmjet drejtësisë dhe sistemeve të mbrojtjes së të miturve që dalin nga sistemi i drejtësisë, të cilët kanë nevojë për mbështetje që të ri-integrohen në shoqëri.

Në lidhje me punën e fëmijëve, anketa kombëtare për fëmijët në situatë rruge, e cila përfundoi në prill

rezultoi se deri në 2 500 fëmijë, kryesisht romë dhe egjiptianë, jetojnë dhe/ ose punojnë në rrugë. Punësimi i fëmijëve në plantacionet e kanabisit përbën shqetësim serioz. Shqipëria mbetet vend origjine për trafikimin e fëmijëve dhe punën e detyruar të fëmijëve dhe për format më të këqija të punës së fëmijëve të përcaktuar nga Konventa ILO 182.

Në lidhje me **integrimin e personave me aftësi të kufizuara**, gjuha e shenjave u miratua si gjuhë zyrtare për personat e shurdhët. Shumica e fëmijëve me aftësi të kufizuara mbeten të përjashtuar nga shkolla dhe arsimit profesional. Personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me vështirësi aksesit në arsim, punësim, kujdes shëndetësor, shërbime sociale dhe vendimmarrje.

Streha e parë për personat **lesbikë, homoseksualë, biseksualë, transeksualë dhe ndërgjinorë (LGBTI)**, u hap në Tiranë në dhjetor. Në maj, kuvendi miratoi rezolutën për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave që i përkasin komunitetit LGBTI, që kërkon një plan veprimi, ndryshime legjislative dhe masa të tjera për të mbrojtur personat LGBTI, dhe bëri Avokatin e Popullit përgjegjës për monitorimin e zbatimit të tij. Dita Ndërkombëtare Kundër Homofobisë u festua në maj, me një sërë aktiviteteve sensibilizuese megjithatë sensibilizimi publik mbetet i ulët. Shqipëria nënshkroi Deklaratën e Përbashkët të Ministrave të rajonit në forumin IDAHO 2015. Parada e dytë e krenarisë u zhvillua në qershor pa incidente. Diskriminimi ndaj personave transgnder dhe ndërgjinorë duhet të hiqet nga legjislacioni.

Të drejtat e punës dhe të bashkimit në sindikata janë respektuar në përgjithësi. Këshilli i ri Kombëtar i Punës përmirësoi funksionimin e tij dhe mbledhet rregullisht.

Përsa i përket të **drejtave procedurale**, komponentë bazë ekzistojnë, por nevojiten më shumë përpjekje për të rritur mbrojtjen e siguruar nga legjislacioni ekzistues dhe për të siguruar zbatimin e tij efektiv. Për sa i përket ndihmës ligjore, funksionimi i Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike duhet të përmirësohet për të përballuar nevojat e qytetarëve vulnerabël. Gjashtë zyra rajonale për ndihmën ligjore nuk janë krijuar ende.

Për sa i përket respektimit dhe mbrojtjes së **minoriteteve**, marrëdhëniet ndër-etnike kanë vazhduar të jenë të mira, por kuadri ligjor dhe politik ka nevojë për përmirësim. Në prill, grupi i punës ndër-institucional për minoritetet, drejtuar nga Ministria e Punëve të Jashtme paraqiti konkluzionet me qëllim adresimin e problemeve për mbrojtjen e minoriteteve, duke patur parasysh rekomandimet e Komisionit Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Grupi sugjeroi hartimin e një ligji specifik për minoritetet me qëllim trajtimin e barabartë të pakicave kombëtare dhe etno-gjuhësore, duke zhvilluar rolin përfaqësues dhe këshillimor të Këshillit Shtetëror për Minoritetet. Shqipëria ende nuk ka miratuar Kartën Evropiane për gjuhët rajonale dhe minoritare. Përfaqësuesit e pakicave kombëtare kanë sfiduar ndryshimet e fundit të kufijve të qeverisjes vendore, me arsyetimin se sistemi i ri shkel të drejtat e tyre dhe normat ndërkombëtare. Aksesit i barabartë për të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve akoma mbetet për t'u siguruar.

Zbatimi i politikave për përfshirjen e **romëve** mbetet joadekuat, në përgjithësi, ashtu si zbatimi i konkluzioneve të seminareve të dhjetorit 2011 dhe 2014. Plani kombëtar i veprimit 2015-2020 për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve mbetet ende për t'u miratuar. Përfshirja e fëmijëve romë në sistemin arsimor është përmirësuar; megjithatë përqindja e regjistrimit dhe braktisjes mbetet një problem serioz: 42% e fëmijëve romë ndjekin arsimin para-shkollor (3-6), por vetëm 16.1% përfundojnë arsimin fillor, 2.1% kanë arsim të mesëm, dhe 0.3 % kanë arsim universitar. 40.3% e popullsisë rome është analfabete.

Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë në rrugë mbetet shqetësues. Kuadri ligjor dhe institucional ekzistues për regjistrimin e lindjeve nuk po jep rezultatet e synuara. Personat romë dhe egjiptianë vazhdojnë të përballen me kushte jetese shumë të vështira dhe shpesh me diskriminim dhe përjashtim social, sidomos për sa i përket aksesit në kujdes shëndetësor, mbrojtjes sociale, punësimin dhe strehimit.

Alokimet buxhetore për strehimin e personave romë dhe egjiptianë janë trefishuar, por mbeten të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat. Shumica e familjeve romë të dëbuara nga vendbanimet e tyre në gusht 2013, të transferuara në një qendër të përkohshme në tetor vazhdojnë të jetojnë atje. Megjithëse disa familje përfituan nga banesat sociale të bashkisë, nuk ka një zgjidhje afatgjatë për të rialokuar të tjerët. Dëbime të mëtejshme u kryen në Selitë për ndërtimin e rrugës për unazën e Tiranës. Përveç ofrimit të qirasë për një periudhë dy vjeçare, shumica e familjeve të dëbuara nuk kanë marrë asistencë për të gjetur një vendbanim të ri përshtatur me nevojat e tyre specifike.

Përfundim

Në tërësi, Shqipëria ka bërë disa përmirësime në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore për zbatimin e *acquis* dhe standardeve evropiane.

Për sa i përket gjyqësorit, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në drejtësi u krijua për të ndërmarrë një reformë gjithëpërfshirëse. Pavarësia e plotë dhe llogaridhënia e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk është e siguruar. Administrimi i sistemit të drejtësisë është i ngadaltë dhe vendimet gjyqësore nuk zbatohen gjithmonë. U miratuan strategjia e re anti-korrupsion me planin e veprimit përkatës. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të mbetet shqetësim serioz. Në fushën e të drejtave themelore, nevojiten përpjekje të mëtejshme për zbatimin efektiv të legjislationit dhe strategjive.

Gjatë vitit tjetër, Shqipëria duhet të forcojë llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe të luftojë korrupsionin në sistemin e drejtësisë; të tregojë progres të vazhdueshëm me qëllimin për të krijuar një historik rezultatesh të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në të gjitha nivelet.

Në lidhje me të drejtat e fëmijës, Shqipëria duhet të parashikojë mekanizma institucionalë për mbrojtjen e fëmijëve, mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, dhe barazisë gjinore, të vazhdojnë përpjekjet për të sjellë legjislationin ekzistues për drejtësinë e të miturve në përputhje me standardet ndërkombëtare, të rrisë përpjekjet për të krijuar një ligj solid për mosdiskriminimin dhe të rrisë përpjekjet për të gjetur një zgjidhje afatgjatë për të drejtën e banimit të grupeve vulnerabël.

Shqipëria duhet të përmirësojë zbatimin e strategjisë për të drejtat e pronësisë 2012-2020 dhe procesin e regjistrimit, kthimit dhe kompensimit të pronave.

(Shih gjithashtu rekomandimet specifike për sistemin gjyqësor, luftën kundër korrupsionit dhe lirinë e shprehjes së seksionet 2.3 dhe 2.4)

4.24. Kapitulli 2: Drejtësia, liria dhe siguria

Migracioni ligjor dhe i parregullt

Profili i zgjeruar i migracionit, i cili përmban të dhënat kyçe për migracionin shqiptar u miratua në dhjetor; profile 2014 ka përfunduar dhe pritet të miratohet në tetor 2015. U bënë përpjekje për të adresuar çështjet e migracionit në disa strategji kombëtare sektoriale për periudhën 2014-20, duke përfshirë mbrojtjen dhe përfshirjen sociale, punësimin, biznesin dhe zhvillimin, menaxhimin e integruar të kufijve dhe luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore. Megjithatë, mungesa e një strategji kombëtare ndërsektoriale për migracionin mbetet një çështje shqetësuese. Procesi i para-skanimit në kufi duhet të forcohet dhe kapacitetet pritëse për migrantët e paligjshëm kanë nevojë të përmirësohen, sidomos në kufirin jugor, për të përballuar fluksin në rritje të migrantëve. Mekanizmat e regjistrimit dhe referimit kanë nevojë të forcohen.

Në gjashtëmujorin e parë të 2015, u kapën 1 963 migrantë të paligjshëm, krahasuar me 601 në të njëjtën periudhë në 2014. Shqipëria duhet të ndjekë penalisht trafikimin e njerëzve pasi numri i arrestimeve dhe

ndjekjeve penale mbetet i ulët.

Azili

Shqipëria i ka dhënë azil të dëbuarve iranianë, ish rezidentë të kampit të përkohshëm në Hurriya, Irak. Në nëntor, Shqipëria pranoi 235 persona nga ky komunitet, duke e çuar numrin e tyre në total në 479. Në 2014, 427 persona, kryesisht nga Irani dhe Siria, kërkuan azil në Shqipëri. Azili iu dha 10 personave. Në gjysmën e parë të 2015, pati 112 kërkesa për azil, dhe 50 persona fituan të drejtën e azilit. Lëshimi i kartave të identitetit dhe dokumenteve të udhëtimit për refugjatët filloi në maj. Kapacitetet e banimit dhe procedurat e azilit kërkojnë përmirësime. Megjithëse janë siguruar shërbimet e përkthimit, mungesa e përkthyesve të kualifikuar mbetet shqetësim. Një sistem menaxhimi i rasteve të azilit duhet të sigurohet. Nuk ka një strukturë të specializuar për të mbledhur informacion nga vendet e origjinës. Procedurat që përcaktojnë statusin e mbrojtjes ndërkombëtare kanë nevojë të përmirësohen. Shqipëria ka vendosur kontaktet e para me Zyrën Evropiane për Azil (EASO).

Për sa i përket **politikës së vizave**, Shqipëria ende nuk e ka përafuar legjislacionin me listat pozitive dhe negative të BE-së. Heqja e vizave ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë ka vazhduar pa asnjë pengesë, por flukset e paligjshme të emigracionit nga Shqipëria janë shtuar ndjeshëm nga viti 2013 dhe kanë arritur nivele më të larta në 2014 dhe 2015. Numri i azilkërkesve nga Shqipëria u rrit me 51% nga viti 2013 në 2014, duke arritur në total 16 795. Nga janari deri në fund të gushtit 2015, Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendet e asociuara të Schengen-it raportuan se numri i kërkesave për azil të shtetasve shqiptarë ishte 45 000. Shqipëria ka intensifikuar procedurat e kontrollit të kufijve dhe është angazhuar në terren. Megjithatë, Shqipëria pritet të ndërmarrë masa me qëllim që të adresojë numrin në rritje të kërkesave për azil në Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendet e asociuara të Schengen-it, dhe të marrë masa të menjëhershme në kuadrin e mekanizmit të monitorimit të post-liberalizimit të vizave. Kjo bëhet edhe më urgjente, pas shifrave rekord të kërkesave gjatë verës. Shqipëria duhet të përmirësojë bashkëpunimin operacional dhe shkëmbimin e informacionit me Shtetet Anëtare të BE-së, si edhe duke kryer hetime të ndërmjetësve të emigracionit të paligjshëm, kontrolle kufitare më efikase, fushata informimi për udhëtarët dhe, mbi të gjitha, duke ulur faktorët nxitës social-ekonomikë. Përpjekjet në të gjitha këto fusha duhet të vazhdojnë sistematikisht dhe me alokimin e burimeve të nevojshme. Kujdes i veçantë duhet treguar në efektivitetin e kontrollove në kufij, përfshirë parandalimin e minoreneve të pashoqëruar të cilët lënë vendin. Numri i minoreneve të pashoqëruar nga Shqipëria, të cilët qëndrojnë ilegalisht ose kërkojnë azil në BE dhe në vendet e asociuara të Schengen-it është rritur.

Është bërë progres në bashkëpunimin me shoqërinë civile për fushata sensibilizuese, asistuar nga kthime vullnetare, kthime të monitoruara dhe ri-integrimi i grupeve vulnerabël. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të siguruar zbatimin efektiv të Strategjisë 2010-15 dhe planin të veprimit për migrantët e kthyer dhe hartimi i një strategjie të re ri-integrimi, bazuar në impaktin e plotë vlerësues të të mëparshmit. Zbatimi i marrëveshjes së ripranimit ka vazhduar normalisht. Një protokoll zbatimi u nënshkrua me Portugalinë. Negociatat për marrëveshje ripranimi dhe protokolle zbatimi vazhdojnë me Ukrainën dhe Federatën Ruse, dhe me Greqinë për protokollin e zbatimit. Marrëveshje për shkëmbimin e informacionit mbi migracionin duhet të nënshkruhet me më shumë Shtete Anëtare të BE-së për të fuqizuar bashkëpunimin mbi ripranimin dhe kthimin. Në 2014, u është refuzuar hyrja në BE 12 867 qytetarëve shqiptarë dhe janë regjistruar 11 923 refuzime për largim nga Shqipëria.

Kufijtë e jashtëm dhe Schengen-i

Dy qendrat e përbashkëta të bashkëpunimit policor të ngritura në pikat kufitare me Malin e Zi dhe Kosovën po ngrihen dhe priten të jenë funksionale deri në fund të vitit. Qendra të bashkëpunimit policor trepalësh me Greqinë dhe Italinë dhe një qendër dypalësh në kufirin grek priten të ngrihen së shpejti. Pritet të nisë puna në dy pikat kufitare me Malin e Zi dhe një me Kosovën dhe protokollin për zbatimin e pikës së re kufitare me Malin e Zi pritet të firmoset. Në periudhën janar - gusht, Shqipëria zbuloi 157 raste të dokumenteve të falsifikuara dhe të rreme, krahasuar me 134 raste gjatë së njëjtës periudhë në

2014. Strategjia dhe plani i veprimit për menaxhimin e integruar të kufijve janë në përputhje të plotë me standardet evropiane. Nevojiten investime të mëtejshme në menaxhimin e kufijve për të qenë në të njëjtin hap me sfidat në zhvillim të krimit ndërkufitar dhe migracionit të paligjshëm. Është konsoliduar bashkëpunimi praktik me Frontex-in në analizat e përbashkëta të riskut. Kapacitetet e policisë kufitare dhe migratore kane nevojë të forcohen për të përforcuar pikat kufitare dhe për të përforcuar mbikëqyrjen e kufijve “jeshil” dhe “ blu” (tokë dhe det). Moszabtimi i kontrolleve në pikat kufitare midis Shqipërisë dhe Kosovës mbetet një problem shqetësues. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndër-institucional për menaxhimin e kufirit blu është përmirësuar. Qendra Ndër-institucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe sistemet e mbikëqyrjes dhe komunikimit detar janë plotësisht funksionale. Kapacitetet operacionale të QNOD-së si dhe qëndrueshmëria financiare dhe teknike e sistemeve të mbikëqyrjes të saj duhet të garantohet përmes planifikimit të duhur të burimeve buxhetore.

Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale

Shqipëria ka mbajtur një bashkëpunim të mirë gjyqësor në çështjet civile dhe penale, përfshirë me Shtetet Anëtare të BE-së. Megjithatë bashkëpunimet ndërkombëtare kanë nevojë të përmirësohen bazuar në zbatimin në kohë të instrumenteve shumëpalësh dhe kapacitetit më të madh institucional. Nevojitet përpjekje të mëtejshme për rritjen e bashkëpunimit me Eurojust. Vlerësimi i standardeve të mbrojtjes së të dhënave nga Eurojust po vazhdon.

Lufta kundër krimit të organizuar

Historiku i rezultateve bindëse

Në 2014, 134 persona u dënuan për krime të organizuara (krahasuar me 129 në 2013), shumica për **trafikim droge**. Pati shumë pak raste të **trafikimit të qenieve njerëzore**. Njëmbëdhjetë çështje u gjykuan nga Gjykata e Krimeve të Rënda e Shkallës së parë, krahasuar me asnjë në 2013, me vetëm tetë dënime (asnjë dënim në 2013).

Për sa i përket pastrimit të parasë, numri i raportimeve të transaksioneve të dyshimta u rrit në 1230 në 2014, më shumë se dyfishi i 2013. Megjithatë numri i dënimeve për pastrimin e parave mbetet i ulët. Vlera totale e aseteve kriminale të konfiskuara u rrit: Gjykata e Apelit për Krime të Rënda nxori pesë vendime konfiskimi për më shumë se 1 milion Euro dhe pesë pasuri të paluajtshme, krahasuar me 747 000 Euro në 2013.

Përsa i përket **trafikimit të drogës**, Shqipëria intensifikoi luftën kundër tregtisë së drogës dhe rrjeteve të shpërndarjes. Sasia e drogës së kapur u rrit. Në 2014, 73.5 kg heroinë, 10.3 kg kokainë dhe më shumë se 97 ton marijuanë u kapën (krahasuar me 47,3 kg heroinë, 16.1 kg kokainë dhe pothuajse 21 ton marijuanë në 2013). Magazinimi i sigurt i drogës së kapur dhe procedurat efektive të asgjësimit të saj nuk janë siguruar ende dhe mbeten një problem shqetësues.

Në 2014, 180 raste të **krimit kibernetik** ku të përfshirë ishin 86 persona u zbuluan, krahasuar me 108 raste në 2013.

Kapacitet institucionale dhe funksionale

Policia mbetet e prekshme nga presioni politik dhe korrupsioni, duke penguar hetimin efektiv të rasteve të krimit të organizuar. Nevojiten përpjekje substanciale për të rritur kapacitetet dhe përmirësuar performancën e të gjithë autoriteteve ligjzbatuese. Prokurorëve të cilët kanë të bëjnë me çështje të ndjeshme lidhur me krimin e organizuar duhet t'u garantohet mbrojtja e nevojshme dhe t'i sigurohet pavarësia nga çdo lloj ndërhyrje e jashtme apo e brendshme.

Krijimi i tri njërive të lëvizshme në Tiranë, Vlorë dhe Elbasan kontribuoi në rritjen e identifikimit të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikut të qenieve njerëzore. Që nga krijimi i tyre në shtator 2014, janë identifikuar 102 viktima të mundshme të trafikut të qenieve njerëzore. Shumica e viktimave janë trafikuar për qëllime seksuale, punë të detyruar dhe lypje.

Sistemi i Teknologjisë së Informacionit për statistikën e krimit është tashmë duke u shqyrtuar për të dhënë një pamje më të qartë dhe të besueshme për statusin e krimeve. Një sistem menaxhimi elektronik i çështjeve në zyrat e prokurorisë filloi me një fazë pilot në janar. Përgatitjet për ndërtimin e kapaciteteve të një laboratorit kriminalistik për mbledhjen, krahasimin dhe mbajtjen e profileve të ADN-së ka filluar. Sistemi i Indeksimit të ADN-së (CODIS) u instalua në prill dhe përdoruesit janë trajnuar.

Një program shkëmbimi me Kolegjin Policor Evropian po vazhdon, mbi bazën e një marrëveshje bashkëpunimi. Megjithatë akoma nuk është shfrytëzuar plotësisht për të përfituar nga të gjitha kurrikulat e trajnimit.

Kuadri ligjor

Ligji i ri për Policinë e Shtetit hyri në fuqi në maj. Ai krijoi një rekrutim bazuar në merita dhe një sistem të vlerësimit të karrierës, dhe përafroi Kodin e Etikës dhe standardet e kontrollit të brendshëm me nivelet evropiane. Në shkurt, Komisioni Parlamentar për Sigurinë Kombëtare

miratoi projektligjin për policinë ushtarake në forcat e armatosura, me qëllim parandalimin, zbulimin dhe hetimin e aktiviteteve kriminale në forcat e armatosura. Qëllimi i ligjit tëri mbetet ende për t'u qartësuar në drejtim të ndarjes të përgjegjësive ndërmjet policisë penale ushtarake dhe policisë gjyqësore. Në shkurt, qeveria miratoi një vendim mbi organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë.

Kuadri strategjik

Në nëntor u miratuan strategjia për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2014-17 dhe plani i veprimit. Shqipëria ka përditësuar dhe ka vazhduar të zbatojë strategjinë dhe planin e veprimit për luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit. Një dokument politikash për sigurinë kibernetike është përgatitur dhe pret miratimin e qeverisë. Në prill, Prokuroria e Përgjithshme miratoi strategjinë afatmesme 2015-17 dhe planin e veprimit për të rritur standardin e hetimit dhe rritur profesionalizmin dhe integritetin e prokurorëve.

Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit është thelbësore për të luftuar infiltrimin e krimit në sistemin politik, juridik dhe ekonomik.

Shqipëria ka vazhduar të zbatojë strategjinë dhe planin e veprimit për **luftën kundër terrorizmin**. Një strategji sigurie është miratuar, por plani i veprimit dhe një kalendar i qartë ende nuk janë hartuar. Strategjia për parandalimin e ekstremizmit dhe terrorizmit u finalizua dhe pritet të miratohet. Në shtator, Komisioni i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (Moneyval) hoqi Shqipërinë nga lista e shteteve nën monitorim për pastrim parash dhe financim terrorizmi. Në dhjetor, u krijua një Drejtori kundër terrorizmit dhe katër degë rajonale në Policinë e Shtetit. Megjithatë ato nuk janë plotësisht funksionale dhe me staf. Megjithatë një drejtori tërësisht funksionale kundër terrorizmit, që të punojë në bashkëpunim të ngushtë me shërbimin sekret dhe policinë kufitare, mbetet kyçe për të trajtuar kërcënimet terroriste efektive. U krijua Task Forca për terrorizmin dhe ekstremizmin fetar, duke përfshirë Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Brendshme, Policinë e Shtetit dhe Shërbimin Informativ Shtetëror (SHISH). Nëntë imamë të vet-shpallur, janë në gjyq me akuzat e promovimit të akteve të terrorizmit. Shqipëria duhet të përgatisë një politikë efektive për të parandaluar radikalizmin, me masa legjislative dhe aktivitete sociale-ekonomike me qëllim për të forcuar integritimin shoqëror, sidomos për të rinjtë dhe për të rritur përpjekjet për të identifikuar, parandaluar dhe ndaluar luftëtarët e huaj terroristë të udhëtojnë në zonat e konfliktit si Iraku dhe Siria.

Bashkëpunimi në luftën kundër drogës

Bashkëpunimi me Qendrën Evropiane të Monitorimit për Drogën dhe Varësinë nga Droga vazhdoi. Survejimi nga ajri solli një rritje të ndjeshme të identifikimit të plantacioneve të drogës dhe asgjësimin e tyre. Në 2014, një total prej 551 414 rrënjë kanabis u shkatërruan, një rritje me 460% krahasuar me 2013. Në 10 muajt e parë të 2015, numri i marijuanës të asgjësuar u rrit me pothuajse 40 % krahasuar me numrin total për 2014, duke përbërë më shumë se 99% të plantacioneve. Në janar, një operacion i gjerë policor rezultoi në shpërbërjen e një laboratorit të madh droge në Elbasan, ku droga përpunohej për në tregun evropian. Një tjetër operacion i zhvilluar në bashkëpunim me Gjermaninë rezultoi në kapjen e 19,4 kg kokainë të pastër dhe 97.6 kg kokainë të përzier, dhe konfiskimin e 321 950 euro dhe një numër të madh armësh zjarri. Megjithëse suksesi i operacionit të gjerë policor në Lazarat në 2014 shënoi një arritje të rëndësishme funksionale në luftën kundër kultivimit të drogës, hetimi dhe ndjekja penale nuk janë vendosur. Nga 187 raste të sjella nga policia, Prokuroria për Krimet e Rënda dërgoi në gjykatë kërkesën për gjykim ndaj 16 personave për disa vepra penale. Nuk u bë asnjë akuzë për pjesëmarrje në organizata kriminale.

Bashkëpunimi doganor

Sistemi dixhital i monitorimit me kamera 24 orë është tërësisht funksional. Numri i hetimeve ndaj punonjësve të doganës është rritur në krahasim me vitet e kaluar.

Për masat kundër **falsifikimit të euros**, shih Kapitulli 32 - Kontrolli financiar.

Përfundim

Shqipëria ka bërë përparim të mëtejshëm në këtë fushë. Duhet të merren hapa për përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve në fushat e menaxhimit të kufirit, azilit dhe luftën kundër korrupsionit. Shqipëria ka filluar të pajisë me karta identiteti dhe dokumente udhëtimi refugjatët dhe është e gatshme të lëshojë dokumente të tilla personave të marrë në mbrojtje. Rritja alarmante e numrit të kërkesave të pabaza për azil nga shqiptarët në Shtetet Anëtare të BE-së përbën shqetësim. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet veçanërisht të intensifikojë hetimet e inteligjencës për pastrimin e parave dhe krimet financiare dhe të rrisë konfiskimin e aseteve kriminale. Shqipëria duhet të fokusohet edhe në konsolidimin e përpjekjeve në parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit duke forcuar drejtorinë antiterror, bashkëpunimin ndërinstytucional dhe zbatimin e politikave të caktuara për të parandaluar radikalizmin.

Duhet të ndërmerren masa për të adresuar në mënyrë efektive fenomenin negativ të kërkesave të pabaza për azil, dhe t'i jepet prioritet hetimeve të personave të cilët mundësojnë migracionin e paligjshëm.

(Shiko gjithashtu rekomandimet specifike për luftën kundër krimin të organizuar në seksionin 2.3)

4.25 Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi

BE ofron mbështetje të rëndësishme për kërkimin dhe novacionin. Të gjitha Shtetet Anëtare mund të përfitojnë nga programet kërkimore të BE-së, aq më tepër kur ekziston ekselencia shkencore dhe investime të qëndrueshme në fushën e kërkimit.

Përgatitje në fushën e shkencës dhe kërkimit janë në **fazë të hershme. Nuk janë bërë përparime gjatë vitit të kaluar.** Vitin e ardhshëm, vendi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ ngritjes së kapaciteteve dhe rritjes së investimeve në fushën e kërkimit për të siguruar integrimin në Hapësirën Evropiane të Kërkimit dhe për të kontribuar në Unionin e Novacionit;

→ rritjes së përpjekjeve për pjesëmarrje të suksesshme në programin kuadër të kërkimit dhe novacionit Horizon 2020.

Në tërësi, masat në fushën e kërkimit dhe novacionit në përputhje me politikën e BE-së nuk janë zbatuar për shkak të mungesës së fondeve të brendshme.

Për sa i përket **programeve kuadër**, Shqipëria bën pjesë në programin kuadër të kërkimit dhe novacionit të BE-së 'Horizon 2020' (2014-2020) dhe të gjitha hapat administrative për pjesëmarrjen në këtë program janë duke u zbatuar (janë emëruar pikat kombëtare të kontaktit dhe përfaqësuesit në komitetin e programit kuadër Horizon 2020). Bazuar në statistikën e para të programit Horizon 2020, numri i pjesëmarrësve shqiptarë në propozimet e përzgjedhura për financim ka qenë shumë i vogël. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Novacionit ende ka mungesa të burimeve për nxitjen e bashkëpunimit në fushën e kërkimit dhe novacionit. Shqipëria duhet të marrë masa për të përmirësuar ekselencën shkencore dhe duhet të nxitet pjesëmarrja e sektorit privat në fushën e kërkimit dhe novacionit.

Shqipëria ka qenë aktive në bashkëpunim në nivel rajonal pas nënshkrimit të strategjisë rajonale R&D të Ballkanit Perëndimor për novacionin dhe bashkëpunon me Iniciativën e Evropës Qendrore.

Për sa i përket integritimit në **Hapësirën Evropiane të Kërkimit**, Shqipëria ka emëruar një anëtar në Komitetin e Hapësirës Evropiane të Kërkimit, e megjithatë, ajo nuk merr pjesë në të mbi bazë të rregullt. Niveli i investimeve në kërkim ka ngecur në rreth 0.4 % të GDP së Shqipërisë. Ky tregues është i pamjaftueshëm për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në procesin e konkurrueshmërisë dhe rritjes. Për arsye të mungesës së statistikave të besueshme është gjithashtu e vështirë të matet niveli i saktë, veçanërisht për shpenzimet në fushën e kërkimit nga sektori privat.

Në fushën e **Unionit të Novacionit**, nuk janë marrë masa të veçanta për të nxitur novacionin.

4.26.Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura

BE mbështet bashkëpunimin në arsim dhe kulturë nëpërmjet financimit të programeve dhe metodës së hapur të bashkëpunimit. Gjithashtu Shtetet Anëtare duhet të parandalojnë diskriminimin dhe të lehtësojnë edukimin e fëmijëve të punëtorëve migrant të BE-së.

Shqipëria ka bërë **përgatitje të moderuar** në arsim dhe kulturë. Përveç miratimit të ligjit të ri për Arsimin e Lartë, **nuk ka pasur përpertime** në vitin e kaluar. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të siguruar gjithëpërfshirjen, besueshmërinë, transparencën dhe cilësinë e sistemit arsimor. Vitin e ardhshëm, vendi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ zbatimit të ligjit të ri për arsimin e lartë me qëllim përmirësimin e cilësisë;

→ zbatimit në vijimësi të kurrikulave bazuar në kompetencën dhe rezultatet e të mësuarit, dhe plotësimin të trajnimit të mësuesve për këtë qëllim;

→ vijimin e ristrukturimit të arsimit dhe formimit profesional për të përmirësuar relevancën e tregut të tij dhe për të rritur lidhjet me sektorin privat.

Në fushën e **arsimit, formimit profesional dhe rinisë**, pas rekomandimeve të komisionit të pavarur për reformën në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, u miratua një ligj i ri për arsimin e lartë. Procesi i akreditimit ka filluar për të gjitha universitetet publike dhe private. Korniza gjithëpërfshirëse e kualifikimeve është në proces rishikimi. Është me rëndësi që diplomat të jenë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë.

Sektori i arsimit mbetet një zonë me risk të lartë për korrupsion. Procedura e rekrutimit për mësuesit dhe drejtorët e shkollave duhet të bëhet më transparente dhe e bazuar në merita. Megjithë përmirësimet e rëndësishme gjatë dekadës së fundit, Shqipëria ende ka mangësi të konsiderueshme në lidhje me vitet e shkollimit, normat e regjistrimit në shkollë të mesme, cilësinë e arsimit dhe relevancën e tregut të kualifikimeve. Shqipëria u fut në Aleancën Evropiane për Praktikantë.

Shpenzimet publike për arsimin janë të ulëta, rreth 3 % të GDP-së, ku arsimi fillor zotëron pjesën më të madhe të shpenzimeve (61%). Rezultatet e PISA 2012 për Shqipërinë, në testimin e 15-vjeçarëve ishin më të ulëta në rajon dhe e renditën Shqipërinë në vendin e 57 nga 65 vendet pjesëmarrëse. Shkalla e pjesëmarrjes në arsimin para-shkollor është rreth 30%. Strategjia kombëtare 2014-2020 për punësim dhe aftësi dhe plan veprimi përkatës u miratuan në nëntor. Ato duhet të shoqërohen me një plan financiar dhe monitorimi. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të forcuar lidhjet ndërmjet arsimit dhe tregut të punës.

Fëmijët romë dhe egjiptianë ende nuk janë integruar plotësisht në sistemin arsimor, gjë që shpesh çon në papunësi dhe përjashtimin e tyre. Vazhdojnë të zbatohen kuotat për regjistrimin në universitet të studentëve romë, egjiptianë dhe atyre të paprivileguar. Normat e regjistrimit për fëmijët romë dhe egjiptianë janë rritur pak, por në tërësi kanë mbetur të ulëta. Plan veprimi 2015- 2020 për integrimin e romëve dhe egjiptianëve dhe dokumenti mbi politikën e përfshirjes sociale,

pritet të miratohen nga qeveria (*shih gjithashtu Kapitulli 19 – Politikat sociale dhe punësimi*).

Për sa i përket rinisë, Shqipëria merr pjesë në programin Erasmus+ ‘*Youth in Action*’ (Rinia në veprim) dhe ‘*Western Balkans Youth Window*’, program për vendet e Ballkanit Perëndimor mbi ngritjen e kapaciteteve në sektorin e rinisë.

Në fushën e **kulturës**, Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë me të drejta të plota në programin e BE-së Evropa Krijuese.

4.27. Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimet klimatike

BE nxit masa të forta për klimën, zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit. Ligji i BE-së përmban dispozita që trajtojnë ndryshimet klimatike, cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, ndotjen industriale, kimikatet, zhurmën dhe mbrojtjen civile.

Shqipëria është në **fazë të hershme të përgatitjes** në këtë fushë. Janë bërë **disa përpertime** në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, megjithatë, kontrolli industrial dhe monitorimi i emetimeve dhe menaxhimit të mbetjeve mbetet i dobët. Në tërësi, burimet mbeten të kufizuara dhe nevojiten investime të konsiderueshme. Vitin e ardhshëm, vendi duhet t’i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ krijimit të planifikimit sistematik strategjik, fillimit të zbatimit të programit Kontributi Kombëtar i Synuar (INDC) për Marrëveshjen e Klimës 2015 që pritet të realizohet në Paris;

→ monitorimin e cilësisë së mjedisit dhe rritjes së kapaciteteve administrative;

Strategjia ndërsektoriale për **mjedisin** ende nuk është miratuar. Më shumë punë duhet bërë për përafrimin e **legjislacionit mjedisor horizontal**, në veçanti me Direktivën për Krimin Mjedisor. Konsultimi publik, aksesimi në informacion dhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile janë përmirësuar. Nevojitet të përshpejtohen masat fillestare të marra për të forcuar zbatimin e ligjit. Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis është përmirësuar, por duhet të forcohet në mënyrë të konsiderueshme, sidomos në sektorët e energjisë hidrike dhe minierave.

Për sa i përket **cilësisë së ajrit**, janë miratuar dhe duhet të zbatohen strategjia kombëtare për cilësinë e ajrit dhe ligji për mbrojtjen e cilësinë së ajrit në mjedis. Është zgjidhur ndarja e përgjegjësiive ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe organeve zbatuese. Ligji për ndalimin e duhanit në ambientet e mbyllura rezultoi efektiv. Shqipëria nuk plotësoi afatin e Komunitetit të Energjisë për të zbatuar Direktivën 1999 për Përmbajtjen e Sulfurit në Karburante. Shkeljet e njohura të vlerave standard për cilësinë e ajrit vazhdojnë. Cilësia e ajrit në qytete mbetet shumë problematike.

Planifikimi, koordinimi dhe zbatimi i politikave për menaxhimin e **mbetjeve** po përparon shumë ngadalë dhe kapacitetet administrative mbeten shumë të kufizuara. Legjislacioni zbatues në përputhje me *acquis* është miratuar në fushën e eksportimit dhe kalimit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe të ndërtimit, si dhe në fushën e përdorimit të llumrave të ujërave të zeza. Veçimi i mbetjeve është shumë i kufizuar dhe niveli i ricklimit mbetet i rrallë. Pjesa më e madhe e mbetjeve vazhdon të hidhet në mënyrë të pasigurtë në vendgrumbullime të ligjshme ose të paligjshme, ose digjet. Mbetjet e rrezikshme mjekësore përbëjnë një shqetësim serioz.

Në fushën e **cilësisë së ujit**, sektori i menaxhimit të ujërave i kaloi Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Menaxhimit të Ujërave dhe u krijua Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit. Janë miratuar rregullore të rëndësishme për përdorimin e ujërave, sipas ligjit për menaxhimin e integruar të ujërave. Në tërësi, cilësia e ujërave të larjes është përmirësuar, megjithatë mbetet në nivel të pakënaqshëm në lumenj. Ujërat e zeza të patrajtuara përbëjnë burimin kryesor të ndotjes. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të zgjeruar gamën e kryerjes së testit të ujit nga AKM. Më mars, përfundoi ndërtimi i impiantit të ujërave të zeza në Velipojë, por ende nuk është vënë në funksion. Pra numri i impianteve funksionale mbetet pesë.

Në fushën e **mbrojtjes së natyrës**, Parlamenti miratoi në shkurt një amendament për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës. Qendra Kërkimore për Florën

dhe Faunën duhet rrjedhimisht të konsultohen pare se të nxirret një leje tregtimi. Është ngritur Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit. Duhet ende të garantohet mbrojtja efektive për zonat e caktuara të mbrojtura. Investimet në sektorin e energjisë hidrike duhet të jenë në përputhje me detyrimet për mbrojtjen e natyrës veçanërisht për zonat e mbrojtura dhe zonat me vlerë të lartë natyrore dhe këto investime duhet të kryhen në përputhje me *acquis* veçanërisht me ligjin 'Për vlerësimin e ndikimit në mjedis', Direktivën e Kuadrit Ujor dhe Direktivat për Zogjtë dhe Habitatet.

Në fushën e **kontrollit të ndotjes industriale dhe menaxhimit të riskut**, ende nuk është miratuar ligji që transponzon Direktivën e BE-së për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore. Masat parandaluese nuk janë zbatuar dhe po kështu përgatitja e vlerësimit të riskut nuk është zbatuar. Vetë-monitorimi i emetimeve nuk është i besueshëm. Në tetor, u ngrit një Task Force për të inspektuar dhe vlerësuar përputhshmërinë mjedisore të kompanive për eksplorimin e naftës. Teknikat më të mira të disponueshme për të drejtuar procesin e vlerësimit të përputhshmërisë ende nuk janë miratuar.

Ligji kuadër për menaxhimin e **kimikateve** ende nuk është miratuar. Vendimi që rregullon kuotat e importit të substancave ozon holluese (HFCF) gjatë viteve të ardhshme deri në 2040 është amenduar në përputhje me angazhimet e Shqipërisë sipas Protokollit të Montrealit.

Për sa i përket politikave për **zhurmën në mjedis**, është miratuar një urdhër i përbashkët i Ministrave të Transportit dhe Mjedisit, ku përcaktohen rregullat për mbrojtjen nga zhurmat e avioneve. Ky urdhër transponzon vetëm pjesërisht direktivat e BE-së.

Për sa i përket **mbrojtjes civile**, ende nuk është miratuar strategjia kombëtare 2014-2018 për reduktimin e rreziqeve nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile. Përmbytjet në jug të vendit në muajin shkurt, treguan nevojën e Shqipërisë për të forcuar më tej kapacitetet e saj në këtë sektor.

Për sa i përket **ndryshimeve klimatike**, Shqipëria duhet të zhvillojë një politikë dhe strategji gjithëpërfshirëse në përputhje me kuadrin e BE 2030. Përpjekje të konsiderueshme nevojiten për të integruar plotësisht vlerësimet klimatike në të gjitha politikat përkatëse sektorale. Ka filluar përgatitja e planit kombëtar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. INDC lidhur me Marrëveshjen e Parisit 2015 për Klimën është miratuar në shtator. Prioritet duhet të mbetet harmonizimi me rregulloren për mekanizmat monitoruese të BE-së. Vendimi për reduktimin dhe stabilizimin e shkarkimeve të gazeve serrë të fluorinuara është miratuar por është përafuar vetëm pjesërisht me rregulloren relevante të BE-së. Ende nuk ka filluar ngritja e një sistemi monitorues, verifikues dhe raportues për shkarkimet e gazeve serrë.

AKM ka forcuar kapacitetet e saj administrative në mënyrë të konsiderueshme. Sistemi monitorues i mjedisit është përmirësuar por kërkon më shumë financim. Inspektorati Shtetëror i Mjedisit ka marrë hapat e para për të forcuar zbatimin e ligjit. Legjislacioni i paplotë zbatues, veçanërisht në sektorin e ujit, dhe burimet e kufizuara logjistike pengojnë funksionimin normal të inspektoratit.

4.28. Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit

Rregullat e BE-së mbrojnë konsumatorët në lidhje me sigurinë e produktit, imitimet e rrezikshme dhe përgjegjësinë për produkte defektive. BE siguron gjithashtu standarde të larta të përbashkëta për kontrollin e duhanit, gjakut, indeve, qelizave dhe organeve, të drejtat e pacientëve dhe sëmundjet ngjitëse.

Përgatitjet në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe shëndetit janë në **fazë të hershme**. Janë bërë **disa përparime** gjatë vitit të kaluar. Vitin e ardhshëm, vendi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ përafrimit të legjislacionit me *acquis* për kontrollin e duhanit, substancat me origjinë njerëzore dhe kërcënimet serioze ndërkuftare ndaj shëndetit, duke përfshirë sëmundjet ngjitëse;

→ miratimin e strategjisë kombëtare për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut;

→ ngritjen e inspektoratit për mbikëqyrjen e tregut.

Legjislacioni për **mbrojtjen e konsumatorit** në lidhje me disa aspekte të ndarjes së kohës, pushimeve afat-gjata dhe kontratat e këmbimit u miratua në tetor, me qëllim përafrimin me *acquis*. Një fushatë ndërgjegjësimit për mbrojtjen e konsumatorit ka nisur në 2014, por nevojitet më shumë veprim për t'i dhënë kompetenca konsumatorëve. Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit ka mungesë personeli dhe Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve nevojitet të forcojë kapacitetet e tij. Strategjia kombëtare 2020 për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut u miratua në shtator 2015.

Në fushën e **çështjeve që lidhen me sigurinë**, ende nuk është ngritur Inspektorati i Mbikëqyrjes së Tregut.

Në fushën e **çështjeve që nuk lidhen me sigurinë**, Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve ka nxjerrë vendime për kontratat standard të energjisë elektrike dhe ujit për konsumatorët, duke kërkuar heqjen e kushteve të padrejta. Bazuar në ankesat e konsumatorëve kundër një zyre të këmbimit valutës, Komisioni nxori një vendim ku i kërkonte operatorit të respektonte plotësisht legjislacionin. Komisioni rekomandoi miratimin e kodit të sjelljes për operatorët telefonik.

Në fushën e **shëndetit publik**, në shkurt u miratua një paketë për shërbimet e kontrollit mjekësor bazë, e cila adresonte probleme të kujdesit prenatal dhe postnatal si dhe kujdesin për fëmijët e posa lindur dhe fëmijët në përgjithësi. Përpjekje të konsiderueshme janë bërë për të luftuar korrupsionin në këtë sektor (shih Kapitulli 23). Rekordi Elektronik Shëndetësor Kombëtar ka filluar të zbatohet pas përfundimit të një studimi fizibiliteti në tetor. Sistemi i informimit shëndetësor ka nisur në disa institucione. Shqipëria ka nënshkruar një marrëveshje huaje me Bankën Botërore për ngritjen e qendrave të sistemit të informimit shëndetësor dhe forcimin e qeverisjes së spitaleve publike dhe financimin e sektorit shëndetësor me qëllim përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së kujdesit shëndetësor. Mbulimi i shërbimit mjekësor nga sigurimet shëndetësore ka mbetur në nivel shumë të ulët.

Në fushën e **kontrollit të duhanit**, ligji për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit është zbatuar në mënyrë të pabarabartë në sektorin e shërbimeve të mikpritjes.

Në lidhje me **sëmundjet ngjitëse**, njerëzit me HIV/AIDS kanë vështirsi në sigurimin e kujdesit shëndetësor. Strategjia për kontrollin e sëmundjes nga mushkonjat dhe një plan veprimi pritet të miratohen. Pak është punuar për të rritur kapacitetet e laboratorëve mikrobiologjik të sistemit spitalor dhe për të siguruar burime shtesë njerëzore. Sistemet raportuese për sëmundjet ngjitëse dhe laboratorët mikrobiologjik nuk janë integruar me sistemin e rekordit elektronik shëndetësor kombëtar.

Në fushën e **gjakut, indeve, qelizave dhe organeve**, janë përmirësuar praktikatat për sigurinë dhe transfuzionin e gjakut, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për përafrimin e legjislacionit me *acquis*.

Në fushën e **farmaceutikës**, ligji për barnat dhe shërbimet farmaceutike ka hyrë në fuqi në shtator 2014. Ky ligji është vetëm pjesërisht i përafëruar me *acquis*.

Në fushën e **shëndetit mendor**, janë bërë disa përparime në zbatimin e legjislacionit dytësor që rregullon shërbimet e shëndetit mendor, i cili përcakton përgjegjësitë e profesionistëve të sektorit të shëndetit mendor dhe standardet e mjeteve të shtrëngimit fizik për pacientët me sëmundje mendore. Në lidhje me **pabarazitë shëndetësore**, janë marrë masa për të përmirësuar aksesin e romëve në kujdesin shëndetësor nëpërmjet fushatave të vaksinimit, infermierëve në komunitet dhe vizitave në shtëpi; megjithatë, romët ende përballen me vështirësi në sigurimin e shërbimit mjekësor. Më shumë punë nevojitet për të siguruar shërbim mjekësor me cilësi për grupet më vulnerabël. Për sa i përket ushqyerjes, deri tani janë trajnuar 700 mjekë dhe infermierë të familjes duke përdorur modulet e trajnimit të integruar për gratë shtatzëna, foshnjat dhe fëmijët. Kequshqyerja e fëmijëve mbetet një shqetësim serioz. Në fushën e **kontrollit të kancerit**, pritet ende të krijohet sistemi i shërbimeve për monitorimin e kancerit dhe sistemi i regjistrimit të kancerit.

4.29. Kapitulli 29: Bashkimi doganor

Të gjitha Shtetet Anëtare janë pjesë e bashkimit doganor të BE-së dhe ndjekin të njëjtat rregulla dhe procedura doganore. Kjo kërkon përafrimin legjislativ si dhe kapacitetet e duhura zbatuese dhe akses në sistemet doganore të përbashkëta të kompiuterizuara.

Shqipëria ka bërë **përgatitje të moderuar** në fushën e bashkimit doganor. Janë bërë **disa përparime** veçanërisht në lidhje me përafrimin e legjislacionit me *acquis* dhe rritjen e pjesëmarrjes së vendit në programet e BE-së dhe bashkëpunimit rajonal. Vitin e ardhshëm, vendi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

- forcimit të luftës kundër kontrabandës dhe importeve të mallrave të falsifikuara;
- sigurimit të interoperabilitetit ndërmjet sistemeve doganore IT dhe ato të BE-së;
- vazhdimin të luftës kundër korrupsionit dhe shpërdorimeve në administratën doganore.

Në fushën e **legjislacionit doganor**, Kodi i ri Doganor hyri në fuqi në janar, së bashku me udhëzimet zbatuese, në përputhje me *acquis* për një gamë të gjerë çështjesh. Kodi u ndryshua përsëri në mars për të lejuar funksionimin e *duty-free shops* (dyqane të çliruara nga taksat). Tarifa doganore u përditësua në përputhje me versionin 2015 të nomenklaturës së kombinuar të BE-së. Në maj, rregullat e origjinës për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit iu referuan Konventës Rajonale për rregullat preferenciale të origjinës Pan-Euro-Med. Legjislacioni që hyri në fuqi më 26 gusht, kërkon pagesën e "tarifës së skanimit" për deklarimet doganore. Neni 33.1 i MSA ndalon futjen e detyrimeve doganore për importet ose eksportet apo tarifatat që kanë efekt të njëjtë në tregti ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.

Për sa i përket **kapaciteteve administrative dhe operacionale**, Drejtorja e Përgjithshme e Doganave ka nisur zbatimin e 'Vijës së gjelbër' në pikat doganore. Kjo iniciativë lejon kompanitë me rekord të mirë doganor të përfitojnë nga procedurat doganore preferenciale, duke përshpejtuar formalitetet doganore. Statusi i nëpunësit civil të punonjësve doganor është konfirmuar në kodin doganor në përputhje me Ligjin për Nëpunësin e Shërbimit Civil, dhe legjislacioni për procedurat dhe kërkesat për punësimin dhe promovim në administratën doganore u miratua në dhjetor. Të ardhurat doganore kanë rënë gjatë tremujorit të parë të vitit 2015 dhe kapacitetet për grumbullimin e tyre duhet të forcohen. Është përmirësuar bashkëpunimi me Prokurorinë dhe Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në identifikimin e rasteve të korrupsionit, duke çuar në shkarkimin nga puna të një numri të punonjësve doganor. Në maj 2015 u kryen testet e integritetit për 123 punonjës doganor dhe ndaj 26 prej tyre u morën masa disiplinore. Shqipëria bën pjesë në programin e BE-së Dogana 2020 që prej dhjetorit.

Në shkurt u inagurua korridori i përbashkët i tranzitit Shqipëri-Kosovë për të lehtësuar procedurat e kalimit në doganë dhe për të rritur tregtinë në rajon.

4.30. Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë

BE ka politika të përbashkëta tregtare ndaj vendeve të treta, bazuar në marrëveshjet multilaterale dhe bilaterale dhe masat autonome. Ekzistojnë gjithashtu rregulla të BE-së në fushën e ndihmës humanitare dhe politikave të zhvillimit.

Shqipëria ka bërë **përgatitje të moderuar** në fushën e marrëdhënieve me jashtë. Janë bërë **disa përparime** vitin e kaluar. Shqipëria ka vazhduar një bashkëpunim të mirë me BE-në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT). Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

- forcimit të mekanizmave të politikave tregtare të koordinimit/konsultimit.

Shqipëria ka vazhduar të koordinojë politikën e saj tregtare me **politikën e përbashkët tregtare** të BE-së në OBT. Vetë-vlerësimi i Shqipërisë 2014 për kapacitetet e lehtësimit të tregut tregoi 85% pajtueshmëri me kërkesat e OBT. Shqipëria u njoh me dispozitat e Marrëveshjes së OBT për Lehtësimin e Tregtisë të cilat do t'i zbatojë në kohën kur marrëveshja hyn në fuqi dhe ka filluar përgatitjet për ratifikimin e marrëveshjes.

Nuk ka pasur zhvillime për *kreditë e eksportit*. Kanë filluar përgatitjet për transpozimin e Aneksit 1 të Rregullores së BE për kontrollet e eksportit për mallrat me përdorim të dyfishtë por nevojiten përpjekje të mëtejshme për përafrimin e legjislacionit të kontrollit të eksportit me *acquis*.

Për sa i përket **marrëveshjeve bilaterale me vendet e treta**, Shqipëria ka vazhduar negociatat me Turqinë në kuadrin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë (FTA), duke u fokusuar në liberalizimin e tregut në shërbime dhe përfshirjen e dispozitave të investimeve në FTA. Shqipëria ka finalizuar memorandumet për bashkëpunim ekonomik me Kuvajtin, Malin e Zi dhe Republikën Çeke, si dhe një marrëveshje bilaterale në investime me Kosovën. Janë finalizuar marrëveshjet e bashkëpunimit ekonomik dhe teknik me Bosnjen dhe Hercegovinën, Brazilin, Kinën, Kazakistanin dhe Korenë e Jugut. Vazhdojnë negociatat për marrëveshje bilaterale në investime me Kanadanë, Islandën, Marokun, Libanin dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Shqipëria ka vazhduar pjesëmarrjen e saj konstruktive në strukturat e Marrëveshjes së Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA). Kanë përfunduar negociatat për një kapitull të ri për zhvillim të qëndrueshëm, të marrëveshjes së Shqipërisë me vendet CEFTA.

Nuk ka pasur ndryshime legjislative në **politikat zhvillimore** ose **ndihmën humanitare, të cilat mbeten në fazë të hershme** të përafrimit me *acquis*.

4.31. Kapitulli 31: Politika e jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes

Shtetet anëtare duhet të jenë të afta të ndërmarrin dialog politik në kuadrin e politikës së jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes, për të qenë në linjë me deklaratat e BE-së, për të marrë pjesë në veprimet e BE-së dhe për të zbatuar sanksionet dhe masat shtrënguese të rëna dakord.

Shqipëria ka një **nivel të mirë përgatitje** në lidhje me politikën e jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes. Është bërë **disi progres** në demontimin e municioneve të zakonshme armëve dhe vogla dhe atyre të lehta suficit. Për sa i përket politikës së përbashkët të jashtme dhe sigurisë, Shqipëria është në linjë me të gjitha deklaratat përkatëse të BE-së dhe përfundimet e Këshillit të Evropës (përafrim 100%). Kjo prirje ka qenë e qëndrueshme në vitet e fundit, duke treguar kështu një angazhim shumë të qartë në lidhje me pozicionin e promovuar nga Bashkimi Evropian për çështje lidhur me paqen dhe sigurinë në botë. Gjithashtu, Shqipëria ka vijuar të marrë pjesë në misionet e administrimit të krizave civile dhe ushtarake. Gjatë vitit të ardhshëm, në veçanti, vendi duhet të:

→ të përdorë gjerësisht dhe të sigurojë mirëmbajtjen e regjistrit në rrjet të armëve dhe municioneve, nën administrimin e Policisë së Shtetit.

Dialogu i rregullt politik midis BE-së dhe Shqipërisë për çështjet e sigurisë së jashtme vijoi edhe në periudhën në shqyrtim. (Për më shumë informacion mbi marrëdhëniet me vendet e tjera të zgjerimit dhe Shtetet Anëtare të BE-së, *shihni Kriteret Politike – Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare*.)

Për sa i përket **politikës së përbashkët të jashtme dhe sigurisë**, Shqipëria ka qenë në linjë, kur i është bërë ftesë, me të gjitha deklaratat përkatëse të BE-së dhe përfundimet e Këshillit të Evropës (përafrim 100%). Kjo prirje ka qenë e qëndrueshme në vitet e fundit, duke treguar kështu një angazhim shumë të qartë në mbështetje të pozicionit të promovuar nga Bashkimi

Evropian për çështje lidhur me paqen dhe sigurinë në botë. (Për sa i përket Gjykatës Penale Ndërkombëtare, *shihni Kriteret Politike – Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare.*)

Shqipëria është në linjë me dhe ka zbatuar të gjitha **masat shtrënguese** të propozuara nga vendimet e Këshillit të Evropës.

Në lidhje me **mospërhapjen**, Shqipëria ka bërë progres të mëtjshëm në zbatimin e planit të veprimit për shkatërrimin e armatimit suficit. Demontimi i municioneve të zakonshme suficit ka zhvillim të mirë. Mbeten akoma për t'u bërë pastrimi i zonave të nxehta, largimi i kimikateve të rrezikshme, dhe mbyllja përfundimtare e depove të panevojshme dhe rehabilitimi i depove të përhershme. Demontimi i armëve të vogla dhe të lehta është thujse i përfunduar. Janë ndërmarrë veprime për të përmirësuar sigurinë e armatimit dhe magazinimit, që mbeten shqetësim. Regjistri i armëve dhe municioneve në rrjet nën administrimin e Policisë së Shtetit është instaluar dhe është në funksion. Është miratuar strategjia e sigurisë kombëtare. Strategjia për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm është përfunduar dhe pritet të miratohet. (Për sa i përket Gjykatës Penale Ndërkombëtare, *shihni Kriteret Politike 2.3 – Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare.*)

Shqipëria ka vijuar të përfshihet në mënyrë aktive në **bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare**. Shqipëria ka patur katër vëzhgues në dy misionet e OSBE-së në Ukrainë, dhe gjithashtu ka dërguar dy vëzhgues të OSBE-së për zgjedhjet parlamentare në Ukrainë të zhvilluara në tetor të vitit 2014.

Për sa i përket **masave të sigurisë**, është duke u diskutuar një marrëveshje sigurie me BE-së për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacioneve të klasifikuara.

Shqipëria ka vijuar të marrë pjesë në misionet e menaxhimit të krizave civile dhe ushtarake në kuadrin e **politikës së përbashkët për sigurinë dhe mbrojtjen** (CSDP), në veçanti në EUFOR Althea Bosnje dhe Hercegovinë (me një oficer ushtarak). Përmes NATO-s Shqipëria ka ofruar furnizime të konsiderueshme me armatime suficit për forcat kurde që luftojnë kundër Da'esh.

4.32.Kapitulli 32: Kontrolli Financiar

Bazuar në standardet ndërkombëtare, rregullat e BE-së për kontrollin financiar promovojnë administrim të fuqishëm financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve kombëtare. Ato gjithashtu mbrojnë interesat financiare të BE-së nga mashtrimi në administrimin e fondeve të BE-së dhe Euron nga falsifikimi.

Shqipëria ka **nivel mesatar përgatitje** për këtë kapitull. Është bërë **disi progres** gjatë vitit të shkuar në lidhje me ndërmarrjen e një strategjie për reformën gjithëpërfshirëse të menaxhimit financiar publik dhe është miratuar një ligj i ndryshuar për Institucionin e Kontrollit të Shtetit (KLSH). Megjithatë, parimi i llogaridhënies menaxheriale nuk është akoma tërësisht i ndërthurur në kulturën e menaxhimit dhe legjislacioni i kontrollit të brendshëm financiar publik (PIFC) nuk zbatohet sistematikisht nga të gjitha institucionet. Gjatë vitit në vazhdim, Shqipëria duhet në veçanti të:

- miratojë ndryshimet në legjislacionin PIFC;
- fuqizojë ndjekjen e vlerësimit vjetor PIFC që trajton dobësitë e sistemit;
- sigurojë cilësinë e auditit të jashtëm duke përafuar më tej veprimtarinë e KLSH me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditit (INTOSAI).

Kontrolli i brendshëm financiar publik

Në dhjetor të vitit 2014, qeveria miratoi **strategjinë e reformës së menaxhimit financiar publik**. Këshilli PIFC, një organ këshillimor i Ministrisë së Financave, akoma nuk ka ndërmarrë një rol më aktiv për promovimin e reformave, ndërsa qeveria nuk ka siguruar

akoma një ndjekje sistematike të gjetjeve të raportit vjetor të PIFC.

Dy **Njësitë Qendrore të Harmonizimit** për Menaxhimin dhe Kontrollin Financiar dhe për Auditin e Brendshëm vijojnë të përqendrohen në organizimin e trajnimeve dhe përgatitjen e legjislacionit e udhëzimeve. Ky përqendrim duhet të kalojë tek ndërmarrja e më shumë veprimtarive strategjike të udhëhequra nga politikat. Rekomandimet nga raportimi vjetor nuk janë ndjekur akoma me efikasitet.

Projekt ndryshimet në ligjin për **menaxhimin dhe kontrollin financiar** (MKF) që qartësojnë rolin e oficerëve autorizues presin miratim. Aktet ligjore dhe nënligjore janë më së shumti në përputhje me kuadrin e kontrollit të brendshëm të Komitetit për Sponsorizimin e Organizatave (COSO) dhe udhëzimet e INTOSAI, por zbatimi mbetet i dobët në të gjitha nivelet e administratës. Shembuj të veçantë janë raporti i ulët i institucioneve buxhetore (30%), që kanë hartuar procedura të brendshme për MKF-në; futja jo e njëtrajtshme e delegimit; dhe aplikimi i pamjaftueshëm i menaxhimit të riskut. Zbatimi dhe mbikëqyrja efikase e sistemeve MKF, dhe trajnimet e përshtatshme për stafin dhe oficerët e lartë të programit nuk janë siguruar akoma. Projekt ligji, që do ta përfaqësojë funksionin e **inspektimit të centralizuar të buxhetit** me kërkesat e PIFC, pritet të miratohet. Kapaciteti operacional i Drejtorisë së Inspektimit Financiar nuk është i mjaftueshëm për të luftuar mashtrimin dhe korrupsionin me rrezik të lartë.

Ligji për **auditin e brendshëm** është i përafëruar me standardet ndërkombëtare. Manualët dhe kodet e etikës më së shumti janë të hartuar. Shkalla e audituesve të certifikuar është 82%, por po krijohet një skemë e re kombëtare certifikimi. Nga 116 institucione, 28 prej tyre nuk kanë numrin e përshtatshëm të personelit. Funksioni i auditit të brendshëm nuk ka arritur akoma potencialin e tij dhe drejtuesit u kërkojnë akoma audituesve të kryejnë punë në lëmin e inspektimit në vend që të identifikojnë dobësitë dhe modalitetet sistematike dhe t'i trajtojnë ato.

Auditi i Jashtëm

Duke qenë se në shkurt të vitit 2015 është miratuar një ligj i rishikuar për KLSH në përputhje me udhëzimet e INTOSAI-it, është krijuar një **kuadër kushtetues dhe ligjor** i përshtatshëm për të garantuar pavarësinë funksionale dhe operationale të KLSH-së. Tani puna duhet të përqendrohet për të siguruar që dispozitat e rishikuara ligjore të zbatohen plotësisht.

KLSH ka një ka një organikë të plotë prej 149 punonjësish që nuk janë të mjaftueshëm për të mbuluar mandatin e tij të auditit që përfshin të gjitha institucionet e sektorit publik. Për të ndihmuar forcimin e kapaciteteve të tij institucionale, KLSH përditësoi planin e tij të zhvillimit strategjik për periudhën 2015-2017, që parashikon përmirësimin e **cilësisë së punës audituese** në përputhje me standardet e INTOSAI-t. Ndërkohë që KLSH mund të ndërmarrë çfarëdolloj audit, institucioni ndërmerr më së shumti auditime përputhshmërie që përcaktojnë dëmin ekonomik dhe shkeljen e rregullave në vend që të përqendrohen në mënyrën e parandalimit të këtyre dëmeve. Auditimet financiare nuk prodhojnë akoma opinione profesionale auditimi. Auditimet e performancës duhet të rriten në numër dhe duhet të jenë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare. Janë hartuar manualët e auditimit, por duhet të rishikohen për të qenë në përputhje me standardet e INTOSAI-t.

Ndikimi i punës së auditit është i kufizuar nga numri i ulët i institucioneve të audituara. Në vitin 2014, KLSH ndërmori 160 auditime, duke zbuluar parregullsi në shumën totale prej 11.19 miliard LEK shqiptare. KLSH paraqiti 41 raste të lidhura me 149 zyrtarë në Organin e Prokurorisë së Përgjithshme në kuadrin e luftës kundër krimit ekonomik, mashtrimit dhe korrupsionit. Raportet e auditimit përmbledhen çdo tremujor dhe publikohen në faqen e internetit të KLSH-së. Ministria e Financave ka hartuar një plan veprimi për të ndjekur gjetjet e KLSH-së por ndjekja sistematike ka nevojë të përforcohet më tej. Raportimi vjetor i auditimit i KLSH-së në Kuvend diskutohet në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, por edhe në këtë

rast nuk ka një ndjekje sistematike parlamentare.

Mbrojtja e interesave financiare të BE-së

Për sa i përket **përafrimit me *acquis***, legjislacioni kombëtar përfshin elementët kryesorë të Konventës për Mbrojtjen e Interesave Financiarë të BE-së dhe rregullon detyrimin për të ruajtur provat. Ligji i rishikuar që mbulon kriteret për **shërbimin e bashkërendimit kombëtar kundër mashtrimit (AFCOS)**, caktuar drejtorisë së inspektimit të financave publike në Ministrinë e Financave, nuk është miratuar akoma. AFCOS ka kapacitete funksionale të kufizuara. Për sa i përket **bashkëpunimit me Komisionin Evropian**, procedurat për raportimin e parregullsive dhe rasteve të dyshuara për mashtrim nuk janë fuqizuar akoma. Sistemi i administrimit të parregullsive është ngritur, por deri tani nuk janë raportuar akoma raste të dyshuara. Nuk është krijuar akoma një historik i shëndoshë i veprimtarive hetuese.

Mbrojtja e Euros nga falsifikimi

Shqipëria ka nënshkruar, por nuk ka ratifikuar ende, Konventën Ndërkombëtare të vitit 1929 për Ndalimin e Falsifikimit të Valutës. **Përafrimi me *acquis*** është i pjesshëm. Medaljet dhe monedhat e ngjashme me monedhat Euro akoma nuk janë të rregulluara. **Analiza teknike** e parave të falsifikuara kryhet nga Qendra Kombëtare e Analizës (QKA) në Bankën e Shqipërisë, që ka vlerësuar një numër të konsiderueshëm kartëmonedhash vendase dhe të huaja në periudhën 2014-2015. Ajo bashkëpunon autoritetet kompetente në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Banka e Shqipërisë ka arritur një **marrëveshje bashkëpunimi** formale me Komisionin Evropian për monedhat në vitin 2013. Një marrëveshje e ngjashme për kartëmonedhat me Bankën Qendrore Evropiane nuk është arritur akoma. Autoritetet kompetente kombëtare marrin pjesë rregullisht në veprimtaritë e organizuara në kuadrin e programit Pericles 2020.

4.33. Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore

Rregullat e financimit të buxhetit të BE-së përcaktojnë kontributet e bazuara kryesisht në të ardhurat kombëtare bruto të secilit Shtet Anëtar si dhe në tatimin mbi vlerën e shtuar dhe tarifat doganore.

Shqipëria është **disi e përgatitur** në lidhje me dispozitat financiare dhe buxhetore. Në këtë fushë kishte **disi progres**. Shqipërisë do t'i duhet të ngrejë një organ bashkërendimi brenda afateve të duhura për të drejtuar përgatitjet para anëtarësimit në fushën e burimeve të veta.

Ka patur zhvillime të kufizuara në fushën e **burimeve vetjake tradicionale, burimin e bazuar në tatimin e vlerës së shtuar dhe burimin e bazuar në të ardhurat kombëtare bruto**. Në lidhje me burimin e bazuar në TVSH, evazoni fiskal mbetet një përparësi që duhet trajtuar. Për sa i përket burimit të bazuar në të ardhurat kombëtare bruto, duhet të vijojë puna për futjen e standardeve ESA 2010. (*Për zhvillimet në fushat themelore të politikave, shihni Kapitujt 16 – Tatimet; 18 – Statistikat; 29 Bashkimi Doganor; dhe 32 – Kontrolli Financiar*).

Shqipëria ka ngritur **infrastrukturën administrative** kryesore për fushat themelore të politikave që ndikojnë drejtpërsëdrejti sistemin e të ardhurave vetjake. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të siguruar masat efikase për luftën kundër evazionit fiskal dhe ekonomisë informale. Në momentin e duhur, do të duhet punë për krijimin e institucioneve dhe organeve bashkërenduese përgjegjëse për hartimin e kushteve administrative për aplikimin e rregullave për të ardhurat e veta.

Shtojca I – Marrëdhëniet midis BE-së dhe Shqipërisë

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit midis Shqipërisë dhe BE-së ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2009. Shqipëria paraqiti aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian më 28 prill 2009. Pas kërkesës nga Këshilli, Komisioni dhe Opinionin e tij në lidhje me aplikimin e Shqipërisë në nëntor të vitit 2010. Në dhjetor të vitit 2010, Këshilli theksoi se hapja e negociatave për anëtarësim do të merrej në konsideratë pasi Komisioni të kishte arritur në vlerësimin se vendi kishte arritur nivelin e nevojshëm të përputhshmërisë me kriteret e anëtarësimit dhe, në veçanti, që vendi kishte përmbushur prioritetet kyçe të përcaktuara në Opinionin e Komisionit. Duke marrë në konsideratë progresin e arritur nga Shqipëria, Komisioni rekomandoi në tetor të vitit 2013 që Shqipërisë t'i jepet statusi i vendit kandidat, duke patur mirëkuptimin që vendi duhet të vazhdojë të ndër marrë veprime në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe Komisioni identifikoi 5 prioritetet kyçe për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Në dhjetor, Këshilli deklaroi se do të vendoste nëse do të jepte statusin e vendit kandidat në qershor të vitit 2014, pas publikimit të një raporti të Komisionit që përqendrohej në zbatimin nga ana e Shqipërisë së strategjisë për reformën e gjyqësorit dhe për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Këshilli theksoi se zbatimi i qëndrueshëm i reformave dhe përmbushja e të gjitha prioritetëve kyçe janë të domosdoshme për hapjen e negociatave. Në një raport të publikuar në qershor të vitit 2014, Komisioni konfirmoi rekomandimin e tij që Këshillit duhet t'i jepet Shqipërisë statusin e vendit kandidat. Këshilli i Evropës i qershorit 2014 mbështeti vendimin e Këshillit të Punëve të Përgjithshme duke i dhënë Shqipërisë statusin e vendit kandidat.

Gjatë vitit të shkuar, Shqipëria ka zbatuar pa probleme detyrimet e saj në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA). Dialogu i rregullt politik dhe ekonomik midis BE-së dhe Shqipërisë ka vijuar përmes strukturave përkatëse në kuadrin e MSA-së. Komisioni dhe Këshilli i Stabilizim Asociimit u mbledhën përkatësisht në prill dhe në maj të vitit 2015. Janë zhvilluar edhe takime të nën komisioneve dhe të grupit të veçantë për reformën në administratën publike. Shqipëria ka vijuar të marrë pjesë aktive në takimet e dialogut të nivelit të lartë, që janë zhvilluar në shtator 2014, mars 2015 dhe shtator 2015, si dhe në takimet e tjera përkatëse të grupeve të përbashkëta të punës për pesë prioritetet kyçe në shtator dhe në shkurt.

Shqipëria ka bërë progres të vazhdueshëm në trajtimin e **prioritetëve kyçe** për hapjen e negociatave të anëtarësimit, duke nisur një sërë reformash të nevojshme për të ecur përpara në rrugën drejt integritit në BE. Arritjet më të rëndësishme janë të lidhura me reformën në administratën publike dhe hartimin e një reforme gjithëpërfshirëse të sistemit gjyqësor. Është thelbësore të vijohet më tej bazuar në progresin e arritur dhe të ruhet ritmi i reformave. Në fushën e sundimit të ligjit, nevojiten rezultate të prekshme të mëtejshme. Përfundimi i reformës gjithëpërfshirëse të gjyqësorit është një nga sfidat më të rëndësishme. Shqipëria ka nevojë të tregojë progres për sa i përket krijimit të një historiku të fuqishëm hetimesh, ndjekjesh penale dhe dënimesh të formës së prerë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në të gjitha nivelet. Zbatimi i masave efikase për të përforcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e popullatës Rome dhe grupeve të tjera të cënueshme në shoqëri, dhe politikat kundër diskriminimit, si dhe zbatimi i të drejtave mbi pronën, janë të një rëndësie të madhe. Shqipëria duhet të zbatojë reforma ekonomike me synim rritjen e konkurrueshmërisë dhe trajtimin e papunësisë, si dhe të përmirësojë mjedisin e biznesit. Angazhimi për dialog përfshirës dhe bashkëpunim në kuadrin e marrëveshjes së arritur midis shumicës qeverisëse dhe partisë kryesore në opozitë në dhjetor të vitit 2014 duhet të zbatohet për qëndrueshmërinë e përgjithshme të të gjitha proceseve reformuese në vijim dhe të ardhshme të lidhura me BE-në.

Liberalizimi i vizave për qytetarët shqiptarë që udhëtojnë në zonën Shengen është në fuqi që

prej dhjetorit të vitit 2010. Si pjesë e mekanizimit të monitorimit të vendosur që prej liberalizimit të vizave, Komisioni ka vlerësuar rregullisht progresin e vendit në zbatimin e reformave të ndërmarra në kuadrin e udhëzuesit të vizave. Mekanizmi i monitorimit përfshin gjithashtu një mekanizëm alarmi, të bashkërenduar nga Frontex, për të parandaluar abuzimin. Komisioni ka organizuar një mision vlerësimi pas liberalizimit të vizave në qershor dhe i ka dorëzuar rregullisht raportet e monitorimit Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Raporti i ardhshëm pas liberalizimit të vizave do të paraqitet në tremujorin e fundit të vitit 2015. Që prej vitit 2006 ka hyrë në fuqi një marrëveshje ri-pranimi midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë.

BE-ja i ka ofruar Shqipërisë asistencë financiare në kuadrin e **Instrumentit të Ndihmës së Para Anëtarësimit (IPA)** për periudhën 2007-2013 në një shumë të përgjithshme prej 594 milion Euro. Asistenca është zbatuar kryesisht nën administrimin e drejtpërdrejtë të Delegacionit të BE-së në Tiranë. Modaliteti i administrimit jo të drejtpërdrejtë është paraqitur përmes një qasjeje pilote për programin kombëtar të IPA 2013.

Në kuadrin e IPA II, Shqipëria do të vijojë të përfitojë nga asistenca e para anëtarësimit për periudhën 2014-2020 në përputhje me prioritetet e përcaktuara në dokumentin strategjik, me një shumë të përgjithshme prej 649 milion Euro. Marrëveshja Kuadër për IPA II hyri në fuqi në prill.

Programi i veprimit për Shqipërinë 2014 siguron rreth 67 milion Euro për promovimin e reformave në sektorë kyçë si demokracia dhe qeverisja dhe sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore. Programi përfshin një operacion për mbështetjen e buxhetit për menaxhimin e financave publike dhe një grup veprimesh për të mbështetur reformën në administratën publike, pjesëmarrjen në programet e bashkimit dhe fuqizimin ekonomik dhe shoqëror të gurpeve minoritare, si dhe një institucion për integrimin në BE.

Shqipëria vijon të përfitojë nga mbështetja në kuadrin e programeve shumë vendëshe dhe rajonale të IPA-s. Vendi vijon të marrë pjesë në pesë programe bashkëpunimi ndërkufitar me vendet fqinjë të Ballkanit Perëndimor dhe Shtetet Anëtare, si dhe në programe të bashkëpunimit tranzitor në kuadrin e Fondit Evropian të Zhvillimit Rajonal dhe Programi IPA i Adriatikut ndërkufitar.

Shqipëria merr pjesë në programet e mëposhtme të BE-së me mbështetjen e IPA: Erasmus+, Evropa Krijuese (fushat e Kulturës dhe Medias), Inovacioni Shoqëror dhe në Punësim, Horizont 2020, Doganat 2020, Fiscalis 2020, Programi i Konkurrueshmërisë së Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME).

Shtojca II – Shtojca Statistikore

TË DHËNAT STATISTIKORE (deri më 07.09.2015)

Shqipëria

Të dhëna bazë	Shënim	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Popullsia (në mijë)	1)	3057e	2919e	2907e	2902e	2899e	2896e
Sipërfaqja totale e vendit (km ²)		28750	28750	28750	28750	28750	28750

Llogaritë Kombëtare		2002	2010	2011	2012	2013	2014
Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) (milion ALL)	2)	62271 1	1 239645 b	1 300624	1 332811	1 350555 p	1 39354 0p
Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) (milion Euro)	2)	4705	8997b	9268	9586	9629p	9956p
PBB (euro për frymë)	2)	1537	3088b	3191	3305	3323p	3440p
PBB (sipas Standardeve të Fuqisë Blerëse (PPS) për frymë)	2)3)	:	7089e	7409e	7300	7400	7800
PBB (sipas Standardeve të Fuqisë Blerëse (PPS) për frymë), krahasuar me mesataren e BE (BE-28 = 100)	2)4)	:	28	28	28	28	29
Norma e rritjes së PBB-së reale: ndryshimi nga viti paraardhës i volumit të PBB-së (%)	5)	4.2	3.7b	2.5	1.4	1.1p	2.1p
Vlera e shtuar bruto e sektorëve kryesorë							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (%)	2)	:	20.7	21.0	21.7	22.5p	22.6p
Industria (%)	2)	:	13.8	13.5	13.3	14.4p	14.2p
Ndërtimi (%)	2)	:	14.9	14.6	13.1	11.9p	11.0p
Shërbimet (%)	2)	:	50.7	50.9	51.9	51.1p	52.2p
Shpenzimet e konsumit final, si përqindje e PBB-së (%)	2)6)	86.0	88.9b	88.9s	88.5	88.9p	90.7p
Formimi bruto i kapitalit fiks, si përqindje e PBB-së (%)	2)6)	37.9	28.4b	29.4s	26.5	25.9p	24.9p
Ndryshimet në inventar si përqindje e PBB-së (%)	2)6) 7)	0.8	1.9b	2.0s	1.8	2.4p	:
Eksportet e mallrave dhe shërbimeve, në raport me PBB-në (%)	2)6)	19.6	32.4b	34.0s	33.4	35.4p	29.9p
Importet e mallrave dhe shërbimeve, në raport me PBB-në (%)	2)6)	44.3	53.0b	56.7s	52.0	53.5p	49.0p

Biznesi	Shënim	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Indeksi i volumit të prodhimit industrial (2010 =100)		:	100.0	111.9	118.7	135.1	138.9
Numri i ndërmarrjeve aktive (shifër)		56490	103038	109039	106837	111083	112537
Norma e krijimit: numri i ndërmarrjeve të krijuara në periudhën e referuar (t) pjesëtuar me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)		18.0	16.0	11.8	12.0	10.9	15.4
Norma e mbylljes: numri i ndërmarrjeve të mbyllura në periudhën e referuar (t) pjesëtuar me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)		:	:	:	:	:	:
Personat e punësuar në SME si përqindje e të gjithë personave të punësuar (në ekonominë e bizneseve jo financiare) (%)		73.6	83.8	81.4	81.7	81.0	:
Vlera e shtuar nga SME-të (në ekonominë e bizneseve jo financiare) (milion Euro)		496e	1574	1521	2126	1961	:
Vlera e shtuar e përgjithshme (në ekonominë e bizneseve jo financiare) (milion Euro)		740	2476	2239	3077	2948	:

Norma e Inflacionit	Shënim	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), % ndryshim nga viti paraardhës	8)	1.7	3.6	1.7	2.4	1.9	0.7

Bilanci i pagesave	Shënim	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Bilanci i pagesave: totali i llogarive korrente (milion Euro)	9)	-444	-1019	-1225	-978	-1037	-1303p
Llogaria korrente e bilancit të pagesave: bilanci tregtar (milion Euro)	9)	-1218	-2083	-2242	-1999	-1893	-2137p
Llogaria korrente e bilancit të pagesave: shërbimet neto (milion euro)	9)	-8	232	135	213	155	268p
Llogaria korrente e bilancit të pagesave: të ardhura neto (milion euro)	9)	116	-90	-25	-72	21	-160p
Llogaria korrente e bilancit të pagesave: transfera korrente neto (milion euro)	9)	667	922	906	880	680	725p
nga të cilat transfera qeveritare (milion euro)	9)	41	45	29	33	17	9p
**Mesatarja e 3 viteve të fundit e bilancit të llogarisë korrente krahasuar me PBB (%)		-7.2	-14.1	-13.3	-11.6	-11.4p	:
Investime të Huaja Direkte hyrëse neto (IHD) (milion euro)		141.4	788.5	608.9	647.8	923.2	801.3p
Investime të Huaja Direkte (IHD) jashtë vendit (milion euro)		0.0	4.8	21.4	17.9	21.6	76.3p
nga të cilat IHD të ekonomisë e raportuar në vendet e BE-28 (milion euro)		:	:	:	:	:	:
Investime të Huaja Direkte (IHD) në ekonominë e raportuar (milion euro)		141.4	793.3	630.4	665.8	944.8	877.6p
nga të cilat IHD të BE-28 në ekonominë e raportuar (milion euro)		:	:	:	:	:	:
**Pozicioni neto i investimeve ndërkombëtare, krahasuar me PBB (%)		:	:	:	:	:	:
Norma e ndryshimit të përvitshëm në hyrjen e remitancave bruto (në valutën kombëtare) nga punonjësit emigrantë (%)		:	-11.0	-3.9	1.6	-19.6	8.8p

Financat Publike	Shënim	2002	2010	2011	2012	2013	2014
***Deficiti/suficiti total qeverisë, në raport me PBB-në (%)		-6.1	-3.1	-3.5	-3.4e	-4.9	-5.1
***borxhi total bruto i qeverisë, në raport me PBB-në (%)		62.8	57.7	59.4	62.0	70.1	71.8
Të ardhurat totale të qeverisë, në përqindje të PBB-së (%)		24.8	26.2	25.4	24.7	24.0	25.9
Shpenzimet totale të qeverisë, në përqindje të PBB-së (%)		30.9	29.3	28.9	28.2	28.9	31.0

Treguesit Financiarë	Shënim	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Borxhi i huaj bruto i të gjithë ekonomisë, në raport me PBB-në (%)	10)	62.8	54.0	55.7	58.0	61.1	65.2
Borxhi i huaj bruto i ekonomisë, në raport me vëllimin total të eksporteve (%)		320.6	166.6	163.7	174.2	174.1	174.0
Oferta e parasë: M1 (kartëmonedha, monedha, depozita 1-ditore, milion euro)		1102	1999	1973	2023	2109	2524
Oferta e parasë: M2 (M1 plus depozitat me maturim deri në 2 vjet, milion euro)		2430	4387	4611	4816	4942	5161
Oferta e parasë: M3 (M2 plus instrumentet e tregtueshme, milion euro)		3083	7114	7626	8080	8192	8538
Kreditimi total i institucioneve financiare monetare për banorët rezidentë (i konsoliduar) (milion euro)		302	3506	3862	3990	3906	4001
Normat e interesit: norma ditore e parasë, për vit (%)	11)	:	4.92	5.07	3.96	3.53	2.55
Norma e interesit të huadhënies (një vit), për vit (%)	12)	14.96	11.29	11.17	10.28	9.52	7.66
Normat e interesit të depozitave (një vit), për vit (%)	13)	8.50	6.40	5.87	5.38	4.17	1.92
Kursi i këmbimit EUR: mesatarja e periudhës (1 euro = ... valuta kombëtare)		132.36	137.79	140.33	139.04	140.26	139.97

Indeksi efektiv i kursit të këmbimit (2005 =100) i ponderuar për tregtinë		:	:	:	:	:	:
---	--	---	---	---	---	---	---

Vlera e aktiveve rezervë (përfshirë arin) (milion euro)		:	1905	1912	1972	2015	2192
Tregtia e mallrave me jashtë	Shënim	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Vlera e importeve: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro)		1587	3328	3867	3797	3699	3941
Vlera e eksporteve: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro)		90	1169	1400	1531	1761	1827
Bilanci tregtar: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro)		-1497	-2160	-2467	-2267	-1938	-2114
Termet tregtarë (indeksi i çmimeve të eksportit / indeksi i çmimeve të importit * 100) (shifër)		101	72	78	83	86	86
Pjesa e eksportit drejt BE-28 si vlerë e eksporteve totale (%)		75.9	70.4	72.8	75.6	76.7	77.4
Pjesa e importit nga BE-28 si vlerë e importeve totale (%)		79.1	66.9	65.3	63.2	64.3	61.1

Demografia	Shënim	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Norma bruto e rritjes natyrale të popullsisë (norma e rritjes natyrale): numri i lindjeve minus vdekjet (për një mijë banorë)		7.6e	4.8e	4.9e	5.0	5.3	5.2
Norma e vdekshmërisë foshnjore e fëmijëve nën 1 vjeç (për 1000 lindje të gjalla)		17.2	9.6	8.7	8.8	7.9	7.9
Jetëgjatësia e pritshme në lindje: meshkuj (vite)		:	74.7e	75.3e	75.5e	76.0	76.4
Jetëgjatësia e pritshme në lindje: femra (vite)		:	79.4e	79.8e	79.7e	80.3	80.3

Tregu i punës	Shënim	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Norma e aktivitetit ekonomik për presonat 20–64 vjeç: përqindja e popullsisë e moshës 20–64 vjeç që është ekonomikisht aktive (%)		:	69.7e	75.6e	71.9e	67.6e	68.6e
*Norma e punësimit për personat 20–64 vjeç: përqindja e popullsisë e moshës 20–64 që janë të punësuar (%)		:	60.3e	64.9e	62.4e	56.7e	56.6e
Norma e punësimit të meshkujve të moshës 20–64 (%)		:	71.5e	72.8e	70.1e	64.8e	65.2e
Norma e punësimit të femrave të moshës 20–64 (%)		:	49.8e	57.2e	54.9e	49.3e	48.5e
Norma e punësimit për personat e moshës 55–64: përqindja e popullsisë e moshës 55–64 që janë të punësuar (%)		:	48.3e	54.7e	56.3e	51.1e	51.2e
Punësimi sipas sektorëve kryesorë							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (%)	14)	:	:	45.4e	46.1e	44.0e	42.7e
Industria (%)	14)	:	:	10.6e	9.1e	9.7e	11.0e
Ndërtimi (%)	14)	:	:	8.2e	8.2e	7.1e	6.4e
Shërbimet (%)	14)	:	:	35.7e	36.6e	38.8e	39.4e
Përqindja e personave të punësuar në sektorin publik në raport me punësimin total për personat e moshës 20–64 (%)		:	:	:	15.7e	17.8e	17.5e
Përqindja e personave të punësuar në sektorin privat në raport me punësimin total për personat e moshës 20–64 (%)		:	:	:	84.3e	82.2e	82.5e
Shkalla e papunësisë: përqindja e fuqisë punëtore që është e papunë (%)	15)	15.8	14.0e	14.0e	13.4e	15.9e	17.5e
Përqindja e fuqisë punëtore meshkuj të papunë (%)	15)	13.6	12.6e	13.6e	14.6e	17.8e	19.2e
Përqindja e fuqisë punëtore femra të papunë (%)	15)	19.1	15.9e	14.4e	11.7e	13.5e	15.2e
Shkalla e papunësisë e rinisë: pjesa e fuqisë punëtore e moshës 15–24 që është e papunë (%)	15)	26.8	30.5e	23.6e	29.8e	31.4e	39.0e
Shkalla e papunësisë afatgjatë: pjesa e fuqisë punëtore e papunësuar për 12 muaj ose më shumë (%)		:	10.6e	10.2e	10.3e	11.5e	11.2e
Shkalla e papunësisë për personat (mosha 25–64) që kanë përfunduar të paktën arsimin e mesëm të ulët (ISCED 0–2) (%)		:	10.9e	12.1e	10.5e	13.6e	13.4e

Shkalla e papunësisë për personat (e moshës 25-64)		:	7.9e	10.1e	11.8e	11.7e	13.7e
--	--	---	------	-------	-------	-------	-------

që kanë përfunduar arsimin terciar (ISCED 5&6) (%)							
Kohezioni Social	Shënim	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Pagat dhe rrogat mesatare mujore nominale (valuta kombëtare)		19659	44375	46665	50093	52150	53025
Indeksi i pagave dhe rrogave reale (indeksi i pagave dhe rrogave nominale pjesëtuar me indeksin e inflacionit) (2000)		121.1	216.1	223.5	238.2	:	234.4
Koeficienti GINI — shih përkufizimet		28.2	:	:	:	:	:
Hendeku i varfërisë		5.7	:	:	3.0	:	:
*Braktisja e hershme e shkollës dhe formimit: pjesa e popullatës e moshës 18–24 që kanë më së shumti arsim të mesëm të ulët dhe që aktualisht nuk merr mësim ose formim (%)		:	31.9e	35.2e	31.6e	30.6e	26.0e

Standardi i jetesës	Shënim	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Numri i automjeteve në raport me popullsinë (numri për 1000 banorë)		49e	104	106p	107	122	131
Numri i abonimeve në shërbime celulare në raport me numrin e popullsisë (numri për 1000 banorë)		261.4e	1584.4	1841.8	2015.0	1822.5s	1686.5

Infrastruktura	Shënim	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Dendësia e rrjetit hekurudhor (linja në funksion për 1000 km ²)		15.0	13.9	13.9	13.9	12.0	12.0
Gjatësia e rrugëve ndër-qytetase (kilometra)							

Inovacioni dhe kërkimi shkencor	Shënim	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Shpenzimet publike për arsimin në raport me PBB-në(%)		3.0	3.4	3.2	3.3	3.2	3.3
*Shpenzimet e brendshme bruto për kërkim-zhvillim, në raport me PBB-në (%)		:	:	:	:	:	:
Përqindja e familjeve që kanë shërbim interneti në shtëpi (%)		:	:	:	14.3	:	:

Mjedisi	Shënim	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Intensiteti energjetik i ekonomisë (kg të barasvlershme naftë për 1.000 euro PBB me çmimet konstante të 2005)		:	:	:	:	:	:
Elektriciteti i prodhuar nga burime të rinovueshme në raport me konsumin bruto të elektricitetit (%)		:	:	:	:	:	:
Transporti rrugor i mallrave si përqindje e transportit të brendshëm të mallrave (bazuar në ton - km) (%)		:	:	:	:	:	:

Energjia	Shënim	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Prodhimi parësor i produkteve energjetike (mijë TOE)		896	1643	1494	1676	2041	2014
Prodhimi parësor i naftës bruto (mijë TOE)		308	744	895	1031	1207	1368
Prodhimi parësor i antracitit dhe linjtit (mijë TOE)		5	3	2	2	2	0
Prodhimi parësor i gazit natyror (mijë TOE)		8	13	15	15	16	28
Importet neto të të gjitha produkteve energjetike (mijë TOE)		965	552	668	320	567	662
Konsumi i brendshëm bruto i energjisë (mijë TOE)		1862	2106	2162	2014	2346	2342
Prodhimi i energjisë elektrike (mijë Gëh)		3.7	7.7	4.2	4.7	7.0	4.7

Bujqësia	Shënim	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Indeksi i vëllimit të prodhimit bujqësor për mallrat dhe shërbimet (çmimet e prodhuesit) (viti pararendës =100)		:	107.3	103.9	104.5	:	:
Sipërfaqja bujqësore e përdorur (mijë hektarë)		1140	1201	1201	1201	1190	1178
Blegtori: gjedh (mijë kokë, fundi i periudhës)		690	493	492	498	498	500
Blegtori: derra (mijë kokë, fundi i periudhës)		114	164	163	159	152	172
Blegtori: të imta (mijë kokë, fundi i periudhës)		2773	2581	2517	2619	2723	2804
Prodhimi dhe përdorimi i qumështit (qumështi i paskremuar) (mijë ton)		1010	1070	1101	1105	1131	1133
Prodhimi i të mbjellave: drithëra (përfshirë orizin) (mijë ton)		519	662	701	697	703	700
Prodhimi i të mbjellave: panxhar sheqeri (mijë ton)		39	0	0	0	0	0
Prodhimi i të mbjellave: perime (mijë ton)		668	860	890	914	924	950

: = nuk ka

b = shkëputje në

seri

e = vlerë e

përlogaritur

p = provizore

s = përlogaritje e Eurostat

* = tregues "Evropa 2020"

** = tregues i Procedurës së Imbalancës Makroekonomike (MIP)

*** = Të dhënat e deficitit dhe borxhit të qeverisë së vendeve të zgjerimit publikohen "siç janë" dhe pa verifikime në lidhje me cilësinë e tyre dhe përputhjen me rregullat ESA.

Fundshënime:

- 1) 2002 dhe 2010–12: bazuar në llogaritjen retro të INSTAT.
- 2) 2010–14: bazuar në ESA 2010.
- 3) 2012–14: Burimi, Eurostat.
- 4) Burimi, Eurostat.
- 5) 2014: llogaritje e shpejtë bazuar në të dhënat e tremujorit.
- 6) 2010–14: pjesët e përbërësve të shpenzimeve të PBB-së nuk arrijnë në shumën 100% për shkak të mospërputhjeve statistikore.
- 7) 2002: ndryshime në inventarë dhe mospërputhje statistikore.
- 8) 2002: ndryshim midis dhjetorit të një viti krahasuar me dhjetorin e vitit paraardhës.
- 9) 2013 dhe 2014: bazuar në balancën e pagesave, edicioni manual 6 (BPM6).
- 10) Të dhëna të shpërndara nga Banka e Shqipërisë.
- 11) Mesatarja vjetore e kursit ditor të këmbimit në tregun e parasë.
- 12) Norma mesatare e ponderuar aplikuar për huatë 12 mujore gjatë periudhës përkatëse, me maturim 12 mujor.
- 13) Norma e interesit të depozitave përfaqëson normën e ponderuar mesatare për depozitat e pranuar në muajin përkatës, me maturim 12-mujor.
- 14) 2013 dhe 2014: shuma e pjesëve në analizën e punësimit sipas aktivitetit nuk është e barabartë me 100% për shkak të rasteve kur personat nuk kanë ose nuk mund të klasifikohen në një aktivitet të veçantë.
- 15) 2002: të dhëna administrative.

